

VENDIM
Nr. 345, datë 22.5.2019

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË UJITJES DHE KULLIMIT
2019–2031 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe të planit të veprimit, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA KOMBËTARE E UJITJES DHE KULLIMIT
2019- 2031

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fjalor

| | |
|----------------------------------|--|
| Fond kapital rezervë | Një fond i krijuar gradualisht nga Njësia e Ujitjes dhe Kullimit e bashkisë ose nga OPU-ja, i cili përdoret për rehabilitime të vogla periodike dhe përmirësime në skemat e ujitjes dhe kullimit |
| Kullim | Largimi i ujërave nga të mbjellat dhe tokat bujqësore e rurale |
| Kosto fikse | Kosto të cilat duhen çdo vit, pavarësisht dinamikës së ngjarjeve |
| Kostot variabël | Kostot që nevojiten për sigurimin e shërbimit të kërkuar |
| Menaxhim i përmbytjes | Kontroll i ujërave dhe drejtimi i tyre për të minimizuar dëmtimet nga përmbytjet |
| Mbrojtje nga përmbytja | Mbrojtja e popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të përmbytjes, përfshirë parandalimin dhe masat zbutëse ndaj rrezikut nga përmbytjet |
| Hidrovor | Stacion pompimi për kullimin |
| Ujitje | Sigurimi i ujit për të mbjellat për të plotësuar nevojat për ujë dhe mundësuar rritjen e duhur të tyre |
| Performanca e ujitjes | Niveli i sigurimit të ujit për ujitje në mënyrë eficiente, në kohë, sasi dhe ndarje të barabartë |
| Menaxhimi i ujitjes | Marrja nga burimi, transportimi, shpërndarja, përdorimi dhe kullimi i ujit për ujitje |
| Auditim për menaxhimin e ujitjes | Një inspektim/vlerësim periodik i gjendjes funksionale të sistemit ujitës/kullues dhe cilësisë së qeverisjes, sigurimit të shërbimeve të ujitjes dhe praktikave të menaxhimit financiar të një sistemi ujitje dhe kullimi. Qëllimi kryesor i këtij auditimi është identifikimi i nevojave për përmirësime nga Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive dhe OPU-ve duke rekomanduar dhe mbështetjen që duhet të sigurohet |

| | |
|-------------------------------------|---|
| Transferimi i menaxhimit të ujitjes | Transferimi i përgjegjësive dhe autoritetit për qeverisjen, menaxhimin dhe financimin e sistemit të ujitjes nga qeveria qendrore te bashkitë dhe OPU-të |
| Tarifa e shërbimit të ujitjes | Pagesë që përdoruesit e ujit duhet të paguajnë brenda një sezoni ujitje për koston e sigurimit të ujit për ujitje në parcelat e tyre |
| Plani i shërbimit të ujitjes | Plan për të gjitha aktivitetet e lidhura me ujitjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen, i cili përfshin mobilizimin e stafit të kërkuar, grafikun e ujitjes dhe aktivitetet e mirëmbajtjes, takime, monitorimin e performancës si dhe çdo kërkesë tjetër në mbështetje të një performace sa më të kënaqshme për sistemin e ujitjes/kullimit |
| Sistem ujitës i madh | Mbulon një sipërfaqe mbi 5 000 ha |
| Tarifa e mirëmbajtjes | Pagesa e bërë nga të gjithë pronarët e tokës brenda zonës potenciale të shërbimit të ujitjes për të mbuluar koston fikse të ujitjes, që përfshijnë shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit ujitës/kullues, stafin dhe zyrën |
| Plan i Përmirësimit të Menaxhimit | Një plan i thjeshtë i përgatitur nga Njësia e Ujitjes dhe Kullimit apo OPU-ja për mënyrën sesi ata do të përmirësojnë politikën, procedurat dhe performancën e menaxhimit të tyre |
| Sistem ujitës mesatar | Mbulon një sipërfaqe nga 1000 deri 5000 ha |
| Buxhet sipas nevojës | Buxhet që bazohet në mjete eficiente për arritjen e standardit të shërbimit për të cilin është rënë dakord |
| Menaxhim i ujitjes me pjesëmarrje | Përfshirja e fermerëve në projektet e ujitjes, konsultime me fermerët në çështjet e ujitjes, kontributi i fermerëve në mirëmbajtjen e sistemit ujitës, sigurimi i shërbimeve të ujitjes nën mbikëqyrjen apo drejtimin e fermerëve |
| Skema të vogla ujitje | Mbulojnë sipërfaqe më pak se 1000 ha |
| Statuti i OPU | Dokumenti themelor i OPU-së ku jepet informacion standard për OPU-në dhe mundëson OPU-në të fitojë statusin e saj ligjor |
| Akte nënligjore të OPU-së | Organizimi, procedurat, rregulloret e brendshme dhe sanksionet e OPU-së |

Shkurtime

| | |
|-------------|---|
| KM | Këshilli i Ministrave |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| SPUK/MBZHR | Struktura Përgjegjëse për Ujitjen dhe Kullimin në MBZHR |
| DUK | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit |
| BRK | Bordet Rajonale të Kullimit |
| SPUKV/MBZHR | Strukturat Përgjegjëse për Ujitjen dhe Kullimin në Varësi të MBZHR-së |
| NjUKB | Njësia e Ujitjes dhe Kullimit e Bashkisë |
| BE | Bashkimi Evropian |
| PBB | Prodhimi i Brendshëm Bruto |
| U dhe K | Ujitja dhe Kullimi |
| BNRZH | Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) |
| TMU | Transferimi i Menaxhimit të Ujitjes |
| EOU | Ekipi i Organizimit të Ujitjes |
| PPM | Plan i Përmirësimit të Menaxhimit |
| Sh dhe M | Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje |

| | |
|------|---------------------------------------|
| ShMM | Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje, Menaxhim |
| MUP | Menaxhimi i Ujitjes me Pjesëmarrje |
| BB | Banka Botërore |
| PBUU | Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes |
| GPU | Grup i Përdoruesve të Ujit |
| OPU | Organizatë e Përdoruesve të Ujit |
| PShU | Plani i Shërbimit të Ujitjes |

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia për Ujitjen dhe Kullimin në Shqipëri është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me asistencën teknike të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore në kuadër të Marrëveshjes së Huas IBRD- Loan No. 1211-AL, pas konsultimeve të gjera me shumë aktorë.

Kjo strategji përfshin një përshkrim të situatës aktuale dhe sfidat kryesore për ujitjen, kullimin, digat dhe rezervuarët dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Sistemet e ujitjes dhe kullimit janë përkeqësuar pas shumë vitesh pa mirëmbajtjen dhe riparimet e duhura. Ndryshimet e nevojshme që po ndodhin në strukturën e kulturave bujqësore dhe metodat e përdorimit të ujit, si dhe ndryshimet klimatike, kërkojnë modernizimin e sistemeve për të lejuar një eficiencë më të mirë të përdorimit të ujit, menaxhim më intensiv dhe procedura financiare më të besueshme. Digat kanë rreth 55% të kapacitetit të projektuar për arsye të mbushjes me aluvione. Rritja e frekuencës dhe vendndodhjes së përmbytjeve kërkon ndryshime në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet, sistemet e paralajmërimit dhe reagimit.

Strategjia identifikon pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet për ujitjen, kullimin, digat dhe rezervuarët si dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Misioni që sugjeron strategjia për nënsektorët e ujitjes dhe kullimit brenda fushës së veprimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është optimizimi i të gjithë investimeve në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim zgjerimin dhe bërjen të qëndrueshme të sistemeve të ujitjes, përmbushjen e nevojave për kullim dhe mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet. Kjo përfshin sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, përmirësimin e përdorimit eficient të ujit dhe shpërndarjen e barabartë, krahas me reduktimin e rrezikut nga përmbytjet dhe shkatërrimit të digave. Vizioni i sugjeruar për këta katër nënsektorë jep një projeksion se si duhet të jenë ata në 10 deri 20 vitet e ardhshme.

Në të jepet një listë me parimet udhërrëfyese për sektorin në nivelet politike, ligjore, institucionale dhe operationale. Këto janë:

1. Krijimi i një bujqësie të ujitshme produktive, fitimprurëse dhe të qëndrueshme;
2. Krijimi i klasës së mesme përmes një strategjie që ndihmon fermerët e vegjël dhe punësimin në zonat rurale;
3. As bujqësia as ujitja nuk mund të zhvillohen më tepër, nëse nuk zhvillohen së bashku;
4. Shërbimi i ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet janë funksione publike;
5. Menaxhimi dhe zhvillimi me pjesëmarrje i ujitjes;
6. Harmonizimi me parimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor;
7. Bashkëfinancimi i orientuar nga kërkesa i investimeve me kushtin “subvencione të zgjuara”, që motivon investimet lokale në sistemet e ujitjes dhe kullimit;
8. Mekanizma nxitës dhe llogaridhënës për të mbështetur arritjen e standardeve të pranueshme të kushteve të shërbimit;
9. Adaptimi në kohë ndaj ndryshimeve të pritshme klimatike;
10. Buxhetimi sipas nevojave për shërbimin e ujitjes dhe kullimit;
11. Tarifa për shërbimin e ujitjes në nivel-sistemi;

12. Parandalimi ose shmangja e dëmeve dhe dëmtimeve nga uji;

13. Të drejta dhe mundësi të barabarta për rolin dhe autoritetin vendim marrës për qeverisjen, menaxhimin dhe financimin si për burra dhe për gra.

Këto parime shoqërojnë shumicën e objektivave politike dhe masat strategjike.

Qëllimet kryesore në nënsektorin e ujitjes janë rivendosja (rikthimi) i ujitjes në sipërfaqen potenciale të ujitshme, për prodhimin në shumë zona të kulturave bujqësore me vlerë të lartë si perimet dhe drurët frutorë etj.; financimi i duhur për kostot fikse dhe variabël të menaxhimit dhe menaxhimi i sistemeve ujitës në mënyrë të tillë, që degradimi i kanaleve dhe veprave të ulen në minimumin e mundshëm.

Qëllimet kryesore të nënsektorit të kullimit janë sigurimi i pajisjeve, stafit dhe buxhetit të mjaftueshëm për programin e kullimit, mobilizimi i buxheteve të mjaftueshme për kryerjen e punimeve periodike të pastrimit në përputhje me prioritetet, dhe shkalla e heqjes së dherave në kanalet kullues të jetë e njëjtë me atë që akumulohet në to.

Qëllimet kryesore për sigurinë dhe shfrytëzimin e digave janë sigurimi i sasisë së kërkuar të ujit për ujitje, duke i rikthyer në kapacitetin e projektuar (heqje aluvionesh nga kupa e rezervuarëve) apo dhe më tej duke rritur kapacitet akumulues të rezervuarëve e duke ndërtuar rezervuarë të rinj, për të përballuar edhe shtimin e kërkesës si pasojë e ndryshimeve të pritshme klimatike; përmirësimi dhe zbatimi i standardeve të sigurisë për digat; abandonimi i digave me probleme sigurie të cilat nuk janë funksionale dhe nuk janë financiarisht të justifikueshme për t'u rehabilituar.

Qëllimet kryesore të nënsektorit të mbrojtjes nga përmytjet, për atë pjesë që MBZHR-ja është përgjegjëse, janë mbrojtja e shtëpive, ndërtesave dhe pronave të tjera nga dëmet dhe dëmtimet nga përmytjet, riparimi, rehabilitimi dhe modernizimi i të gjitha strukturave të mbrojtjes nga përmytjet, të cilat kanë nevojë për investimeve të tilla, zhvillimi i strukturave shtesë për mbrojtjen nga përmytjet ku ato janë të nevojshme, trajnimi i stafit të strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe Bashkive për monitorimin e gjendjes funksionale të infrastrukturës së mbrojtjes nga përmytjet.

Kapitujt në vijim përmbajnë një set qëndrimesh politike dhe strategjike për ujitjen, kullimin, digat dhe rezervuarët dhe mbrojtjen nga përmytjet. Të gjitha janë në një linjë me misionin dhe objektivat e sektorit, parimet udhëheqëse dhe qëllimet.

Plani i veprimit për atë çfarë do të bëhet për çdo nënsektor është dhënë me projeksionet kohore (afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë), me vlerësimet e kostove të çdo veprimtarie në agjendën e implementimit, dhe rezultatet e pritshme.

Kapitulli 9, shpjegon se si do të caktohen përgjegjësitë kryesore për zbatimin e kësaj strategjie dhe se si palët do të jenë përgjegjëse për të kryer përgjegjësitë e tyre në përputhje me parimet themelore të strategjisë. Strukturat ose organizatat, që do përfshihen në matricat e përgjegjësive janë: Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes dhe bashkitë.

Transparenca në lidhje me performancën e aktorëve të përfshirë në zbatimin e strategjisë është thelbësore për të siguruar llogaridhënien e tyre ndaj politikës dhe strategjisë së qeverisë. Matja e performancës së aktorëve në lidhje me strategjinë është thelbësore për të siguruar llogaridhënien. Kjo përfshin performancën në mobilizimin e burimeve, në zbatimin e strategjisë dhe arritjen e rezultateve dhe impaktit të dëshiruar.

Treguesit e propozuar të performancës për vlerësimin e katër aspekteve të strategjisë, përfshijnë katër kategori:

1. **Inputet** - shkalla në të cilën janë mobilizuar fondet e nevojshme dhe inputet e tjera;
2. **Zbatimi** - shkalla në të cilën janë arritur objektivat e zbatimit;
3. **Rezultatet e menjëhershëm** - shkalla në të cilën rezultatet e pritshme të menjëhershme ose të drejtpërdrejta janë arritur;
4. **Impakti përfundimtar** - shkalla në të cilën impakti përfundimtar i pritshëm është arritur.

Për sa i përket financimit, sipas vlerësimin të bërë nga MBZHR-ja, për një periudhë 10-13-

vjeçare, kostoja totale për rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, infrastrukturës së kullimit, digave të rezervuarëve të ujitjes dhe objekteve të mbrojtjes nga përmytja, është rreth 717 milionë USD, si më poshtë:

- 253.6 milionë USD, për rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar ujitjen në sipërfaqen potencialisht të ujitshme prej 360 000 ha;
- 56.5 milionë USD, për rikthimin e infrastrukturës së kullimit në parametra optimal në sipërfaqen potencialisht të kalueshme prej 280 000 ha;
- 130.2 milionë USD, për rehabilitimin e 410 digave (ose rreth 65% e numrit të përgjithshëm) për rritjen e sigurisë së tyre dhe garantimin e burimeve ujore për skemat ekzistuese;
- 276.8 milionë USD, për rritjen e sigurisë së mbrojtjes nga përmytja lumore dhe detare, nëpërmjet rehabilitimit/ rikonstruksionit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave reja.

Me kontributin e MBZHR-së dhe të 61 bashkive, brenda vitit 2018 sipërfaqja e ujitshme (me infrastrukturë të rehabilituar pjesërisht/plotësisht) arriti në rreth 230 000 ha (me rrjedhje të lirë).

Në kushtet e reja të decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësisë në sektorin e ujitjes dhe kullimit, bashkitë do të marrin masat e nevojshme për mbledhjen e tarifës së ujitjes nga gjithë pronarët e tokave brenda zonës së mundshme të shërbimit të ujitjes. Kjo do të mbulojë kostot fikse të ujitjes, duke përfshirë shpenzimet e mirëmbajtjes, stafin dhe zyrat. Tarifa e shërbimit të ujitjes do të mbulojë kostot e ndryshueshme të ujitjes për ujitje të siguruar faktikisht për ata fermerë, të cilët hyjnë në marrëveshje shërbimi me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkisë.

Megjithatë, asnjë nga investimet e përmendura më sipër nuk do të jetë me efektivitet, nëse nuk sigurohet mirëmbajtja dhe operacionet e duhura nga institucione dhe praktika menaxhimi efektive. Kjo nënvizon prioritetet që duhet të vendosen në reformat institucionale dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Hyrje

Strategjia për Ujitjen dhe Kullimin në Shqipëri është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me asistencën teknike të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore në kuadër të Marrëveshjes së Huas IBRD- Loan No. 1211-AL, pas konsultimeve të gjera me shumë aktorë.

Ky dokument strategjik bazohet dhe është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), miratuar me VKM nr. 348, datë 11.5.2016, Strategjinë për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, miratuar me VKM nr. 73 datë 7.2.2018, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020, miratuar me VKM nr. 709 datë, 29.10.2014.

Kjo strategji përmban një përshkrim të situatës aktuale dhe sfidave për ujitjen (përfshi këtu digat dhe rezervuarët), kullimin dhe mbrojtjen nga përmytjet, një përmbledhje të pikave të forta, të dobëta, mundësitë dhe rreziqet, një vizion për të ardhmen e sektorit, parimet udhërrëfyese, qëndrimet politike dhe strategjike dhe një listë veprimesh e masash me kohën e zbatimit të tyre. Vlerësimet e kostove janë përfshirë në kapitullin 8.

Shqipëria ndodhet në Evropën Juglindore dhe në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Terreni shqiptar është më së shumti malor. 77% e territorit është zonë kodrinore-malore. Pjesa kryesore e terrenit fushor gjendet në pjesën perëndimore, në fushat përgjatë bregut të detit Adriatik.

Klima e Shqipërisë është mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë, dhe dimër të ftohtë e të lagësht. Mesatarja vjetore e reshjeve është 1,485mm. Mesatarja vjetore e reshjeve në zonat malore është rreth 3 000 mm, ndërsa në zonat fushore të ultësirës perëndimore rreth 1 000 mm. 70% e reshjeve ndodhin në periudhën midis muajve tetor–mars, veçanërisht gjatë muajit nëntor. Korriku dhe gushti janë muajt më të thatë.

Shqipëria ndahet në gjashtë basene lumore: Drin–Bunë, Mat, Ishëm–Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë. 66% e sipërfaqes të këtyre baseneve ndodhet brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë. Një e treta ndodhet në Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë dhe Greqi. Totali i rrjedhës ujore vjetore vlerësohet rreth 39.22 miliard m³/vit, nga të cilat rreth 95% derdhet në detin Adriatik dhe vetëm 5% në detin Jon. 86% e rrjedhës ujore ndodh në periudhën midis muajit tetor–maj, kështu që është thelbësore, që kapaciteti grumbullues me ujë i rezervuarëve të sigurojë ujë përgjatë sezonit të vegjetacionit në verë. Sidoqoftë kapaciteti grumbullues i rezervuarve është zvogëluar me rreth 45% e kapacitetit të projektuar për shkak të depozitimit të aluvioneve. Ujërat nëntokësore kontribuojnë me rreth 23% të rrjedhës totale vjetore. 80% e nevoja të popullatës për furnizim me ujë plotësohen nga shfrytëzimi i ujërave nëntokësore.

Sektori energjetik përdor rreth 14 miliard m³ ujë në vit nëpërmjet shfrytëzimit të sistemit të hidrocentraleve. Ujitja përdor vetëm rreth 1 miliard m³ ujë në vit. Për shkak se vetëm 20% e sasisë vjetore të reshjeve ndodhin në muajt e verës, ujitja është e paevitueshme. Kullimi dhe mbrojtja nga përmbytjet bëhen të paevitueshme në muajt e tjerë të vitit, sidomos fund vjeshtë–fillim dimri, fund dimri–pranverë.

Qëndrimet politike të paraqitura më poshtë shpjegojnë cilat janë prioritetet, ndërsa qëndrimet e strategjisë dhe Plani i Veprimit shpjegojnë se si këto prioritete do të implementohen në afatet kohore përkatëse.

1. Situata aktuale dhe sfidat për bujqësinë, ujitjen, kullimin, digat, rezervuarët, dhe mbrojtjen nga përmbytjet

1.1 Bujqësia

Në Shqipëri, bujqësia zë rreth 50% të punësimit dhe 19% të PBB-së. Në total, toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 695,000 ha (24% të sipërfaqes totale të vendit), 80% është në pronësi private dhe 20% në pronësi shtetërore. Madhësia mesatare e fermës shkon në rreth 1.26 ha dhe ndahet në mesatarisht 4.7 parcela, që nënkupton se madhësia mesatare e parcelës shkon në vetëm 0.27 ha. Kulturat kryesore që mbillen janë perimet, pemët frutore, vreshtat, ullinjët, drithërat dhe kulturat foragjere.

Disa nga shqetësimet për bujqësinë përfshijnë nevojën për konsolidimin e tokës të operacioneve në fermë apo të pronësisë, me qëllim përmirësimin e:

1. aksesit ndaj kapitalit dhe të produktivitetit;
2. mundësisë për përzgjedhje më të mirë të kulturave bujqësore;
3. varieteteve dhe standardeve të kultivimit të krahasueshme me standardet ISO, që përdoren në vendet evropiane, dhe
4. mundësisë për të plotësuar nevojat e tregjeve lokale dhe rritjen e eksporteve.

Qëllimet kryesore për bujqësinë janë rritja e prodhimit për njësi sipërfaqe dhe gradualisht dhe të sasisë së ujit të destinuar për ujitje, ashtu si dhe rritja e punësimit në sektorin bujqësor dhe të ardhurave, që gjenerohen nga ky sektor. Ujitja dhe kullimi janë faktorë kyç në arritjen e këtyre qëllimeve.

Bujqësia është një sektor me mundësi të mëdha për punësimin, veçanërisht për gratë. Në vitin 2012, punësimi i grave në sektorin bujqësor është më i lartë se ai i burrave, ndërkohë që vetëm 21,527 janë ferma me pronare femra, krahasuar 329,389 ferma me pronarë meshkuj. Në Shqipëri, gratë luajnë një rol të rëndësishëm në fermat familjare, i cili mund të konsiderohet i barabartë me atë të burrave. Ato janë të përfshira në të gjitha detyrat bujqësore dhe në marrjen e vendimeve në lidhje me kulturat dhe planin e mbjelljeve.

1.2 Ujitja

Situata aktuale

Aktualisht në Shqipëri, sipërfaqja që mund të ujitet vlerësohet në rreth 360,000 ha. Në vitin 2014 aksesit për ujitje shtrihej në një sipërfaqe prej 120 000 ha ose rreth 30% të sipërfaqes potencialisht të ujitshme. Skemat ujitëse janë projektuar me një hidromodul 0.8-1.2 litër/sekondë/ ha, me një normë të ujitjes 2000-7000 m³/ha. Megjithëse skemat me gravitet janë projektuar me eficiencë prej 70% (30% humbje), eficiencia aktuale varion nga 30-60%.

Gjatësia totale e kanaleve ujitëse është 25,000 km, nga të cilat 2,000 km kanale kryesore, 6,200 km kanale sekondarë dhe 16,800 km kanale terciarë.

Sistemi ka nevojë për rehabilitim dhe modernizim. Një pjesë e kanaleve ujitëse dhe veprave të artit në to, kryesisht për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ciklike, janë jashtë funksioni dhe nga 360,000 ha sipërfaqe potencialisht të ujitshme, kanë nevojë për rehabilitim të plotë rreth 140,000 ha ku nuk realizohet ujitja (përfshi dhe ujitjen me ngritje mekanike me stacione pompimi që zë rreth 60%), ndërsa në sipërfaqen tjetër prej rreth 225 000 ha, për të siguruar ujitje të qëndrueshme, nevojiten rehabilitime të pjesshme dhe mirëmbajtje vjetore. Është vlerësuar se nga sistemi duhen larguar rreth 8-10 milionë m³ dhera, të vishen me beton rreth 50% e kanaleve kryesore dhe dytësore (rreth 5000 km) si dhe rikonstruksioni i veprave të artit (vepra të marrjes se ujit, tombino, priza, ura etj.).

Rreth 640 stacione pompimi janë përdorur për ujitjen e rreth 110 000 ha, por që aktualisht pothuajse të gjithë këto stacione pompimi janë jashtë funksioni, kryesisht për shkak të çmimit të lartë të energjisë, mirëmbajtjes në nivele të ulëta, dëmtimeve apo vjedhjeve. Është vlerësuar se për rikthimin e ujitjes në maksimum në rreth 75 000 ha, duhen rikonstruktuar rreth 300 stacione pompimi (me lartësi ngritje mesatarisht 50 metër) dhe skemat ujitëse përkatëse. Për këtë, kërkohen financime të mëdha jo vetëm për rehabilitim e infrastrukturës, por edhe për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike, që në total vlerësohen në 7-8 milionë USD/sezon ujitës. Vënia në punë e stacioneve mund të bëhet e mundur nëse do të subvencionohet kostoja e energjisë nga buxheti i shtetit, të paktën në fazat e para. Kjo do të vinte në kushte të barabarta të gjithë fermerët që kanë nevojë për ujë për ujitje, pavarësisht skemës ujitëse me gravitet apo me stacion pompimi.

Menaxhimi i ujitjes përballet me një numër problematikash, të tilla si:

1. vështirësia që fermerët kanë për të punuar së bashku,
2. cilësia e ulët e shërbimit të ujitjes,
3. mirëmbajtje e pamjaftueshme,
4. infrastrukturë ujitëse jofunksionale,
5. nivel i ulët i pagesës për tarifën e shërbimit të ujitjes (sipas një vlerësimi të Bankës Botërore më pak se 5% e vlerës bruto të prodhimit),
6. menaxhim financiar i dobët apo jo transparent,
7. pasiviteti i OPU-ve, monitorim i dobët i performancës menaxheriale,
8. nivel i ulët konsultimi apo i pranisë së ekspertëve në OPU, dhe
9. nivel i pamjaftueshëm i SH dhe M nga OPU-të.

Veç këtyre, edhe ndryshimet e shpeshta në ekonomi, urbanizim dhe plakja e popullsisë rurale, kanë ndikuar në përkeqësimin e performancës të sistemeve të ujitjes dhe kullimit dhe zvogëlimin e sipërfaqes së ujitur.

MBZHR-ja dhe ish-bordet e kullimit nuk kanë pasur mundësinë të monitorojnë dhe të rrisin kapacitetet brenda OPU-ve, çka bëri të qartë nevojën e ngritjes së një strukture në nivel të mesëm ndërmjet qeverisë qendrore dhe OPU-ve, e cila do të ketë përgjegjësinë për administrimin e kanaleve të dyta të skemave ujitëse të mëdha dhe kanalet kryesore e të dytë si dhe veprat e marrjes për skemat e mesme të ujitjes. Me qëllim bërjen e skemave të ujitjes më produktive dhe më të qëndrueshme duhet që strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë e reja të punojnë së bashku në partneritet edhe me OPU-të si dhe të rrisin kapacitetet e tyre. Qeveria tashmë i ka kaluar këto funksione te 61 bashkitë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve të kullimit”. Në mbështetje të procesit të decentralizimit të përgjegjësive të ujitjes midis qeverisë qendrore dhe bashkive/OPU, është miratuar ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”

Megjithatë, në rrethanat e duhura, arritja e niveleve të kënaqshme të financimit për kostot operacionale për mbulimin e shërbimit të ujitjes është e mundur, dhe OPU-të, nëse trajnohen dhe mbështeten, mund të bëhen funksionale. Referuar një vlerësimi të bërë në vitin 2003 për

performancën e mbi 200 shoqatave të përdoruesve të ujit (SHPU), rezultoi se 49% e tyre u rankuan me nivel të kënaqshëm performance për sa u takon aspekteve institucionale, menaxheriale dhe financiare. Megjithatë fermerët shpesh kanë ndjesi të ulët besimi ndërmjet tyre, është e qartë se SHPU-të nuk dështuan vetëm për faj të tyre. Në një shkallë të gjerë ato dështuan se strukturat shtetërore përgjegjëse, nuk punuan në partneritet me to në terma afatgjatë apo nuk vazhduan të ndërtojnë kapacitete lokale dhe sigurojnë shërbime mbështetëse për to.¹

Sfidat kryesore

Mungesa e besimit midis fermerëve, dhe fermerëve dhe strukturave shtetërore përkatëse është mjaft i përhapur. Kjo është e lidhur me një ndjesi të dobët të integritetit bashkëpunues brenda komuniteteve. Për të kapërcyer këtë do të duhet një menaxhim i qëndrueshëm me pjesëmarrje, planifikim dhe vendimmarrje e përbashkët, si dhe ndihmë nga strukturat shtetërore bazuar në veprimtaritë e kushtëzuara nga fermerët. Mungesa e përfshirjes së bashkive në administrimin dhe financimin e sistemeve të ujitjes, ka çuar në mungesën e drejtimit, mbështetjes, kontrollit dhe balancave midis strukturave shtetërore dhe OPU-ve. Gjithashtu, për OPU-të ka pasur mungesa për formimin e kapaciteteve. Është e qartë se OPU-të duhet të kenë një partneritet të vazhdueshëm me strukturat përkatëse shtetërore, për t'i ndihmuar që të zhvillojnë kapacitetet e tyre. Kjo do përfshijë bashkitë dhe strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, në hartimin e planeve të shërbimit të ujitjes, buxhetin, tarifën dhe monitorimin e performancës. OPU-të do të marrin përsipër gradualisht përgjegjësi në rritje duke u trajnuar dhe kur demonstronjë dëshirë/interes për to.

Për periudhën 2019-2021, për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja janë parashikuar rreth 90 milionë USD, nga të cilat rreth 25% e zënë shpenzimet për operim dhe mirëmbajtje. Ky financim pritet të rritet nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara dhe specifike për bashkitë si dhe duke mobilizuar burime për projekte shtesë për rehabilitimin, modernizimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.²

Përmirësimet në performancën e sistemeve të ujitjes dhe bujqësisë së ujitur janë të nevojshme për të rritur prodhimin e brendshëm bruto (PBB), punësimin dhe të ardhurat në zonat rurale dhe zvogëlimin e varfërisë. Me kalimin e kohës, me bërjen efektiv të menaxhimit dhe financimit të sistemeve të ujitjes, mund të pritet ulja e shpenzimeve nga buxheti i shtetit për ujitjen dhe kullimin.

Me ndryshimet e fundit ligjore dhe institucionale është transferuar përgjegjësi e menaxhimit për shumicën e kanaleve ujitës dhe kullues të bashkitë. Megjithatë, kanalet kryesorë dhe veprat e marrjes së ujit të 22 sistemeve ujitës të mëdha dhe 7 rezervuarë të mëdhenj janë mbajtur nën përgjegjësinë e MBZHR-së. Po kështu, edhe mirëmbajtja dhe rehabilitimi për kolektorët dhe kanalet të mëdhenj kullues, hidrovorët, kanalet e ujërave të larta dhe argjinaturat mbrojtëse nga lumenjtë. Buxheti për ministrinë bazohet në nevojat e propozuara për rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e infrastrukturës në administrim. Ministria do të ndërtojë kapacitetet për njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-ve si dhe trajnimin e trajnuesve.

Ka një nevojë urgjente për ngritjen e kapaciteteve të stafeve në të gjitha strukturat si në nivel qendror e vendor me punonjës, që kanë kualifikimin e duhur tekniko-inxhinierik për fushën. Të një rëndësie mjaft të veçantë janë njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe stafet pranë bashkive, të cilët do të përfshihen në menaxhimin e sistemeve të ujitjes. Lidërsip, identifikimi i përbashkët dhe në kohë i problemit dhe reagimi, komunikimi strategjik dhe arritja e qëllimit, zgjidhja e konflikteve, menaxhimi, dhe roli më i balancuar midis grave dhe burrave në qeverisjen dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes duhet të zhvillohen me mbështetjen e vazhdueshme të strukturave shtetërore. Mungesa e përgjegjësive institucionale dhe stimujt për të drejtuar agjencitë rajonale, vendore dhe fermerët drejt një menaxhimi të mirë kërkojnë vëmendje të posaçme.

¹ World Bank, 2004. Project Appraisal Document for Water Resource Management Project in Albania. Washington, DC. Also, ArbenMolla, 2005. Water Users Association Performance Assessment. Done by the Project Management Unit under the Second Irrigation and Drainage Rehabilitation Project of The World Bank. Tirana, Albania.

² As per the current mid-term budget, 2018-2020.

1.3 Kullimi

Situata aktuale

Në Shqipëri, sipërfaqja me infrastrukturë kullimi shkon në 280 000 ha, nga të cilat 205 000 ha kullohet me gravitet. 75 000 ha kullohen me ngritje mekanike nëpërmjet 29 hidrovorëve. Gjatësia totale e kanaleve kulluese është 15 700 km, nga të cilat rreth 2 000 km janë kanale kryesorë, 2 700 km kanale sekondare dhe 11 000 km kanale të tretë.

Për rikthimin në kushtet e projektit për funksionimin e rrjetit të kanaleve kulluese, duhen larguar rreth 18 milionë m³ aluvione, të krijuara nga mungesa e mirëmbajtjes ciklike vjetore. Ndërsa për vazhdimin e mirëmbajtjes së qëndrueshme duhen larguar nga sistemi për çdo vit rreth 5-6 milionë m³ aluvione.

Mungesa e investimeve dhe fenomenet natyrore, kane bërë të domosdoshme rikonstruksionin e plotë të infrastrukturës së kullimit në rreth 8 000 ha toka torfike në fushën e Torroviçës në Lezhë dhe në Maliq.

Nga 138 elektropompa të hidrovorëve, 102 janë në punë prej një periudhë 30-45-vjeçare. Hidrovorët kanë një fuqi të instaluar prej 28,000 kw, me një kapacitet të projektuar të largimit të ujit, prej rreth 390 m³/s. Amortizimi i pajisjeve elektromekanike ka ulur kapacitetin e hidrovorëve me rreth 30% kundrejt kapacitetit të projektuar. Kostoja e lartë e energjisë është një tjetër faktor negativ për rinovimin e hidrovoreve. Shumica e stacioneve kanë nevojë jo vetëm për rehabilitim, por edhe për modernizim, me qëllim përmirësimin e kapacitetit dhe eficiencën e elektropompave.

Sfidat kryesore

Funksionet kryesore për t'u kryer në sektorin e kullimit janë: 1) Hartimi i një plani për ndërhyrjet prioritare të largimit të mbushjeve nga rrjeti i kanaleve kulluese, 2) Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e parkut të makinerisë së rëndë (ekskavatorë dhe draga) me një normë vjetore të largimit të dherave rreth 5-6 milionë m³/vit, dhe 3) Shfrytëzimi i hidrovoreve me kapacitet maksimal, mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.

Pastrimi i kanaleve dhe rehabilitimi i sistemeve kullues është një detyrë urgjente, sepse pa një funksionim të mirë të kullimit shpesh nuk mund të kemi as ujitje funksionale.

Meqë shumica e ekskavatorëve ekzistues e kanë mbushur ciklin e tyre të jetës, kanë harxhim të madh karburanti dhe kosto të lartë riparimi dhe pjesë këmbimi, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 90, datë 4.02.2016, alokoi fondet e nevojshme për blerjen e 61 ekskavatorëve të rinj, të tipit të mesëm dhe të vegjël, me të cilët u pajisën 45 bashki. Po kështu, nga një grant i qeverisë kineze Bordet Rajonale të Kullimit u pajisen me 10 ekskavatorë krahëgjatë.

Rehabilitimi i 14 nga 29 hidrovorët, që kullojnë një sipërfaqe prej 70 000 ha, në zonën e Ultësirës Perëndimore në Lezhë, Durrës, Lushnjë, Fier, Vlorë dhe Sarandë, është tepër prioritar. Kjo do të kërkonte instalimin e rreth 43 elektropompave të reja ose 30% të pompave në total. Megjithatë, thuhet se 29 hidrovorët kanë nevojë për rehabilitime në masë të ndryshme dhe ndoshta edhe për modernizim.³

Detyrat dhe kostot që kërkohen nuk janë vetëm investime kapitale. Do të duhej staf shtesë dhe më shumë shpenzime operative për pastrimin e kanaleve nga mbushjet e aluvioneve për çdo vit.

Kullimi kërkohet më shumë gjatë periudhës nëntor-mars, ndërsa ujitja qershor-shtator.

Në konsideratën e MBZHR-së, më prioritare në ujitje, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja janë: 1) studime fisibiliteti/projekte zbatimi për infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe të mbrojtjes nga përmytjet, 2) pastrimi i kanaleve kryesor dhe sekondar kullues dhe 3) rehabilitimi i 14 hidrovorëve në zonën e ultësirës perëndimore.

Prioritetet për rehabilitimin e hidrovorëve duhen përcaktuar duke gjykuar më parë riskun nga përmytjet dhe sipërfaqes që do të kullohet.

Studimet e fizibilitetit dhe inventarizimi i detajuar të rrjetit të kanaleve ujitëse, kullues dhe

³ Vlerësim i bërë nga MBZHR-ja, 2013

veprave të artit janë të nevojshëm për klasifikimin e ndërhyrjeve sipas prioriteteve, hartimin e planit të administrimit të aseteve dhe gjetjen dhe mobilizimin e burimeve për investime kapitale. Kjo gjithashtu do të kërkonte dhe përmirësimin e efikasitetit të procedurave të administrimit dhe prokurimit të kontratave. Gjithashtu dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i stacioneve të pompimit është e nevojshme të përmirësohen nëpërmjet rehabilitimit dhe trajnimit të stafëve të tyre.

Norma e heqjes së aluvioneve nga rrjeti i kanaleve kullues duhet të jetë rreth 5 deri 6 milionë m³ dhera në vit, që është thajse sa trefishi i volumit vjetor të largimit të dherave nga rrjeti kullues (2 deri 2,5 milionë m³ dhera në vit), para vitit 2016.

Me fuqizimin e parkut të makinerisë së rëndë për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë, ritmi i largimit të dherave prej 5-6 milionë m³/vit është plotësisht i mundshëm dhe brenda një periudhe 3-4-vjeçare i gjithë sistemi të jetë i pastruar nga depozitimet ndër vite, pas së cilit duhet të vijohet me ritmin normal.

Kjo do të kërkonte edhe alokimin e shpenzimeve operative të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të largimit të aluvioneve.

Me VKM-në nr. 1107, datë 30.12.2015, “Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”, u krijuan 4 borde rajonale të kullimit, nëpërmjet riorganizimit të 13 bordeve ekzistuese. Riorganizimi i tyre në 4 borde rajonale kullimi bazohet në funksionet dhe detyrat kryesore, të lidhura me përdorimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore të kullimit, hidrovoreve, kanaleve të ujërave të larta, 22 kanaleve kryesore të skemave të mëdha ujitëse, 7 rezervuarëve të mëdhenj që u shërbejnë më tepër se një bashkie dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytjet. Ndërsa gjithë infrastruktura tjetër e ujitjes dhe kullimit iu është transferuar në pronësi bashkive së bashku me përgjegjësinë e administrimit të saj.

Bordi Rajonal Lezhë përfshin qarqet Lezhë, Shkodër dhe Kukës. Bordi Rajonal Durrës përfshin qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër. Bordi Rajonal Fier përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë. Bordi Rajonal Korçë përfshin qarqet Korçë, Elbasan dhe Berat. Staf i total për 4 bordet rajonale është 350 punonjës. Ndërsa një numër prej 267 punonjësish u transferuan te bashkitë.

Gjithë aktiviteti i bordeve rajonale të kullimit financohet nga buxheti i shtetit.

Në zbatim të ligjit të ri nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Këshilli i Ministrave, miratoi vendimin nr. 437, datë 17.5.2017, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, zëvendësojnë bordet rajonale të kullimit duke ruajtur të njëjtat zona respektive shërbimi dhe shërbejnë aktualisht si strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së.

1.4 Digat dhe rezervuarët

Situata aktuale

Nga vlerësimet e bëra për gjendjen teknike të 626 digave, rezulton se 410 (ose 65% e numrit të përgjithshëm), paraqesin probleme të theksuara teknike dhe kërkojnë vëmendje urgjente si për sa i takon sigurisë së digave ashtu edhe volumit të disponueshëm të ujit në rezervuarë.

Në 27% të tyre ka dëmtime në trupin e digës, 29% dëmtime të shkarkuesit katastrofik, 30% dëmtime të ujëlëshuesit, 14% dëmtime njëkohësisht të trupit të digës dhe shkarkuesit katastrofik/ujëlëshuesit.

Në total, kapaciteti uJOR i rezervuarëve është zvogëluar me rreth 45%. Kjo për faktin se cikli i jetëgjatësisë së tyre është në përfundim dhe kupat e rezervuarëve janë mbushur me aluvione. Kapaciteti uJOR i projektuar për të 626 rezervuarët ka qenë 560 milionë m³ ujë, ndërsa kapaciteti total aktual shkon në rreth 300 milionë m³ për sezon ujitjeje.

Sfidat kryesore

Është vlerësuar se për ujitjen e 360,000 ha sipërfaqe toke potencialisht e ujitshme do të nevojitej një sasi prej rreth 1 miliard m³ ujë (të siguruar nga lumenjtë dhe rezervuarët). Aftësia aktuale vlerësohet në 0.6 deri 0.7 miliard m³ ujë për sezon ujitës. Është vlerësuar gjithashtu se për pasojë të ndryshimeve klimaterike sasia që nevojitet (me sistemet me gravitet dhe metodën e

ujitjes sipërfaqësore) mund të shkojë në rreth 1.5 miliard m³ ujë për sezon. Kjo do të kërkonte një kombinim midis rikthimit të volumeve të ujit në një pjesë të rezervuarëve ekzistues, ngritjen e rezervuarëve të rinj, gjetjen e burimeve të reja ujore si dhe nga ana tjetër përdorimin më eficient të ujit, nëpërmjet zbatimit të teknologjive moderne të ujitjes (ujitje me presion). Do të duhet ndoshta një periudhë 10-15-vjeçare kur do të përballemi me këtë kërkesë të lartë për ujë nga rezervuarët.

Një aspekt i modernizimit të digave është rritja e standardeve të sigurisë. Është vlerësuar se rreth 70 rezervuarë duhet të abandonohen, pasi ata e kanë përfunduar ciklin e jetës dhe heqja e aluvioneve apo riparimit të digës nuk justifikohet nga pikëpamja ekonomike.

1.5 Përmbytja dhe mbrojtja ndaj saj

Situata aktuale

Sasia mesatare e reshjeve vjetore në Shqipëri shkon në 1,485 mm/vit. Ajo varion nga 1,000 mm/vit për zonat e ulëta deri në 3,000 mm/vit në zonat malore. Rreth 70% e sasisë totale vjetore të reshjeve bie në periudhën tetor–mars. Nëntori është muaji me nivelin më të lartë të reshjeve. Në Shqipëri rreth 130,000 ha janë të pajisur me infrastrukturë mbrojtëse për përmbytjet nga lumenjtë dhe deti. Përmbytjet në dimër dhe thatësira në verë sa vjen e bëhen më prezente në Shqipëri, sidomos gjatë dy dekadave të fundit.

Përmbytje të konsiderueshme kanë ndodhur në zonën e Shkodrës nga lumi Drin – Buna dhe kjo edhe për shkak të shpyllëzimit, shfrytëzimit pa kriter të kullotave dhe erozionit. Zona që preket më shumë është ajo e Ultësirës Perëndimore, për shkak të disa lumenjve që derdhen në detin Adriatik. Kjo zonë kap një sipërfaqe prej 200,000 ha tokë bujqësore. Përmbytje të konsiderueshme kanë ndodhur edhe në jug të vendit, në vitet 2015, 2017 dhe 2018.

Largimi i ujërave të përmbytjes është përkeqësuar për shkak të mbushjeve në kanalet kulluese dhe uljes së kapacitetit largues të hidrovorëve. Pritet që situata të përkeqësohet akoma më shumë për shkak të ndryshimeve klimaterike, të cilat reflektohen me fenomene moti ekstreme. Një sërë masash vazhdojnë të merren për sa i takon sigurisë së digave dhe zvogëlimit të efektit të përmbytjeve. Mbas periudhës së ujitjes, merren masa për uljen e sasisë së ujit në rezervuarë për periudhën e dimrit, nga nëntori deri në mars.

Është vlerësuar se janë rreth 3285 ndërtime pa leje në infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe të mbrojtjes nga përmbytja. Këto ndërhyrje ndikojnë negativisht në infrastrukturën e ujitje/kullimit apo mbrojtjes nga përmbytjet. Urbanizimi dhe ndërhyrjet njerëzore nga njëra anë, degradimi natyror i veprave nga ana tjetër, kanë bërë, që shumë prej veprave mbrojtëse të jenë jashtë funksionit apo gjysmë funksionale, në një mjedis ku frekuenca, ashpërsia dhe vendndodhjet e përmbytjeve po rriten. Për këtë arsye, është e pashmangshme nevoja për rritjen e investimeve dhe asistencë në këtë fushë, përndryshe situata do të përkeqësohej gjithnjë e më shumë.

Sfidat kryesore

Për sa i takon veprave mbrojtëse nga përmbytjet, nga 850 km gjatësi argjinaturash lumore e detare rreth 300 km argjinatura kanë nevojë për riparime, rehabilitim, rikonstruksion, apo ri-dimensionim për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur dekadave të fundit. Për shkak të rritjes së frekuencës së ndodhjes së këtyre dukurive natyrore, nevoja për ndërhyrje është tepër urgjente.

Mbrojtja nga përmbytja dhe kullimi janë të lidhura me njëra tjetrën. Prioritetet për rehabilitimin e stacioneve të pompimit të kullimit duhet të kenë parasysh edhe riskun e përmbytjeve dhe sipërfaqen që do të kullojë. Rehabilitimi i argjinaturave përgjatë brigjeve të lumenjve dhe deteve duhet të jetë tërësor dhe duhet bazuar në standarde të larta që të sigurojë dhe jetëgjatësinë e veprës.

Duhet të bëhet një vlerësim për veprat shitesë, që nevojiten për rastet e përmbytjeve për zonat me shkallë të mesme e të lartë rreziku, për veprat ekzistuese dhe gjendjen e tyre, si dhe për standardet, që duhen arritur dhe kostot për mirëmbajtjen e veprave. Meqë MBZHR-ja është përgjegjëse për veprat e mbrojtjes nga përmbytjet, ndërsa Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat vendore janë përgjegjëse për aspekte të tjera të mbrojtjes nga përmbytjes dhe reagimin ndaj saj, kjo strategji kufizohet në veprat e mbrojtjes nga përmbytjet.

1.6 Kuadri ligjor për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet

Në vitin 1994, ligji i ujitjes dhe rregulloret e shoqatave të përdoruesve të ujit (SHPU) ishin nismat e para ligjore për administrimin e ujitjes, kullimit dhe ngritjes së SHPU-ve. Në vitin 1996 me amendimin nr. 8111, datë 28.3.1996, të ligjit të ujitjes, themelimi i SHPU-ve bëhej mbi bazë skeme ujitëse. Mbi këto baza, ngritja e SHPU-ve i ka fillimet e veta që në vitin 1996.

Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin” përcaktoi Ministrinë e Bujqësisë si autoritetin kryesor për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet, ndërkohë që administrimi i ujitjes nga bordet e kullimit, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë duhej të transferohej të SHPU-të (ose të referuara tani si organizata të përdoruesve të ujit, OPU). Ky ligj krijoi Departamentin e Mbikëqyrjes, brenda Ministrisë së Bujqësisë për të drejtuar dhe mbikëqyrur sektorin e ujitjes dhe kullimit. Po kështu ligji, përcaktoi statutet e SHPU-ve, mënyrën e transferimit të infrastrukturës ujitëse të SHPU-të dhe kuadrin për ngritjen e Federatave të SHPU-ve.

Nga 1999 deri më 2008-n bazuar në këtë ligj, ekzistonte Departamenti i Mbikëqyrjes, i cili operonte nën Projektin e Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore. Ai ishte ngarkuar të rregullonte përgjegjësitë midis Bordeve të Kullimit dhe SHPU-ve.

Megjithatë, në vitin 2008 ky departament u shkri pasi nuk kreu funksionet për të cilat u ngrit, kjo për shkak të mungesës së stafit dhe fondeve të kufizuara.

Me amendimet e bëra në vitin 2008, SHPU-të u zëvendësuan me organizatat e përdoruesve të ujit (OPU). OPU është organizatë jo fitimprurëse, me vetëfinancim dhe e krijuar me ligj. Ato i shërbejnë interesit të anëtarëve të tyre si dhe interesit publik. Që nga hyrja në fuqi e ligjit të ujitjes dhe kullimit të vitit 1999, dhe pas tre projekteve të njëpasnjëshme të financuara nga Banka Botërore, SHPU-të u ngritën në një sipërfaqe ujitëse prej 218,000 ha, ose 60% e sipërfaqes ujitëse potenciale në vend.

Ende sot, ka pak rregullore apo udhëzime për sektorin, ndaj në këtë strategji propozohen disa nisma të reja, si planet e shërbimit të ujitjes dhe marrëveshjet, auditimet e administrimit të ujitjes, metodat për zgjidhjen e konflikteve etj.

Ligji nr. 111/2012, i datës 15.12.2012 “Për administrimin e integruar të burimeve ujore”, i ndyshuar, është ligji bazë për ujin në vend.

Në lidhje me problematikën gjinore në bujqësi, ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, krijoi kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e grave nga çdo lloj diskriminimi gjinor dhe promovoi shanse të barabarta. Sipas strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri, gratë të cilat bien pre e diskriminimit në lidhje me pjesëmarrjen në drejtimin e OPU-së, apo në pozicione të tjera në bujqësi, kanë mundësi t'i drejtojnë peticione qeverisë ku mund të trajtojnë këto çështje. Megjithatë, presionet sociale lokale do të dekurajojnë gratë nga bërja e peticioneve të tilla. Prandaj, është e rëndësishme, që të ketë rregulla dhe akte nënligjore, që përcaktojnë nivelet minimale të përfaqësimit të grave në strukturat drejtuese të këtyre organizatave.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 27, “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit”, ka përcaktuar se bashkitë janë përgjegjëse për: “Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Ligji i ri nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, reflekton ndryshimet në reformën për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, specifikisht funksionet e bashkive për ujitjen dhe kullimin dhe janë në proces përgatitje nga MBZHR-ja disa udhëzime, që përcaktojnë kriteret dhe rregullat teknike për administrimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.

1.7 Rregullimet institucionale për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet

Gjatë viteve të fundit është vërejtur një boshllëk institucional në rritje për sa i takon faktit se cila strukturë është përgjegjëse për **administrimin e sistemeve ujitës**. Bordet e Kullimit kanë qenë përgjegjës për administrimin e veprave të marrjes dhe kanaleve kryesore të ujitjes kryesisht

në sistemet e mëdha si dhe infrastrukturën kryesore të kullimit. OPU-të e krijuara ishin përgjegjëse për administrimin e rrjetit sekondar dhe terciar të ujitjes, por shumica e tyre nuk janë më aktive dhe ato dështuan në kryerjen e funksioneve të tyre për shkak të mungesës së partneritetit dhe krijimit të kapaciteteve nga strukturat përgjegjëse shtetërore gjatë dekadës së fundit.

Në fillim të vitit 2016, shumica e skemave ujitëse u transferuan te bashkitë, të cilat kanë krijuar njësitë përkatëse të ujitjes dhe kullimit. Tani bashkitë janë përgjegjëse për ndërtimin e kapaciteteve në njësitë e tyre të ujitjes dhe kullimit, si dhe për OPU-të.

OPU-të do të marrin gradualisht përgjegjësi në rritje, kur ato të trajnohen dhe kanë interes/dëshirë për një angazhim të tillë. Ligji i ri për administrimin e ujitjes dhe kullimit i trajton OPU-të si **struktura opsionale** në ofrimin e shërbimit të ujitjes, nëse vetë bashkitë vendosin se është e nevojshme ndihma e tyre. Parimi është, që nëse OPU-të demonstrojnë se funksionojnë në mënyrë të kënaqshme, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe financiare, atëherë bashkitë mund të transferojnë te to përgjegjësitë e menaxhimit.

Kullimi është përcaktuar si funksion publik pasi përfituesit nga kullimi nuk janë të lehtë për tu identifikuar dhe kalojnë për tej bujqësisë. Megjithatë disa përfitues, si fermerët lokal, biznese lokale mund të identifikohen të lidhura direkt me kullimin, ka dhe shumë përfitues të tjerë të cilët janë të lidhur jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, në shumicën e vendeve, kullimi që nuk lidhet direkt me ujitjen, konsiderohet si funksion publik dhe si i tillë financohet nga buxheti i shtetit.

Administrimi i kullimit është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së. Funksionet dhe detyrat e tyre janë të lidhura me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kolektorëve dhe kanaleve kryesore kullues, hidrovoreve, kanaleve të ujërave të larta dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të tyre.

Ndërsa përgjegjësia e administrimit dhe pronësia e gjithë infrastrukturës tjetër të kullimit i është transferuar bashkive përkatëse, në zbatim të VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.

Aktivitetet e kullimit nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, financohen nga buxheti i shtetit. Përgjegjësitë kryesore për kullimin konsistojnë në:

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues, KUL-ve;
- Mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hidrovoreve;
- Kontrolli i cilësisë së ujit në kullues që lidhet me zonat bujqësore, urbane apo me zona të rëndësishme nga pikëpamja mjedisore (këneta etj.);
- Inspektimi, mbikëqyrja e veprave të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja;
- Përgatitja e plan veprimtari në raste përmbytje;
- Mirëmbajtja e veprave mbrojtëse nga përmbytjet lumore e detare;
- Administrimi i lumenjve, përrenjve, aty ku është e nevojshme, në lidhje me erozionin.

MBZHR-ja do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe rikonstruksionin e veprave të **mbrojtjes nga përmbytjet**, si kanalet e ujërave të larta dhe argjinaturat lumore dhe detare. Ndërsa Ministria e Mbrojtjes dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për paralajmërimin nga përmbytjet dhe masat për reagimin ndaj situatave emergjente. Edhe mbrojtja nga përmbytjet është një përgjegjësi publike dhe financimi bëhet nga buxheti i shtetit, si për parandalimin ashtu dhe masat në situata emergjente.

Veprimtaritë për mbrojtjen nga përmbytjet duhet të hartohen dhe zbatohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, të përgatitur nga MBZHR-ja, ligjin “Për emergjencat civile” dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

Realizimi i funksioneve të mësipërme, mbështetet nga buxheti i shtetit me fondet e planifikuara në buxhetin vjetor të MBZHR-së dhe bashkive.

Për vitin 2016–2018, financimi për operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës

së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet në total ka qenë 14.78 miliard lekë, nga të cilat 4.92 për 61 bashkitë dhe 9.86 miliard leke për MBZHR-në. Rreth 60% e financimit është adresuar për rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes.

2. Përmbledhje e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve

Në këtë kapitull jepet një përmbledhje e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve për ujitjen, kullimin, mbrojtjen nga përmytjet dhe sigurinë e digave në Shqipëri.

2.1 Ujitja

Pika të forta

- Angazhimi i fondeve publike për të investuar për rehabilitimin dhe modernizimin e sistemit;
- Angazhimi i strukturave shtetërore përgjegjëse për përmirësimin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së sistemit;
- Njëpërmjet investimeve dhe mirëmbajtjes skemat e amortizuara mund të rikuperojnë aftësinë e projektuar.

Pika të dobëta

- Fermat e vogla dhe të fragmentuara e bëjnë sistemin e ujitjes të vështirë për t'u menaxhuar;
- Përvoja në Shqipëri e menaxhimit të ujitjes me pjesëmarrje ka qenë relativisht e pasuksesshme dhe e paqëndrueshme;
- Ka pasur mungesë angazhimi, mbështetje, llogaridhënie dhe kohezioni social midis përdoruesve të ujit;
- Strukturat shtetërore nuk kanë bërë sa duhet në drejtim të trajnimit dhe mbështetjes së OPU-ve;
- OPU-të nuk kanë qenë në gjendje të mblidhnin tarifa të mjaftueshme për të përballuar shërbimet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes;
- Fonde të pamjaftueshme për mirëmbajtje dhe investime në sistemet e ujitjes;
- Dëmtime dhe vjedhje të pompave, pjesëve elektrike dhe mekanike të stacioneve të pompimit për ujitje.

Mundësitë

- Fermerët dhe qeveria mbështesin zhvillimin e bujqësisë së ujitshme;
- Ka burime ujore të mjaftueshme për të rikthyer ujitjen në një sipërfaqe prej 360,000 ha;
- Vlerësimet kosto-përfitim nga rehabilitimi janë pozitive;
- Bashkitë mund të sigurojnë mbështetje esenciale për ofrimin e shërbimit të ujitjes dhe administrimin financiar;
- Kjo strategji siguron lidhshmëri të mjaftueshme, mbështetje politiko-ligjore dhe trajnim për menaxhimin e ujitjes për strukturën përgjegjëse të ujitjes dhe kullimit në MBZHR;
- MBZHR-ja do të sigurojë shërbime menaxhimi dhe mbështetëse për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj, të cilat do të kryejnë funksione menaxheriale dhe operacionale për sistemet e ujitjes.

Rreziqet

- Mundësia në të ardhmen e mirëmbajtjes së pamjaftueshme dhe amortizimi i shpejtë i sistemeve të ujitjes mund të bëjnë që rehabilitimi të mos japë rezultatet e pritshme.
- Rehabilitimi i herë pas herësh mund të mos përballohet nga qeveria dhe kjo bën që Shqipëria të jetë më e varur nga institucionet kredituese ndërkombëtare;
- Rreth 45% e kapacitetit mbajtës të rezervuarëve është e mbushur me sedimente;
- Ndërtime të paligjshme mbi sistemet e ujitjes.

2.2 Kullimi

Pika të forta

- Sistemet e kullimit në vend mbulojnë sipërfaqe të mëdha;
- Ka një numër të madh specialistësh me njohuritë e duhura për kullimin dhe administrimin e tij;
- Rinovimi kohët e fundit i flotës së ekskavatorëve me 71 ekskavatorë të rinj;
- Strukturat shtetërore përgjegjëse janë të angazhuara për rikthimin në gjendje funksionale

sipas kushteve të projektit të gjithë rrjetit të kanaleve kulluese/ndalimin apo prishjen e ndërtimeve të paligjshme në rrjetet e kullimit.

Pika të Dobëta

- Financime të pamjaftueshme nga buxheti i shteti për rrjetin e kanaleve dhe hidrovorët;
- Kthimi i rrjetit kullues në kapacitetet e projektuara kërkon fonde të mëdha për shkak të mungesës së mirëmbajtjes shumëvjeçare;
- Hidrovorët kanë struktura dhe pajisje të amortizuara;
- Fonde të pamjaftueshme për zëvendësimin e pajisjeve elektrike-mekanike;
- Ka një nevojë urgjente për rikonstruksionin e plotë të rrjetit të kanaleve kulluese dhe ndërtimin e hidrovorëve të rinj në zonën e Maliqit (Korçë) dhe Torovicës (Lezhë);
- Stafit i hidrovorëve ka nevojë për më shumë fonde për shërbime dhe mirëmbajtjen e stacioneve.
- Mungesa e linjave dyfishe për furnizimin pa ndërprerë me energji elektrike;
- Kosto e lartë për riparimin dhe shfrytëzimin e ekskavatorëve të vjetër;

Mundësitë

- Kullimi mund të financohet, të paktën pjesërisht, nga buxheti i shtetit;
- Është e mundur të mblidhen të ardhura nga fermerët për pastrimin në nivel ferme, kanali sekondar e kryesor nga përfituesit;
- Bashkitë mund të ndihmojnë në mbledhjen e tarifave të shërbimit të kullimit nga përfituesit;
- Rritja e numrit të ekskavatorëve dhe dragave, nëpërmjet granteve nga donatorë apo projekte me institucione ndërkombëtare financiare për ruajtjen e normës vjetore të largimit të dherave nga sistemi i kullimit (5-6 milionë m³/vit).

Rreziqet

- Fonde të pamjaftueshme nga buxheti për pastrimin e kanaleve;
- Rritja e shkallës së erozionit rrit nivelin e mbushjeve në rrjetin kullues;
- Mospastrimi i kanaleve të ujërave të larta mund të përbëjë kërcënim për zonat urbane;
- Urbanizimi kërkon standarde më të larta për mbrojtjen nga përmytjet.

2.3 Siguria e digave

Pikat e forta

- Shqipëria ka standarde për sigurinë e digave dhe një Komitet të Digave të Larta;
- Shqipëria ka 626 diga për qëllime bujqësore;
- 90% e digave janë funksionale.

Pikat e dobëta

- Nuk ka një numër të mjaftueshëm specialistësh të kualifikuar për të inspektuar 626 digat dhe për të bërë rekomandime;
- Shfrytëzuesit e shumë digave nuk janë të trajnuar sa duhet dhe nuk kanë njohuritë e mjaftueshme;
- Pothuajse të gjitha digat kanë nevojë për rehabilitim (ujëlëshues, shkarkues, erozion, shkarje etj.);
- Në pjesën e poshtme të digave janë zhvilluar zona të reja urbane/ndërtime të paligjshme, të pa parashikuara gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit të digave;
- Ndryshimet klimatike mund të kërkojnë modernizimin e standardeve të projektimit të digave.

Mundësitë

- Transferimi i përgjegjësive të digave dhe rezervuarve të bashkitë mund të përmirësojë administrimin dhe sigurinë e digave dhe rezervuarve;
- Përvoja botërore ka standarde dhe metoda projektimi të reja, të cilat mund të përmirësojnë standardet dhe praktikën e projektimit në vend;
- Përdorimi i sasive më të vogla të ujit nga rezervuarët nëpërmjet teknologjive moderne të ujitjes, të tilla si ujitja në formë shiu apo me pika.

Rreziqet

- Ndryshimet klimatike shoqërohen me përmbytje më të shpeshta dhe me intensitete më të larta në dimër, me thatësi më të zgjatur në verë dhe ngjarje të motit më pak të parashikueshme;
- Rreziku i dëmtimit apo humbjes së strukturave metalike.

2.4 Mbrojtja nga përmbytjet

Pikat e forta

- Strukturat shtetërore përgjegjëse kanë rritur shkallën e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë në lidhje me parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin paraprak (masat e hershme);
- Strukturat shtetërore përgjegjëse janë të angazhuara të riparojnë dhe ndërtojnë vepra të reja mbrojtëse në zonat e kërcënuara nga përmbytjet.

Pika të dobëta

- Rehabilitimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet kërkon investime shumë të mëdha, që janë përtej mundësive të buxhetit. 300 km argjinatura të dëmtuara kanë nevojë për rehabilitime me një kosto tejet të lartë;
- Buxhet i pamjaftueshëm për mbrojtjen nga përmbytjet;
- Investimet në veprat mbrojtëse nuk japin garanci të plotë ndaj përmbytjeve;
- Mungojnë studime të plota të rrjedhës së lumenjve në kushtet e reja të shfrytëzimit pa kriter dhe intensiv të zhavorreve në shtretërit e tyre, ndërtimit të HEC-ve të rinj, dëmtimeve në ekosisteme etj.

Mundësitë

- Agjencitë shtetërore janë të prirura për bashkëpunim për parandalimin e përmbytjeve, mbrojtjen, paralajmërimin e hershëm dhe reagimin ndaj përmbytjeve.

Rreziqet

- Shfrytëzim pa kriter i lumenjve si marrje pa kriter e zhavorreve apo rërës nga shtretërit e lumenjve;
- Futja e detit në zonat e ulëta dhe në derdhjet e lumenjve;
- Mirëmbajtje e pamjaftueshme e veprave të mbrojtjes nga përmbytjet;
- Rreth 300 km argjinatura të dëmtuara nga 850 km gjithsej;
- Ndryshimet klimatike rrisin frekuencën, intensitetin dhe zonën e përmbytjeve;
- Ndryshimet klimatike do të kërkojnë jo vetëm rehabilitimin e veprave të mbrojtjes nga përmbytjet në standardet e projektuar, por edhe me standarde më të larta;
- Amortizimi i strukturave metalike;
- Urbanizimi kërkon standarde më të larta për veprat mbrojtëse.

3. Vizioni, parimet dhe misioni

3.1 Vizioni për sektorin

MBZHR-ja synon që menaxhimi dhe financimi i skemave të ujitjes dhe kullimit, të decentralizohen. Bashkitë dhe gradualisht edhe OPU-të, të mbështetura nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, do të jenë përgjegjëse për skemat e ujitjes dhe kullimit. Në vazhdimësi, do t'i kushtohet vëmendja e duhur për të gjitha aspektet e zhvillimit, rehabilitimit dhe menaxhimit të sistemeve të ujitjes dhe kullimit. Kjo përfshin përdorimin, sigurimin e ujit, mirëmbajtjen, rehabilitimin, modernizimin dhe mbrojtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

Në zbatim të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të ligjit të ri “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, bashkitë janë në procesin e krijimit dhe konsolidimit të njësive të ujitjes dhe kullimit. Stafi i këtyre njësive, duhet të trajnohet dhe të marrë përgjegjësinë e menaxhimit të ujitjes për të gjithë kanalet e transferuar në pronësi të bashkive përkatëse.

Ndërsa OPU-të, kur ato krijohen dhe funksionojnë do të bëjnë fillimisht menaxhimin e rrjetit terciar të kanaleve.

Trajnimi do të mbulojë aspekte të rëndësishme të menaxhimit dhe financimit të ujitjes për të gjithë aktorët e përfshirë: strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të.

Çdo vit, njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe OPU-të, dhe për skemat e mëdha edhe strukturat

përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, së bashku do të bëjnë konsultime periodike dhe do të përgatisin pjesët e tyre të Planit të përgjithshëm të Shërbimit të Ujitjes për skemën ujitëse. Secila pjesë do të integrohet në një Plan, që specifikon objektivat, kalendarin e ujitjes, punimet e mirëmbajtjes, veprimet që do të ndërmerren prej secilit, buxhetin e këtij Plani dhe koston për tarifën bazë të ujitjes, që do të paguhet nga të gjithë fermerët, që zotërojnë tokë në zonën e shërbimit, për të mbuluar koston e ofrimit të shërbimit të ujitjes.

Njësitë e ujitjes dhe kullimit do të menaxhojnë ujitjen, në bashkëpunim të ngushtë me OPU-të në rastet kur ato funksionojnë. Bashkitë do të mbledhin tarifën bazë të ujitjes në fillim të vitit, e cila përdoret vetëm për mbulimin e kostove fikse të ujitjes. Ndërsa, tarifa e shërbimit të ujitjes do të grumbullohet prej bashkisë nga të gjithë fermerët dhe mundësisht edhe përdoruesit e tjerë të ujitjes, të cilët kanë një marrëveshje me njësinë e ujitjes dhe kullimit për të marrë ujë për ujitje.

Gjatë një periudhe afatmesme, nëpërmjet konsultimeve për menaxhimin, do të përgatiten Plane afatmesme për përmirësimin e menaxhimit për sistemet e mesme dhe të mëdha, dhe këto do të fillojnë në sistemet e vogla. Gjithashtu, në këtë kohë, rehabilitimi dhe modernizimi do të vazhdojë dhe do të kompletohet në shumicën e sistemeve në vend, siç parashikohet në buxhetet afatmesëm. Auditimet për menaxhimin e ujitjes do të kryhen, së paku një herë në dy vjet, për skemat ujitëse të mesme dhe të mëdha, duke bërë edhe rekomandimet për rritjen e kapaciteteve dhe shërbime mbështetëse.

Bashkive tashmë iu është transferuar pronësia e infrastrukturës së ujitjes, që përfshin sipas rastit diga, vepra marrje të ujit, kanale të para, kanale të dyta dhe të treta etj. Të drejtat e përdorimit mund t'u transferohen OPU-ve, nëse dhe atëherë kur ato janë të gatshme. Kjo do të lidhet me kushtin që OPU-ja ose bashkia janë të afta dhe dëshirojnë të menaxhojnë këto nënsisteme në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për administrimin e tyre dhe sipas planeve të shërbimit të ujitjes të rënë dakord midis OPU-së dhe njësisë së ujitjes dhe kullimit të bashkisë.

Vlerësohet se zbatimi i të gjitha këtyre përmirësimeve në ujitje dhe në tokat bujqësore të ujitura, me efektet e tyre dytësore në kultivimin intensiv të kulturave me vlerë të lartë, do të çojnë në rritjen e punësimit dhe të ardhurave me 20% ose më shumë dhe efektet në PBB-së do të jenë me një rritje të paktën 10%. Për më tepër, pasi sistemet e ujitjes janë rehabilituar dhe mirëmbajtja rutinë dhe financimi të bëhen adekuate, kostoja e nënsektorit të ujitjes për buxhetin e shtetit do të ulët me të paktën një të tretën.

Parashikohet se në terma afatmesëm (5-7 vjet) skemat ekzistuese të kullimit dhe hidrovorët do të jenë rehabilituar apo modernizuar. Të gjithë ekskavatorët dhe dragat më të vjetra se 15-20 vjet duhet të zëvendësohen. Kjo do të bëhet duke kombinuar alokimet prioritare me qeverinë qendrore, grantet apo huat nga donatorët bilateralë, dhe me mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare si Banka Botërore etj. Për mirëmbajtjen e sistemit të kullimit duhet të largohen rreth 5-6 milionë m³ dhera në vit. Kjo do të sillte funksionimin normal të sistemit kullues, eliminimin e lagështirës së tepërt të tokës dhe mbajtjen në kontroll të nivelit të ujërave në tokat bujqësore.

Parashikohet, që në terma afatmesëm (5-7 vjet) i gjithë sistemi i mbrojtjes nga përmbytjet, i projektuar për mbrojtjen e një sipërfaqe prej 130,000 ha, ku përfshihen rreth 300 km argjinatura lumore e detare nga 850 km, që janë në total, do të rehabilitohet, rindërtohet apo modernizohet sipas nevojës. Synimi i qeverisë është, që brenda një periudhe 7-10-vjeçare, të ndërtohen edhe vepra të reja shtesë për mbrojtjen nga përmbytjet, në zona të tjera ku ato janë të nevojshme.

Gjithashtu parashikohet, që në terma afatgjatë të gjitha digat të kenë shfrytëzues të kualifikuar, të cilët operojnë bazuar në manualët e SH dhe M të digave. Të gjitha digat duhet, që më parë të jenë riparuar, rehabilituar apo modernizuar. Rezervuarët do të kenë rifituar kapacitetin e projektuar ose dhe më të madh, kur del e nevojshme për shkak të rritjes së nevojave për ujë për t'i bërë ballë ndryshimeve klimatike. Shfrytëzuesit e digës duhet të kenë burime financiare të mjaftueshme për të mundësuar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e duhur për veprën. Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të kryejnë inspektime periodike

dhe japin rekomandime mbi sigurinë e digave, kushtet dhe përdorimin e tyre.

3.2 Parimet bazë për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet

Parimet kryesore mbi të cilat bazohet dhe duhet të ndiqen për zbatimin e kësaj strategjie janë:

1. Rritja e produktivitetit, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë nga bujqësia e ujitshme;
2. Krijimi i një shtrese të gjerë fermerësh të mesëm, nëpërmjet një strategjie që ndihmon fermerët e vegjël dhe nxit punësimin në zonat rurale;
3. As bujqësia e as ujitja nuk mund të zhvillohen në mënyrë të shkëputur nga njëra tjetra;
4. Shërbimet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet janë funksione publike;
5. Zhvillimi dhe menaxhimi i ujitjes me pjesëmarrje;
6. Harmonizimi me parimet dhe Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore;
7. Bashkëfinancimi i investimeve të orientuara nga kërkesa (*demand-driven*) me “subvencione të mençura” të kushtëzuara, të cilat motivojnë investimet lokale në sistemet e ujitjes dhe kullimit
8. Incentiva dhe mekanizma llogaridhënie në mbështetje të arritjes së standardeve të pranueshëm të shërbimit;
9. Përshtatje pro-aktive ndaj ndryshimeve të pritshme klimatike;
10. Buxheti i shërbimeve për ujitjen dhe kullimin, bazuar mbi nevoja;
11. Tarifa shërbimi mbi bazë skeme ujitëse;
12. Parandalimi dhe shmangia e dëmtimeve nga uji nëpërmjet veprave mbrojtëse;
13. Të drejta dhe mundësi të barabarta për rolet dhe autoritetin vendimmarrës për qeverisjen, menaxhimin dhe financimin si për burrat ashtu edhe për gratë.

Parimi 13 duhet të përfshijë vendim marrjen në Planin e Shërbimit të Ujitjes, praktikën e menaxhimit, buxhetimin bazuar në nevoja dhe tarifën.

3.3 Misioni

Misioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ujitjen dhe kullimin është optimizimi i investimeve në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë të sipërfaqes së ujitshme, plotësimin e kërkesave për kullim dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe pronave të tyre nga përmbytja. Kjo përfshin sigurimin e një menaxhimi produktiv dhe të qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, duke përmirësuar eficiencën e përdorimit dhe shpërndarjen e barabartë të ujit si dhe uljen e rrezikut nga përmbytjet dhe shembjet/shkatërrimet e digave të rezervuarëve.

4. Qëllimet kryesore të politikës dhe objektivat

4.1 Komponenti strategjik 1: Ujitja

Qëllimet kryesore në nënsektorin e ujitjes janë rivendosja (rikthimi) i ujitjes në sipërfaqen potenciale të ujitshme, për prodhimin në shumë zona të kulturave bujqësore me vlerë të lartë si perimet dhe drurët frutorë etj., financimi i duhur për kostot fikse dhe variabël të menaxhimit dhe menaxhimi i sistemeve ujitës në mënyrë të tillë, që degradimi i kanaleve dhe veprave të ulen në minimumin e mundshëm.

Objektivat kryesorë për nënsektorin e ujitjes, për t'u arritur brenda një periudhe 8-vjeçare, janë:

1. Rehabilitimi, aty ku është i nevojshëm, dhe modernizimi i sistemeve ujitëse për të rikthyer ujitjen një sipërfaqe bujqësore prej 360,000 ha;
2. Mbjellja në shumicën e sipërfaqes së ujitshme me kultura me vlerë të lartë komerciale për fermerët e vegjël;
3. Arritja e mbulimit të kostos së shërbimit dhe mirëmbajtjes në masën 90%;
4. Fillimi nga shumica e Njësitëve të Ujitjes dhe Kullimit të bashkive dhe OPU-ve e krijimit të fondeve rezervë për investime kapitale;
5. Arritja e një niveli të kënaqshëm mirëmbajtje periodike në shumicën e sistemeve të ujitjes, që ul koston e amortizimit në nivele të papërfillshme.

4.2 Komponenti strategjik 2: Kullimi

Qëllimet kryesore të nënsektorit të kullimit janë sigurimi i pajisjeve, stafit dhe buxhetit të mjaftueshëm për programin e kullimit, mobilizimi i buxheteve të mjaftueshme për kryerjen e

punimeve periodike të gërmimit të pastrimit në përputhje me prioritetet, dhe shkalla e heqjes së dherave në kanalet kullues të jetë e njëjtë me atë që akumulohet në to.

Objektivat kryesorë të kullimit, për tu arritur brenda një periudhe 8-vjeçare, janë:

1. Zëvendësimi i makinerisë së rëndë të vjetruar dhe ineficente që përdoret për pastrimin e kolektorëve dhe kanaleve kullues;

2. Plotësimi i strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së me staf dhe buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e volumit vjetor të punimeve;

3. Njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të që kanë skema kulluese të jenë në gjendje të mobilizojnë burime të mjaftueshme financiare për mbulimin e kostove të pastrimit të kanaleve kullues në zonat e tyre të shërbimit çdo vit;

4. Rregulli i përgjithshëm në kullim është vendosja e balancës ndërmjet dherave që depozitohen dhe atyre që largohen.

4.3 Komponenti strategjik 3: Siguria e digave dhe shfrytëzimi i tyre

Qëllimet kryesore për sigurinë e digave dhe shfrytëzimin e tyre në Shqipëri janë sigurimi i sasisë së kërkuar të ujit për ujitje, duke i rikthyer në kapacitetin e projektuar (heqje aluvionesh nga kupa e rezervuarëve), apo dhe më tej duke rritur kapacitet akumulues të rezervuarëve e duke ndërtuar rezervuarë të rinj, për të përballuar edhe shtimin e kërkesës si pasojë e ndryshimeve klimatike; përmirësimi dhe zbatimi i standardeve të sigurisë për digat; abandonimi i digave me probleme sigurie, të cilat nuk janë funksionale dhe nuk janë financiarisht të justifikueshme për t'u rehabilituar.

Objektivat kryesorë për digat dhe rezervuarët, për t'u arritur brenda një periudhe 10–15-vjeçare, janë:

1. Largimi i aluvioneve nga kupat e rezervuarëve për ta rritur kapacitetin aktual nga 55% në 90% të atij të projektuar;

2. Ndërtimi i rezervuarë të rinj aty ku mund të ndërtohen dhe shfrytëzohen në mënyrë të sigurt;

3. Rritja e kapacitetit të rezervuarëve për të plotësuar me ujë sipërfaqen potencialisht të ujitshme dhe efektin e ndryshimeve të pritshme klimatike;

4. Përmirësimi i standardeve të sigurisë duke i përshtatur me ato me standardet e BE-së si për digat ekzistuese ashtu dhe për ato të reja;

5. Abandonimi i rreth 70 digave me rrezik shembje, të cilat kanë humbur funksionin e përdorimit dhe nuk justifikojnë koston e rehabilitimit.

4.4 Komponenti strategjik 4: Mbrojtja nga përmbytjet

Qëllimet kryesore të MBZHR-së në rolin e saj të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së veprave të mbrojtjes nga përmbytjet dhe sistemeve të kullimit, të nevojshme për të zvogëluar rrezikun nga përmbytjet, janë riparimi, rehabilitimi dhe modernizimi i të gjithë veprave të mbrojtjes nga përmbytjet që kanë nevojë për investime të tilla, ndërtimi i veprave të tjera ku ato janë të nevojshme dhe trajnimi i stafit të strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj për të monitoruar gjendjen funksionale të veprave të mbrojtjes nga përmbytjet.

Objektivat kryesorë për mbrojtjen nga përmbytjet, për t'u arritur brenda një periudhe 10-vjeçare janë:

1. Reduktimi i dëmtimeve dhe dëmeve nga përmbytjet në më pak se 50% të atyre që kanë ndodhur vitet e fundit;

2. Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së dëmtuar dhe ka rrezik për shembje;

3. Ndërtimi i veprave të reja mbrojtëse aty ku është e nevojshme;

4. Trajnimi i stafeve të strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së në drejtim të monitorimit, projektimit, ndërtimit dhe riparimit të veprave mbrojtëse.

Veprimtaritë për mbrojtjen nga përmbytjet duhet të hartohen dhe zbatohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, të përgatitur nga MBZHR-ja, ligjin “Për emergjencat civile” dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

5. Objektivat e politikës dhe masat strategjike

5.1 Komponenti strategjik 1: Objektivat dhe masat për ujitjen

5.1.1 Politika për ujitjen dhe bujqësinë

Objektivi i politikave është që projektet e ujitjes të zhvillohen paralel me projektet e tjera bujqësore, përfshirë edhe ato nëpërmjet granteve dhe instrumenteve të para anëtarësimit në BE (IPA). Vendosja e balancave të duhura midis investimeve në ujitje dhe bujqësi është e nevojshme për arritjen e rezultateve optimale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe menaxhimit të ujitjes. Projektet në ujitje dhe bujqësi do të fokusohen kryesisht në produktivitetin e fermave të vogla dhe agrobizneset. Synimet për zhvillimin e bujqësisë me ujitje do të jenë për rritjen e të ardhurave për fermerët e vegjël dhe punësimit të popullsisë rurale me të ardhura të ulëta.

Do të krijohen lehtësira për konsolidimin e operacioneve në ferma për të bërë të mundur krijimin e kooperativave të agrobiznesit dhe marketingut. Po kështu, do të mbështetet konsolidimi i pronësisë mbi tokën për fermat e fragmentuara apo konsolidimin e operacioneve në ferma, ndërmjet fermerëve vullnetarë fqinjë, për t'i bërë ata më të fuqishëm ekonomikisht nëpërmjet veprimtarisë bujqësore. Synimi kryesor do të jetë krijimi i një klase të mesme në zonat rurale. Prioritetet e zhvillimit dhe kërkimit shkencor janë për një bujqësi me vlerë të lartë, përpunimin dhe marketingun dhe përputhjen me standardet e BE-së. Synimi nuk është bashkimi i fermave të vogla në ferma shumë të mëdha, ku fermerët do të ngeleshin pa punë, por bashkimi në ferma më të mëdha të cilat do të jenë konkurrese dhe do të kthehen në burim i leverdishëm jetese për banorët e zonave rurale.

Masat për politikën për ujitjen dhe bujqësinë

Investime paralele do të jetë si kriter për grantet e dhëna nga qeveria dhe projektet IPA në zonat ku bëhet rehabilitimi i ujitjes. Këtu përfshihen shërbimet e ekstensionit, mbështetja për tregjet e favorshme lokale, zhvillimi i agrobizneseve nga vlera e shtuar e përpunimit të produkteve si dhe ngritja periodike e kapaciteteve në terma afatgjatë për menaxhimin e ujit në fermë.

Mbështetja e qeverisë dhe programet IPA në vitet e fundit është fokusuar në fermat e mëdha dhe veprimtaritë sipërmarrëse. Në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, rehabilitimi i ujitjes dhe zhvillimi i bujqësisë dhe agrobiznesit do të fokusohet në prodhimin e fermave të vogla dhe aktivitetet bazë për uljen e varfërisë dhe sigurimin e ushqimit. Veprimtaritë bujqësore do të përfshijnë zgjedhjet e kulturave bujqësore me vlerë të lartë, farërat e përmirësuara, inputet dhe praktikën e kultivimit, aksesin më të mirë në tregjet brenda vendit dhe në Evropë, si dhe përpunimin e produkteve me vlerë të shtuar dhe agrobizneset.

MBZHR-ja do të punojnë ngushtë me ministrinë e tjera dhe bashkitë për promovimin e konsolidimit të tokës larg nga fermat jo-ekonomike tepër të fragmentuara. Ligji për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe grantet nga qeveria do të mbështesin formimin e grupeve të fermerëve. Po kështu, do të mbështeten grupet e fermerëve të investojnë për ngritjen e pikave të grumbullimit dhe/ose tregjeve lokale.

MBZHR-ja do të mbështetë kërkimin shkencor për të përcaktuar sesi fermat e vogla mund të bëhen ekonomikisht të leverdishme nëpërmjet kultivimit të perimeve, drurëve frutorë etj., përpunimit dhe marketingut. Kjo do të përfshijë analiza të detajuara institucionale, ekonomike, agronomike rreth kërkesës për kapital, aksesit për kredi dhe inpute, praktika optimale kultivimi dhe marketingu. Gjithashtu do të përfshijë testimin e metodave të prodhimit në fermë. Të gjitha metodat e kultivimit do të jenë në përputhje me standardet e BE-së.

5.1.2 Politika për zhvillimin e infrastrukturës

Një udhëzues për rehabilitimin, modernizimin dhe zhvillimin skemave të reja të ujitjes do të shërbejë dhe ndiqet si një politikë bazë. Rehabilitimi dhe modernizimi luajnë një rol të rëndësishëm për administrimin. Me qëllim arritjen e përfitimeve maksimale nga këto investime të mëdha, është e rëndësishme që fermerët dhe bashkitë të bien dakord për prioritetet e rehabilitimit dhe modernizimit. Fermerët dhe bashkitë duhet të njihen me pikëpamjet dhe idetë e njëri tjetrit për mënyrën e rehabilitimit dhe modernizimit. Në fakt, përmirësimet do të bëhen vetëm atëherë kur fermerët dhe bashkitë kanë rënë dakord për çka do të bëhet, kanë rënë dakord

për kontributin në investim (5%), dhe janë të gatshëm të marrin përgjegjësi të plotë për pagesat e shërbimeve të ujitjes pas investimit.

Përafrimi i sipërfaqes që ujitet me atë potenciale të ujitshme konsiderohet prioritet. Për këtë do të përgatitet Plani i investimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e sistemeve të ujitjes. Fondet për Planin e investimeve do të sigurohen nga buxheti i shtetit dhe institucionet ndërkombëtare. Mbështetja financiare nga qeveria për riparime, përmirësime, rehabilitim, modernizim dhe zgjerim të skemave ujitëse do të bazohet në parimin e përdorimit të fondeve të buxhetit për stimulimin e investimeve koresponduese në rang lokal, por në mënyrë të tillë që të mos krijojë varësi ndaj pushtetit qendror. Kjo bëhet për të rritur vetë-mbështetjen e sektorit dhe për të garantuar investime të qëndrueshme në sektorin e ujitjes.

Fermerët dhe OPU-të do të përfshihen në ndarjen e kostos së investimeve rehabilituese. Fermerët duhet të kontribuojnë në një masë të pranuar në investimet e bëra në rehabilitim, modernizim, përmirësim ose zgjerimin e sistemeve të ujitjes. Rehabilitimi i sistemeve të ujitjes do të përfshijë digat, rezervuarët, veprat e marrjes, dhe kanalet kryesore, sekondare dhe në disa raste terciarë. Pritet që në shumicën e rasteve, rrjeti i terciareve të pastrohet kryesisht prej fermerëve ndërkohë që punimet e tjera janë kryer.

Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve ujitëse konsiderohet si një prioritet të lartë dhe urgjent. Për një periudhë afatshkurtër me fonde nga buxheti i shtetit për rehabilitimin e sistemeve ujitëse, është mundësuar ujitje në rreth 230 000 ha. Nga 120 000 ha të ujitshme me sistemet ekzistuese në vitin 2014, është arritur në 230 000 ha në fund të vitit 2018, me një shtim të sipërfaqes së ujitshme në këtë periudhë me rreth 110 000 ha. Gjithashtu, mbështetja për bujqësinë dhe agrobiznesin është e nevojshme në të gjithë sipërfaqen e ujitur.

Një vlerësim duhet bërë për të parë se deri në ç'masë është i nevojshëm modernizimi i sistemeve ujitëse, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në dekadat e fundit dhe për ndryshimet e mundshme klimatike. Vlerësimi do të përfshijë aspektet teknike dhe menaxhuese të digave, rezervuarëve dhe kanaleve ujitës për shkak të kushteve të reja në vend. Me përfundimin e vlerësimit të nevojave për modernizim të sistemeve të ujitjes në vend, do të vlerësohen opsionet e financimit, mobilizohen burimet dhe implementohet modernizimi.

Ndonëse kostot për rehabilitimin dhe modernizimin e stacioneve të pompimit për ujitje mund të jenë të larta, ka skema ujitëse që rezultojnë efikase dhe rehabilitimi apo modernizimi është ekonomikisht i justifikuar.

Masat për politikën e zhvillimit të infrastrukturës

Do të përgatitet një udhëzues për rehabilitimin dhe modernizimin e sistemet e ujitjes dhe kullimit me pjesëmarrje. Në këtë udhëzues do të përfshihen të gjitha procedurat që do të ndiqen në të gjitha projektet si ato të financuara nga buxheti i shtetit ashtu dhe ato nga institucionet financiare ndërkombëtare. Këtu do të përfshihen procedurat për identifikimin, përparësitë dhe rënien dakord për mënyrën e rehabilitimit dhe modernizimit, kontributin e anëtarëve të OPU-ve, marrëveshjet që do të bëhen, rolin e bashkive dhe OPU-ve në marrjen e përgjegjësisë të administrimit të rrjetit të kanaleve të ujitjes, pasi të kenë përfunduar përmirësimet (përfshi administrimin financiar). Të dy gjinitë duhet të marrin pjesë në këtë proces. Gjithashtu, ndihmë për rehabilitim do të jepet vetëm pasi OPU-të marrin angazhimin e tyre për të kryer mirëmbajtjen në një standard të pranuar dhe të matshëm në nivel terciar, dhe vetëm pasi ato e bëjnë mirëmbajtjen para-sezonit në këtë standard, për në paktën një sezon. Kështu, zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet në atë mënyrë që të inkurajojë zhvillimin organizativ dhe menaxhimin.

Bashkitë dhe OPU-të duhet të bien dakord për nivelin e administrimit të M dhe SH pas investimit me standarde të matshme dhe të pranueshme. Këto marrëveshje do të bëhen mbi bazën e angazhimit të plotë të OPU-ve për të paguar shërbimet e ujitjes që vijnë më pas. Ky udhëzues për rehabilitimin dhe modernizimin e skemave të ujitjes me pjesëmarrje duhet përgatitur brenda një periudhe afatshkurtër.

Përgatitja e Planit të Investimeve për ujitjen, do të ketë edhe kostot përkatëse. Do të bëhen

përpjekje me institucionet financiare ndërkombëtare për të gjetur fonde të mjaftueshme për të mundësuar një program rehabilitimi dhe modernizimi të sistemit ujitës që synon rritjen e sipërfaqes që ujitet nga 230 000 ha drejt sipërfaqes potenciale ujitëse prej 360,000 ha, për periudhën 2019–2031.

Një shqyrtim më i kujdesshëm dhe punë e mëtejshme projektuese mbetet për tu bërë. Për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, do të angazhohen fonde të mjaftueshme për të mundësuar rehabilitimin e të gjitha skemave që kanë nevojë. Në të njëjtën kohë, bujqësia, kreditimi, grantet dhe marketingu do të zhvillohen përmes programeve të MBZHR-së për të gjitha zonat që përfitojnë nga rehabilitimi.

Fonde nga burime të ndryshme do të mobilizohen për të bërë të mundur zbatimin e Planit të investimeve për ujitjen. Brenda një periudhe afatshkurtër, do të planifikohet dhe hartohet strategji investimesh për përmirësim, rehabilitim, zgjerim, modernizim dhe zhvillim, të cilat kërkojnë masa të investimeve lokale korresponduese. Në terma afatgjatë, investime të tilla kushtëzohen nga kontributi që duhet të japin fermerët dhe bashkitë. Refuzimi i fermerëve dhe bashkive për të rënë dakord për pjesën e tyre në investim mund të rezultojë në anulimin e investimit nga qeveria.

Bashkëfinancimi i fermerëve mund të bëhet në formën e kontributit me fuqi punëtore, me materiale, ose në ripagimin e një pjese të rënë dakord të kostos së rehabilitimit dhe modernizimit. Prioritet do t'i jepet së pari rehabilitimit dhe modernizimit të digave, rezervuarve dhe veprave të marrjes. Me qëllim që të inkurajohen përdoruesit e ujit të kontribuojnë në kryerjen e investimeve në rehabilitim dhe modernizim, ndërsa qeveria bën, rehabilitimin dhe modernizimin e digave, rezervuarve dhe veprave të marrjes së sistemeve ujitëse, kur OPU-të do të jenë krijuar dhe funksionojnë, bëhen marrëveshje, që ato të marrin përsipër të rehabilitojnë kanalet e treta. Pasi kjo është bërë, qeveria do të rehabilitojë kanalet kryesore dhe sekondare. Ky sistem paralel i investimit nga shteti dhe përdoruesit e ujit do të inkurajojë OPU-të të bëjnë pjesën e tyre të investimeve dhe të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë për sistemet e tyre.

Kriteret bazë për fizibilitetin dhe projektimin e infrastrukturës së ujitjes do të përfshijnë efektivitetin e kostos të përmirësimeve, implikimet e projektit për thjeshtësinë dhe kontrollin mbi asetet, shpërndarjen dhe furnizimin e ujit të përdoruesit, sigurinë, lehtësinë dhe efektivitetin e kostos së mirëmbajtjes të kanaleve, tubacioneve dhe strukturave të kontrollit të ujit.

Në të ardhmen parashikohet frekuencë më e shpeshtë të mungesave të ujit, konkurrencë me e madhe për ujë, saturim nga uji dhe përmytje. Në kontekstin me luhatje më të mëdha të intensitetit të reshjeve dhe ekstremeve të shpeshta në rritje të thatësisë dhe përmytjeve, duhet të identifikohen ndryshimet që duhet të bëhen në kanalet e sistemit ujitës, kontrollin e ujit dhe strukturat matëse, në praktikatat e menaxhimit dhe nevojat për modernizim e sistemit.

Këtu mund të përfshihen shpërndarja më të mirë të ujit në kohë, sasi të mjaftueshme të ujit dhe në kohën e duhur për kultura me vlerë të lartë si perimet, pemë frutore etj.

Në terma afatshkurtër, MBZHR-ja do të analizojë nevojat potenciale për modernizimin e sistemeve ujitëse. Nga analizat do të dalin rekomandimet specifike për modernizimin strukturor gradual dhe të përshtatshëm financiarisht. Këtu përfshihet edhe vlerësimi i përmirësimeve të lidhura me administrimin. Në terma afatmesëm, do të fillojë programi i modernizimit dhe investime të tjera për rehabilitimin dhe modernizimin do të parashikohen dhe implementohen në përputhje me këtë program.

Vetëm disa ndryshime mund të sugjerohen për momentin, por një vlerësim në terren i parametrave aktuale të projektuar duhet të kryhet për ta krahasuar me kërkesat e projekteve të ardhshme për asete/shpronësime, furnizimin me ujë si dhe për kushtet e shpërndarjes së ujit. Ka të ngjarë që shqetësimet për frekuencë më të lartë të përmytjeve, zgjatje të periudhës së thatësisë, modele më pak të parashikueshme motit, dhe pasiguria e objekteve metalike në sistem do të çojnë në nevoja për ruajtje më të madhe të ujit, në më shumë praktika intensive të menaxhimit të ujit për të përmirësuar kohën e marrjes, besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shpërndarjes të ujit, humbje me të paket të ujit, dhe matje më të shpeshta të sasisë së ujit.

Përpjekje duhet të bëhen për zvogëlimin e strukturave metalike. Portat e modelit Duck-bill, prita gjatësore dhe pajisje matëse mund të përdoren për matje. Modernizimi do të jetë pjesë e rehabilitimit, përmirësimit, zgjerimit si dhe të projektimit të sistemeve të reja të ujitjes.

Duhet të bëhet një vlerësim se për cilët stacionet e pompimit të ujitjes duhen rehabilituar dhe modernizuar me kosto të moderuar. Sisteme të tjera me kosto shumë të larta dhe kostoja e energjisë është shumë e lartë dhe e papërbalueshme nga fermerët mund të mbyllen dhe abandonohen.

5.1.3 Politika për rregullimet/mbikëqyrjen sektoriale

Zbatimi i udhëzimeve dhe rregulloreve dhe përmirësimi i kapaciteteve të bashkive do të kërkojë kryerjen periodike të Auditimeve/mbikëqyrjeve të menaxhimit të ujitjes te njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive. Auditimet/mbikëqyrjet e menaxhimit të ujitjes do të kryen në mënyrë periodike dhe do rekomandojnë për atë se çfarë duhet bërë për të përmirësuar menaxhimin e sistemeve të ujitjes, menjëherë apo në të ardhmen e afërt.

Masat për politikën e rregullimeve sektoriale

Spektori i Mbikëqyrjes, pranë strukturës përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR, do të ndjekë realizimin e punimeve që kryhen për rehabilitimin, modernizimin, dhe ndërtimin e skemave ujitëse. Spektori do të identifikojë indikatorët kryesorë të zbatimit, përfshirë disbursimin e fondeve, mobilizimin e punonjësve, cilësinë e punimeve, kompletimin e kontratave. Ai do të planifikojë dhe zbatojë një program të monitorimit të punimeve në investimet e ujitjes. Auditimet e menaxhimit të ujitjes do të kryhen nga një ekip prej 3 personash, të përbërë nga stafi i ministrisë, strukturave të varësi dhe një përfaqësues nga bashkia, por jo punonjës i njësisë së ujitjes dhe kullimit.

Do të përgatitet një udhëzues për auditimet e menaxhimit të ujitjes, i cili ndihmon/orienton përmes identifikimit të pikave të forta dhe të dobëta në qeverisjen e sistemeve ujitëse, ofrimin e shërbimit dhe financimin dhe identifikon se çfarë trajnimesh dhe shërbime mbështetëse nevojiten.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të planifikojnë dhe koordinojnë zbatimin periodik të auditimeve të menaxhimit të ujitjes. Auditimet priten të kryhen së paku një herë në tre vjet dhe do të japin rekomandime për përmirësime në menaxhimin e skemave ujitëse në përputhje me politikën e qeverisë, legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse. Fokusi i këtyre auditimeve do të jetë identifikimi i përmirësimeve të nevojshme dhe dhënia e rekomandimeve për ngritjen e kapaciteteve dhe shërbime mbështetëse.

5.1.4 Politika për qeverisjen e sistemit dhe institucioneve

Ndryshime organizative janë të nevojshme brenda MBZHR-së në nivel kombëtar dhe rajonal. Më shumë informacion dhe udhëzime, ndërtim kapacitetesh, rregullore dhe monitorim janë të nevojshme për të siguruar menaxhim produktiv dhe të qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe kullimit si dhe shërbime mbështetëse të përshtatshme dhe në kohën e duhur për njësitë e ujitjes dhe kullimit pranë bashkive dhe OPO-ve. Kjo do të kërkojë organizime të reja dhe në nivel qendror me buxhet dhe stafe të nevojshme.

Aktualisht pronësia dhe përgjegjësia e administrimit të sistemeve ujitëse të vegjël dhe të mesëm është transferuar te bashkitë. Në administrim të MBZHR-së janë vetëm kanalet kryesorë dhe veprat e marrjes së ujit për sistemet e mëdhenj të ujitjes dhe disa rezervuarë të mëdhenj.

Për administrimin e kësaj infrastrukture, do të përgatiten një sërë udhëzuesish, rregulloresh dhe manuale teknike. Po kështu, do të përgatiten Statuti dhe udhëzimet (akte nënligjore) për ngritjen e OPU-ve dhe grupeve të përdoruesve të ujit (GPU).

Ministria do të trajtojë ekipe të vogla specialistësh, të cilët do të punojnë për ngritjen e OPU-ve dhe GPU-ve në çdo skemë ujitëse. Njësia e ujitjes dhe kullimit e bashkisë do të trajnohet dhe do të jetë përgjegjëse për rritjen kryesor dhe sekondar të kanaleve në bashkëpunim me OPU dhe GPU. Kjo njësi është përgjegjëse për Sh dhe M, si dhe për menaxhimin financiar, përfshirë pagesat e ujitjes, depozitimin e fondeve në llogarinë bankare dhe tërheqjen e fondeve me OPU-të si firmë e përbashkët. Organizatat e përdorimit të ujit do të krijohen kur së paku 51% e

pronarëve të tokave brenda zonës potenciale të shërbimit të sistemit të ujitjes do të votojnë pro krijimit. Kur kjo gjë ndodh, të gjithë pronarët e tokave brenda zonës potenciale të shërbimit të sistemit do të bëhen anëtarë të OPU-së.

Përpara se të fillojë rehabilitimi apo modernizimi i sistemit të ujitjes me mbështetjen e qeverisë dhe përpara se të ngrihen OPU/GPU-të, njësia e ujitjes dhe kullimit pranë bashkisë do të kujdeset për vendosjen e një komunikimi dhe koordinimi midis fermerëve në nivel kanalesh të treta.

Rehabilitimi dhe modernizimi do të luajnë një rol të rëndësishëm në drejtim të administrimit të sistemit të ujitjes. Me qëllim arritjen e përfitimeve optimale, për qeverinë qendrore, vendore dhe fermerët është e rëndësishme që të bien dakord për çështjet prioritare të rehabilitimit apo modernizimit. Fermerët dhe bashkitë duhet të ftohen të paraqesin pikëpamjet e tyre për rehabilitimin dhe modernizimin. Në fakt, përmirësimet do të bëhen vetëm atëherë kur fermerët dhe bashkitë do bien dakord për pjesën e tyre të kontributit, marrin përgjegjësi të plota për administrimin e sistemit, dhe bien dakord të mbulojnë kostot e mirëmbajtjes së ujitjes pas investimit.

Kur njësia e ujitjes dhe kullimit e bashkisë është funksionale dhe administron kanalet e treta në koordinim me kryepleqtë e fshatrave, ekipi i organizimit të ujitjes fillon procesin e ngritjes së OPU/GPU-ve.

Bashkitë do të marrin përgjegjësitë të përcaktojnë se kanalet kryesore, të dytë dhe të tretë menaxhohen në mënyrën e duhur. Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë kanë objektiv të mundësojnë OPU/GPU për administrimin e rrjetit të tretë dhe ku është e mundur atë të rrjetit të dytë. Sidoqoftë, për momentin bashkitë nuk kanë staf dhe përvojën e mjaftueshme për menaxhimin e sistemeve të ujitjes, kështu që trajnimi i tyre për ujitjen dhe kullimin është prioritet.

Fillimisht bashkitë kanë përgjegjësinë kryesore të administrimit të kanaleve para dhe të dyta të ujitjes, ndërsa kryepleqtë e fshatrave, dhe nëse do ishte e mundur GPU-të, do të administronin kanalet e treta. Por në çdo rast, njësia e ujitjes dhe kullimit e bashkive do të bëjë menaxhimin financiar si të kanaleve kryesore, të dyta dhe të treta. Brenda një periudhe 5-vjeçare, njësitë e ujitjes dhe kullimit së bashku me kryepleqtë e fshatrave dhe fermerët mund të vendosin të ngrenë OPU-të dhe përgatiten të marrin në administrim edhe kanalet e dyta. Bashkitë kanë në pronësi të tyre kanalet ujitëse, por mund të fillojnë të transferojnë të drejtën e përdorimit të tyre për nivele të caktuara (të treta, të dyta apo edhe të para), sidomos në skema të vogla dhe të mesme ujitëse, kur OPU-të janë vlerësuar nga se janë të afta dhe kanë dëshirë të administrojnë të gjithë sistemin e ujitjes.

E drejta e përdorimit për kanalet edhe të treta/të dyta mund t'i transferohet OPU-ve brenda një periudhe 5-vjeçare, nëse ato janë gati dhe me një marrëveshje transferimi të së drejtës së përdorimit. Qeveria do të mbështetë krijimin e OPU-ve të fuqishme në nivel kanalesh të dytë dhe me GPU në nivel kanalesh të tretë. Fillimisht, bashkitë do të administrojnë kanalet e dyta ndërsa GPU-të ato të treta. Por në çdo rast, njësia e ujitjes dhe kullimit e bashkive do të bëjë menaxhimin financiar si të kanaleve të dyta ashtu dhe të treta.

Brenda një periudhe 5-vjeçare OPU-të përgatiten të marrin përgjegjësinë e të administrojnë kanalet e dyta. Për sistemet e vogla dhe ndoshta edhe ato mesatare, mundet që OPU-të të marrin përgjegjësinë e administrimit të gjithë sistemit, kur nga bashkia dhe strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së vlerësohet se ato janë gati dhe dëshirojnë një gjë të tillë. E drejta e përdorimit afat gjatë, jo më pak se 10 vjet dhe e përsëritshme, do t'u transferohet OPU-ve pasi ato të jene të afta dhe të vullnetshme për të marre të drejtat, përgjegjësitë dhe autoritetin për të qeverisur, menaxhuar dhe financuar shërbimet e ujitjes dhe për të mbrojtur sistemin nën juridiksionin e tyre.

Në çdo kohë pas transferimit, nëse MBZHR-ja përcakton se bashkia dështon të menaxhojë kanalet e parë/të dytë në pronësi të saj me standardin e menaxhimit të rënë dakord, pronësia e tyre mund të revokohet në mënyrë të njëanshme. Në një rast të tillë, strukturat përgjegjëse për

ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së merr përgjegjësinë deri në kohën kur bashkia apo OPU-ja bëhen të afta dhe dëshirojnë të marrin përsipër këtë përgjegjësi.

Masat për politikën e qeverisjes së sistemit dhe institucioneve

Struktura përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR synohet të fuqizohet duke përfshirë në përbërjen e saj sektorë për ngritjen e kapaciteteve, strategjinë dhe programet. Kjo strukturë do përgatisë politika, kuadrin ligjor, strategji, reformën institucionale dhe aktivitete zhvillimi, metodat teknike për projektimin e ujitjes dhe kullimit, metodat e menaxhimit dhe monitorimin e aktiviteteve.

Sektori për ngritjen e kapaciteteve do të përgatisë module trajnimi, do planifikojë programe trajnimi dhe trajnojë trajnuesit.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, do të jenë përgjegjëse edhe për administrimin e veprave të marrjes së ujit dhe kanaleve kryesore kryesisht në sistemet e mëdhenj ujitës. Ato do të mbikëqyrin përgatitjen e Planeve vjetore të shërbimit të ujitjes dhe monitorimin e performancës së menaxhimit të ujitjes. Procesi i zhvillimit institucional do të bazohet në një proces të përbashkët planifikimi, investimi dhe menaxhimi.

Udhëzuesit për ngritjen e OPU-ve, që janë përdorur më parë do të amendohen në përputhje me ndryshimet, nevojat dhe kapacitetet aktuale. Statuti i OPU-ve do të standardizohet dhe do të përdoret si bazë ligjore për regjistrimin e OPU-ve. Aktet nënligjore dhe rregulloret do të përcaktojnë rregullat e brendshëm, procedurat dhe sanksionet për OPU-të.

Roli fillestar i OPU-së do të jetë bashkëpunimi me njësinë e ujitjes dhe kullimit në hartimin e Planeve të Shërbimit të Ujitjes, buxheteve sipas nevojës dhe në përcaktimin e tarifës së shërbimit të ujitjes. Ajo gjithashtu do të punojë me GPU-të në nivel terciar, për të qenë të sigurt se punimet e mirëmbajtjes do të kryhen para se të fillojë sezoni i ujitjes. Ato do të koordinojnë përgatitjen e grafikëve të ujitjes dhe ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të sanksionuara me aktet nënligjore të tyre (OPU-ve). Pas një periudhe 5-vjeçare do të vlerësohet kapaciteti dhe vullneti i tyre për menaxhimin e ujitjes. Kur ato të jenë gati, atëherë do të marrin përgjegjësinë e menaxhimit dhe për rrjetin sekondar.

Njësia e Ujitjes dhe Kullimit e bashkisë do të trajnohet dhe jepet autoritet të menaxhojë rrjetin e kanaleve kryesore, sekondare dhe të treta si dhe shpërndarjen e ujit për ujitje në fermë në se nevojitet, kur GPU nuk janë krijuar akoma ose nuk janë të afta ta bëjnë këtë gjë. Deri sa GPU të jenë krijuar dhe bërë funksional, Njësia e Ujitjes dhe Kullimit mund të punojë me kryepleqtë e fshatrave për vjeljen e tarifave të ujitjes apo kryerjen e punimeve nga vetë fermerët për mirëmbajtjen dhe riparimin e kanaleve të treta. Njësia e Ujitjes dhe Kullimit ka përgjegjësinë për menaxhimin e kanaleve të dyta deri sa OPU të jenë të afta për ta bërë këtë.

Partneriteti Publik Privat (PPP) mund të përfshihet në këtë nivel, kur një kompani private mund të kontraktohet për të kryer shërbimet operacionale dhe ato të mirëmbajtjes në bazë kontrate. Shërbime të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen rutinë, riparime dhe rehabilitime të vogla. Një marrëveshje PPP mund të lidhet për menaxhimin e rrjetit sekondar dhe të tretë në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, dhe mund të shkojë edhe më tej, të menaxhimi i rrjetit kryesor e të veprat e marrjes në terma afatgjatë. Megjithëse shërbimet e menaxhimit mund t'i transferohen OPU-ve ose të bëhen me palë të treta në bazë marrëdhëniesh kontraktuale, menaxhimi financiar do të vazhdojë të bëhet apo mbikëqyret nga njësitë e ujitjes dhe kullimit.

Ekipi i Organizimit të Ujitjes në rajon do të përbëhet nga një person nga ministria, një nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe një nga bashkia përkatëse. Ata duhet të trajnohen dhe të fillojnë punë brenda një periudhe afatshkurtër. Gratë duhet të inkurajohen për të marrë pjesë dhe të inkurajohen që të japin mendimet e tyre në takime. Një specialist për zhvillimin institucional dhe një specialist për çështjet gjinore duhet të jenë anëtarë të Ekipit Organizativ të Ujitjes në nivel kombëtar. Ato duhet të përgatisin materiale trajnimi që do të përdoren në nivel rajonal dhe për OPU-të.

Pasi të jenë përcaktuar kufijtë dhe pronarët e tokës brenda zonës së shërbimit të ujitjes, Ekipi i Organizimit të Ujitjes do të mbledhë firmat e së paku 51% të pronarëve të tokës brenda zonës,

me takime apo dhe me vizita në shtëpi. Pas kësaj, Njësia e Ujitjes dhe Kullimit dhe kryepleqtë e përfshirë hartojnë planin e ngritjes së OPU-së.

Si fillim kjo mund të bëhet thjesht me koordinimin e kryepleqve, të cilët nga ana e tyre, koordinojnë veprimet me fermerët përdorues të ujit si p.sh. mirëmbajtjen e rrjetit të kanaleve të treta përpara fillimit të sezonit të ujitjes. Njësia e Ujitjes dhe Kullimit vendos komunikimin me kryepleqtë mbi planin e të mbjellave, grafikun e ujitjes dhe mirëmbajtjen e sistemit.

Bashkitë duhet të bien dakord për marrjen e përgjegjësisë së administrimit të ujitjes në standarde shfrytëzimi dhe mirëmbajtje të pranueshme, pasi më parë të jenë kryer përmirësimet në to. Marrëveshja e transferimi të administrimit ujitjes do të përfshijë angazhimin e OPU-së për mbulimin e kostos së shërbimeve të ujitjes në të ardhmen. Një udhëzues për transferimin e administrimit të ujitjes do të hartohet në një periudhë afatshkurtër. Mbas një përvoje 5-vjeçare, OPU-ja mund të kualifikohet për të marrë përgjegjësinë e administrimit të rrjetit sekondar. Megjithatë, përgjegjësia për mbikëqyrjen financiare dhe pronësia do vazhdojë të mbetet te bashkitë.

Nëse ekziston besim i mjaftueshëm midis fermerëve dhe shumica e tyre mbështesin idenë e ngritjes së OPU-së dhe GPU-së, Njësia e Ujitjes dhe Kullimit dhe kryepleqtë mund të fillojnë procedurat për ngritjen e OPU/GPU-ve. Ky proces përfshin përgatitjen dhe miratimin e statutit, rregulloreve, zgjedhjen e nëpunësve, trajnimin, regjistrimin ligjor dhe hartimin e Planit të shërbimit të ujitjes, buxhetit të bazuar në nevoja, vendosjen dhe mbledhjen e tarifës së shërbimit të ujitjes. Pastaj, vendimet e OPU-së merren nga votimi i anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, ose nga përfaqësues të tyre për çdo njësi terciare, nëse numri i anëtarëve do të jetë shumë i madh për tu akomoduar dhe Asambleja e Përfaqësuesve mbledhet çdo vit.

Bashkitë kanë përgjegjësinë e administrimit dhe financimit të sistemeve ujitëse. Bashkitë duhet të punësojnë specialistë (në varësi të sipërfaqes ujitëse nën administrim) për Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit. Këta punonjës duhet të vijjnë nga përvoja në fushën e bujqësisë dhe nëse do të ishte nga projektet e mëparshme të zbatuara në ujitje. Ata duhet të trajnohen në çështje të ndërtimit, administrimit, menaxhimit financiar etj. Si stafi i NJUK, ashtu dhe ato të OPU duhet të trajnohen gjerësisht.

Sistemet e ujitjes të transferuar te bashkitë duhen të rehabilitohen apo modernizohen me fondet e buxhetit të shtetit, vetëm nëse me bashkitë arrihet një marrëveshje për mirëmbajtjen dhe funksionimin siç duhet të tyre në vijimësi. Gjatë një periudhe fillestare 5-vjeçare njësitë e ujitjes dhe kullimit do të jenë administratorë të rrjetit të kanaleve të dyta ujitëse (apo sipas rastit edhe të para) dhe do të koordinojnë punën me kryepleqtë dhe fermerët në nivelin e terciareve për të mirëmbajtur kanalet dhe strukturat dhe mundësisht të shpërndajnë ujin te fermerët individualë.

Për ndërtimin e sistemeve të reja të ujitjes, duhet që më parë përdoruesit e ujit të firmosin një marrëveshje për formimin e GPU-ve që të administrojnë kanalet e treta, dhe OPU-të për kanalet e dyta dhe se përdoruesit garantojnë mbulimin e kostove të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së sistemit pas investimit.

Ministria dhe bashkitë do të mbështesin krijimin e OPU-ve në nivel kanalesh të treta. GPU-të do të ngrihen si grup përdoruesish brenda blloqeve terciare, jo si njësi të veçanta legale, por si pjesë përbërëse të OPU-ve. Në terma afatgjatë (8 deri 15 vjet) do të përcaktohet nëse OPU-të mund të bashkoheshin në federata për të marrë përsipër menaxhimin e kanaleve sekondare, sistemeve të vogla dhe të mesme.

Në pesë vitet e para pas ngritjes ose ringritjes së OPU-ve në nivel kanalesh të dyta, pritet që OPU-të së bashku me bashkitë do të kryejnë vetëm funksione administrative, të cilat nënkuptojnë përgatitjen dhe miratimin e Planeve të Shërbimit të Ujitjes, buxhetin dhe tarifën e shërbimit të ujitjes. Administrimi i kanaleve të dyta do të jetë kryesisht përgjegjësi e bashkisë në 5 vitet e para dhe do t'i transferohet OPU-ve kur ato të kenë dëshirë dhe të jenë të afta të administrojnë sistemin.

Mbas një periudhe prove 2–3-vjeçare, nëse OPU-të do të jenë të afta dhe dëshirojnë, të drejtat e përdorimit mbi kanalet e dyta dhe të treta do tu transferohen OPU-ve. Kjo do t'i jepte

përdoruesve të ujit besim se çdo investim i bërë prej tyre në kanalet e tretë dhe të dytë dhe në strukturat përkatëse do tu jepte atyre përfitime afatgjata, pa ndërhyrjen e shtetit, përjashtuar rastet kur OPU-ja dështon të menaxhojë dhe mbrojë sistemin.

Rolet dhe përgjegjësitë e qarta të organizatave në planifikimin, rehabilitimin dhe modernizimin, menaxhimin të përbashkët në nivel sistemit kryesor dhe terciar, dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të specifikohen më tej në procesin e zhvillimit institucional.

Stafi i OPU-së do të trajnohet dhe do të bashkë-menaxhojë kanalet e dyta me Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkisë, deri sa disa përgjegjësi të menaxhimin dhe autoriteti t'i jenë transferuar OPU-së. Përgjegjësitë për menaxhimin/mbikëqyrjen financiare për mbledhjen e të ardhurave, depozitimin në llogari bankare, tërheqja e parave, do të vazhdojë të mbetet te bashkitë për një periudhë afatgjatë.

Në pesë vitet e para pas ngritjes së OPU në nivel kanalesh të dyta, pritet që OPU-të së bashku me bashkitë do të kryejnë vetëm funksione administrative, të cilat nënkuptojnë përgatitjen dhe miratimin e planeve të shërbimit të ujitjes, buxhetin dhe tarifën e shërbimit. Administrimi i kanaleve të dyta do të jetë kryesisht përgjegjësi e bashkive dhe do t'i transferohet OPU-ve kur ato të kenë dëshirë dhe të jenë të afta të administrojnë sistemin.

Në marrëveshjet e transferimit do të specifikohen elementët e mëposhtëm:

1. Pjesa e sistemit ujitës, për të cilën transferohet e drejta e përdorimit, e shoqëruar me listën e kanaleve dhe veprave;
2. Miratimi i bashkisë që ka pronësinë mbi sistemin ujitës;
3. Organizata që ka të drejtat e pronësisë;
4. Organizata që do t'i transferohet e drejta e përdorimit;
5. Të drejtat, autoriteti dhe përgjegjësitë që transferohen së bashku me infrastrukturën;
6. Kushtet dhe procedurat për revokimin e të drejtave të përdorimit.

Revokimi i marrëveshjeve afatgjata të transferimeve mund të ndodhë në çdo kohë kur MBZHR-ja gjykon se bashkitë apo OPU-të kanë dështuar në administrimin e ujitjes apo kanë keqpërdorur autoritetin e tyre në administrimin e sistemit ujitës nën përgjegjësinë e tyre.

Pronësia e kanaleve kryesore dhe veprave të marrjes së skemave ujitëse të mëdha nuk do të transferohet. Megjithatë, në të ardhmen, administrimi i veprave të marrjes së ujitjes dhe kanaleve kryesore mund t'i transferohet me kusht dhe afatkohor kompanive private apo OPU-ve, si pjesë e ndonjë marrëveshje Partneriteti Publik Privat.

Incentiva për performancën dhe masa llogaridhënieje do të identifikohen gjatë hartimit të procesit të planifikimit, vendimmarrjes dhe funksioneve menaxheriale të këtyre organizatave. Planet vjetore të punës në nivele individuale apo si organizatë mund të shërbejnë si bazë për vlerësimin e performancës vjetore, në fund të çdo viti. Bazuar në legjislacionin në fuqi mund të jepen shpërblime për punonjësit që kanë pasur performancë të lartë. Këto mund të përfshijnë rritje të buxheteve, përmirësimin e kushteve të punës nëpërmjet pajisjes me kompjuterë, mjete transporti dhe trajnime shtesë. Sistemi i performancës duhet të jetë transparent dhe i qartë, dhe organizatat e përfshira, me përfshirjen e përdoruesve të ujitjes, duhet të vendosin se cilat do të jenë objektivat dhe standardet e performancës dhe se si do të monitorohen.

5.1.5 Politika për menaxhimin e sistemeve të ujitjes

Përmirësimet në cilësinë e menaxhimin të sistemeve ujitëse do të mbështeten fuqimisht. Ka një seri kriteresh performace sfiduese të cilat strukturat qendrore, bashkitë dhe OPU-të do të kërkojnë që të arrihen. Çdo sistem ujitës duhet të menaxhohet si një skemë hidraulike e vetme e integruar.

Strukturat Përgjegjëse për Ujitjen dhe Kullimin në Varësi të MBZHR-së do të ndihmojnë Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive në hartimin e Planeve të Shërbimeve të Ujitjes, në hartimin e buxheteve sipas nevojave si dhe do të sigurojnë drejtimin dhe koordinimin për gjithë sistemin e ujitjes në skemat e mëdha.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të koordinojnë hartimin e planeve vjetore të shërbimit të ujitjes për çdo skemë ujitëse që ndodhet në

juridiksionin e tyre dhe së bashku me bashkitë dhe OPU-të do të punojnë për të hartuar PSHU-të vjetore për të gjithë sistemin e për të gjithë sezonin ujitës. Ky plan do të bazohet në sasinë e ujit dhe grafikët e ujitjes të hartuara bashkërisht. Plani i përgatitur nga OPU-të do të jetë pjesë integrale e PSHU-së që hartohet në nivel skeme. Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të takohen periodikisht me bashkitë dhe OPU-të e skemave të vogla për siguruar asistencën e nevojshme teknike.

Për planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve të ujitjes do të ndiqet qasja e “kërkesës nga nevojat e modifikuara”. Kjo nënkupton që kërkesat për ujitje do të merren më parë se të fillojë sezoni i ujitjes. Këto grumbullohen dhe bëhet vlerësimi i kërkesave në total për të gjithë skemën dhe krahasohen me sasinë e ujit disponibël, duke bërë modifikimet përkatëse për shkak të kufizimeve për plotësimin e kërkesave me ujë që mund të ketë skema.

MBZHR-ja do të kërkojë fonde dhe bashkëpunim për kërkime mbi teknologjitë e ujitjes dhe inovacionet në menaxhim. Qeveria mbështet aplikimin e teknologjive moderne dhe metodat e menaxhimit që do të mundësonin ofrimin eficient, të barabartë dhe në kohë të shërbimeve të ujitjes.

Që fermerët të paguajnë sipas volumit të ujit të përdorur për ujitje, është e nevojshme që në kanalet ujitëse të instalohen pajisje matëse, së paku deri në nivelin e prizave në kanalet e treta. Sasia e ujit që përdor çdo fermer afërsisht mund të ishte sa sasia e ujit në kanali e tretë pjesëtuar me numrin e fermerëve që marrin ujë nga po ky kanal i tretë.

Trajnime mbi konfliktet dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të ofrohen për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe OPU-të. Konfliktet që lidhen me ujitjen dhe shkëljen e rregullave duhet të zgjidhen sa më shpejt të jetë e mundur dhe në mënyrë të drejtë. Mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve të ujit duhet të zgjidhen me ndërmjetësim midis palëve të përfshira.

Masat për politikën e menaxhimit të sistemeve ujitëse

Në kriteret kryesorë të performancës përfshihen shpërndarja e barabartë e sasisë së ujit, koha e shpërndarjes në përputhje me grafikun e ujitjes, eficienta e ujitjes, shpërndarja e barabartë si për fermerët në fillim të kanalit ashtu dhe për ata në fund të kanalit, cilësia e mirëmbajtjes dhe funksionalitetit të skemës, shkalla e mbledhjes së tarifave, rendimenti i prodhimit për njësi sipërfaqe të ujitur dhe qëndrueshmëria e skemës ujitëse.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të takohen një herë në muaj me njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të dhe do t'i ndihmojnë ato në hartimin e planeve të shërbimeve të ujitjes, buxhetit sipas nevojave, monitorimin sezonal të Planit, këshilla për çështje teknike financiare dhe institucionale sipas nevojave, do ndihmojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe do marrë pjesë në auditimet e administrimit të ujitjes çdo dy vjet.

Plani i Shërbimeve të Ujitjes do të hartohet çdo vit, së paku një muaj para fillimit të sezonit të ujitjes. Ky plan normalisht përbëhet nga shtatë komponentë. Ata janë:

1. Përcaktime të matshme të standardeve të shërbimit që do të sigurohen, si shpërndarja dhe furnizimi i ujit, mirëmbajtja e sistemit etj.;

2. Shërbimet (p.sh. lëvizja e ujit, shpërndarja, kullimi);

3. Mirëmbajtja dhe riparimet apo përmirësimet që duhen;

4. Buxheti, tarifa e shërbimit të ujitjes dhe procedurat e administrimit financiar;

5. Aktivitetet menaxheriale dhe institucionale;

6. Monitorimi i performancës së administrimit dhe aspekteve mjedisore; dhe

7. Mbajtja e proces-verbaleve dhe përgatitja e raporteve.

Dy muaj përpara se të fillojë sezoni i ujitjes, çdo OPU paraqet në bashki, kërkesat e tyre për ujë, planin e të mbjellave dhe marrëveshjet me fermerët që kërkojnë ujitje. Këto përfshijnë emrat e fermerëve, datat e mbjelljeve dhe kohën kur pritet ujitja e parë.

MBZHR-ja do të bashkëpunojë sipas nevojës me konsulentë, qendrat e ekselencës dhe donatorë për identifikimin dhe adoptimin e teknologjive moderne të ujitjes për të përmirësuar

eficiencën, leverdishmërinë dhe kritere të tjera të performancës që kanë rëndësi të veçantë për vendin. Përpyqje do të bëhen edhe për sigurimin e fondeve për kërkim diagnostik dhe aplikativ nga institutet dhe universitetet shqiptare, për aspekte teknike, financiare dhe menaxheriale të performancës së sistemeve të ujitjes.

Pagesa e kostos së sasisë së ujit të siguruar për ujitje fermerëve kërkon që volumi i ujit të matet dhe kjo është e kuptueshme. Minimalisht, është e nevojshme të instalohen pajisjet matëse në veprat e marrjes, në kanalet kryesorë, në sekondarë dhe në prizat e kanaleve të tretë.

Për sa i takon blloqeve terciare, që mbulohen nga kanalet e treta nuk do të ishte praktike të mateshin volumet për çdo fermë, por mund të bëhet me përafërsi. Kjo mund të nënkuptonte që fermeri mund të paguante për sasinë e ujit, bazuar në ndarjen e sasisë së ujit në kanalën e tretë dhe përqindjen e përafërt të sasisë që ka marrë ai krahasuar me fermerët e tjerë, që furnizohen nga i njëjti kanal i tretë.

Shkelja e rregullave duhet të adresohet shpejt dhe në mënyrë të drejtë me aplikimin e sanksioneve të parashikuara në aktet përkatëse të bashkisë apo OPU-ve. Shkeljet e para mund adresohen me paralajmërime të buta, nëse ato të përsëritura me ndëshkime më të rënda.

Mosmarrëveshjet apo konfliktet janë një çështje tjetër. Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive dhe OPU-të duhet të kenë staf të trajnuar për zgjidhjen e tyre. Ndërmjetësimet bëhen kur dy apo më shumë persona, që kanë një problem me ujitjen, takohen së bashku për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për pretendimet e tyre.

Personi i trajnuar e çon diskutimin drejt një zgjidhje që mund të pranohet nga të dy palët që janë në konflikt. Vetëm nëse ndërmjetësimi dështon, atëherë palët mund t'i drejtohen një pale të tretë për zgjidhjen përfundimtare të konfliktit. Zgjidhjet e konflikteve do të jenë pjesë e moduleve të trajnimit për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të.

5.1.6 Politikat për financimin e ujitjes

Synimi është të përmbysët prirja e dekadave të fundit e një mirëmbajtjeje në nivele të ulëta dhe degradimi i sistemeve ujitëse dhe të arrihet një nivel optimal i mirëmbajtjes së tyre. Kjo do të realizohet me mbështetje dhe me kapacitete institucionale të ngritura, nëpërmjet punës së përbashkët të strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-ve.

MBZHR-ja do të hartojë një udhëzues për buxhetin sipas nevojave dhe tarifave të shërbimit të ujitjes. Tarifa e shërbimit të ujitjes (TSHU) do të vendoset për çdo skemë ujitëse dhe bazohet në kostot faktike për funksionimin e skemës për sigurimin e shërbimit të ujitjes të rënë dakord me fermerët, siç është përcaktuar në buxhetin e bazuar në nevoja. Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë, në bashkëpunim me OPU-të, do të hartojnë buxhetin vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të përshkruara në Planin e Shërbimit të Ujitjes, i cili hartohet sipas një performancë standarde, e cila garanton funksionimin normal të skemës ujitëse. Çdo skemë ujitëse do të menaxhohet si një njësi e pandarë financiare. Çdo skemë ka koston e saj dhe buxhetin e saj, në varësi të specifikave të veta.

Pritshmëria është që për të gjitha skemat ujitëse të hartohen dhe zbatohen buxhete “bazuar mbi nevoja” ose buxhete “bazuar në performancë”. Këto janë buxhete që bazohen tërësisht në arritjen e standardeve të kënaqshëm të performancës për mirëmbajtjen dhe veprimtarinë e ujitjes me mjetet më eficiente dhe pragmatike. Megjithatë, në të ardhmen, ato mund të përmbajnë kontribute për krijimin e fondit kapital rezervë.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të ndihmojnë njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe OPU-të në hartimin e buxheteve dhe përcaktimit të TSHU-së.

Bashkitë do të jenë përgjegjëse të mbledhin kostot fikse të ujitjes nga të gjithë pronarët e tokës në zonat e mbuluara me shërbim nëpërmjet zyrës së tyre të taksave. Ato duhet të përdoren për buxhetin bazuar në performancën, ose kur është rënë dakord me anëtarët e OPU-ve, për të krijuar fondin kapital rezervë, i cili përdoret për riparime emergjente dhe të parashikuara, rehabilitime të vogla, zgjerimin e kanaleve dhe përmirësime. Kostot përbëhen nga kostot fikse

dhe kostot variabël. Kostoja fikse vendoset çdo vit, pavarësisht nëse ka reshje apo kërkesa për ujitje dhe përdoret për mirëmbajtje, kostot për zyra, staf etj. Kostoja variabël ndryshon dhe përdoret për kostot e shpërndarjes së ujit sipas kërkesave që bëjnë fermerët për shërbime ujitje.

Që të funksionojë mbledhja e TSHU-së, është e rëndësishme që të krijohet besimit të fermerët se tarifat që mblidhen përdoren siç duhet dhe për qëllimin që janë mbledhur. Janë shumë të rëndësishme masat që sigurojnë se paratë e grumbulluara përdoren për zbatimin e PSHU-së. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm mund të luajë dhe teknologjia moderne e informacionit. Sistemi duhet të jetë i projektuar për të parandaluar joefikasitetin dhe korrupsionin.

Parimi “paguaj vetëm për shërbimet e mara faktikisht” do të vendoset për shërbimet e ujitjes kudo në të gjithë vendin. Në ujitje, parimi “paguaj për shërbimin”, nënkupton gjithashtu se “fermerët nuk do të paguajnë për shërbimet e pamarrë”. Kjo do të thotë se çdo fermer individual përdorues i ujit paguan plotësisht vetëm nëse merr ujin për të cilin ka rënë dakord si në sasi ashtu dhe në kohë. Fillimisht, fermerët paguajnë për shërbimin dhe pastaj e marrin atë, por kur shërbimi nuk kryhet, pagesa i'u kthehet mbrapsht për pjesën që nuk morën këtë shërbim.

Masat për politikën e financimit të ujitjes

Me qëllim që sistemet e ujitjes dhe kullimit të bëhen produktivë dhe të qëndrueshëm financiarisht, kostot duhet të mbulohen kryesisht nga pagesat e përdoruesve të ujit, pronarët apo qiramarrësit e tokave që marrin shërbim, nga bashkitë dhe nga buxheti i shtetit për rehabilitimin e digave, veprave të marrjes së ujit dhe kanaleve të parë që administrohen nga MBZHR-ja apo bashkitë.

Pagesat e kostove fikse për ujitjen (si kostot vjetore të mirëmbajtjes, për stafin, zyrat etj.) do të mblidhen nga zyra e taksave të bashkive, në fillim të vitit si çdo taksë tjetër që mblidhet nga bashkitë. Kostoja variabël e ujitjes varet nga shërbimi që do të kërkojnë fermerët. Ajo do të paguhet në bashki përpara dhe gjatë sezonit të ujitjes si pagesë direkte në zyrat e bashkisë ose si transfertë bankare.

Për hartimin e buxheteve sipas nevojës duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi dhe dakordësia për shërbimet e dëshiruara;
2. Identifikimi dhe pranimi i standardeve të ofrimit të shërbimit;
3. Identifikimi i zërave të punimeve, volumeve të punës dhe specifikimeve të tyre;
4. Pranimi i standardeve financiare, të tilla si çmimet për njësi;
5. Hartimi i Planit të Shërbimit të Ujitjes;
6. Hartimi i buxhetit sipas nevojave;
7. Përcaktimi i tarifës së shërbimit të ujitjes që siguron fondin për buxhetin.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së së bashku me njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të takohen çdo fillim viti për hartimin e Planit të Shërbimit të Ujitjes, buxhetit dhe tarifës së shërbimit të ujitjes. Më pas shkohet në këshillin bashkiak ku dhe kërkohej miratimi i buxhetit dhe tarifës.

Kur sistemi ujitës bëhet financiarisht i qëndrueshëm, bashkitë dhe OPU-të do të nxiten të krijojnë një fond rezervë, i cili mblidhet çdo vit dhe do të përdoret për mbulimin e kostove fikse të menaxhimit të sistemit ujitës.

Kostot fikse për ujitjen (mirëmbajtje, zyra, staf) do të mblidhen nga bashkitë nga të gjithë pronarët e tokave brenda zonës së shërbimit të sistemit ujitës, pavarësisht nëse ata zgjedhin të ujitin ose jo. Kostot variabël i ngarkohen vetëm fermerëve që kërkojnë ujitje dhe kjo duhet të bëhet sa më shumë të jetë e mundur, bazuar mbi sasinë e ujit të kërkuar dhe atë të dhënë.

Fermerët kanë përfituar tokë, nëpërmjet reformës së ndarjes së tokës, çka nënkupton që toka do të përdoret për qëllime bujqësore. Zhvillimi i ujitjes është pjesë e investimeve që qeveria bën për zhvillimin e bujqësisë. Nga fermerët pritet që ta mirëmbajnë investimin dhe jo të lejojnë shkatërrimin e tij.

Pagesa e kostove fikse nga të gjithë pronarët apo qiramarrësit e tokës është i justifikueshëm, pasi sigurimi i një shërbimi të mundshëm ujitje rrit vlerën e tokës si për shitje ashtu dhe për

dhënie me qira. Nëse të gjithë pronarët e tokës do të paguanin kostot fikse, detyrimi për çdo fermer do të ishte më i ulët dhe më i përballeshëm. Nga ana tjetër, kostot variabël do të ishin gjithashtu më të ulëta për përdoruesit e ujit, krahasuar me tarifën aktuale, pasi kjo kosto do ishte e zhveshur nga kostot fikse bazë.

Bashkia do të vlerësojë dhe mbledhë koston fikse, e cila do të jetë “tarifa bazë e ujitjes”, që përdoret vetëm për këtë qëllim, dhe shumën e mbledhur e depoziton në llogari bankare të mbajtura nga bashkia dhe/ose OPU-ja, dhe kjo shumë do të përdoret vetëm në skemën ujitëse përkatëse, për zbatimin e Planit të Shërbimit të Ujitjes.

Bashkitë do të vazhdojnë rolin e tyre për mbledhjen dhe depozitimin e të ardhurave nga kostot fikse edhe pasi përgjegjësia për administrimin e rrjetit të kanaleve të dyta ujitës do t'i kalojë OPU-ve. Bashkitë do të kenë dy llogari bankare: një për shpenzimet vjetore të M dhe Sh-së dhe një tjetër për fondin kapital rezervë, i cili mund të përdoret në një të ardhme për rehabilitime e investime.

MBZHR-ja do të hartojë procedura të reja për pagesën dhe depozitimin si për tarifën fikse, e thënë ndryshe Tarifa Vjetore e Mirëmbajtjes (TVM), ashtu dhe për koston variabël apo ndryshe Tarifën e Shërbimit të Ujitjes (TSHU). Paga për TVM, e cila mbulon kostot fikse bazë, do bëhet si për taksat dhe tarifën e tjera të vendosura nga bashkia. Ajo do të vendoset mbi këdo që zotëron apo merr me qira një tokë, brenda zonës potenciale të shërbimit të të ujitjes. Paga nga pronarët/qiramarrësit mund të bëhen direkt në zyrat e taksave në bashki ose nëpërmjet transfertave bankare.

Përdorimi i fondeve do të bëhet duke qenë Njësia e Ujitjes dhe Kullimit e bashkisë si firmë e parë e autorizuar dhe OPU-ja si firmë e dytë. Paga për Shërbimin e Ujitjes do të kryhen 50% përpara sezonit të ujitjes dhe 50% në mes të sezonit të ujitjes. Kjo mënyrë minimizon apo eliminon veprimet me para në dorë dhe çdo gjë bëhet si për taksat e tjera të bashkisë ose nëpërmjet transfertës bankare. Kjo rrit transparencën dhe minimizon mundësitë për keqpërdorim të fondeve.

Masa të tjera shtesë do të merren për të parandaluar keqpërdorimin e fondeve në nivel bashkiak, të tilla si përdorimi i auditimeve të brendshme dhe kontrolli i llogarive.

TSHU-ja nga fermerët do të mbledhet në zyrat e taksave pranë bashkive, përpara se të fillojë sezoni i ujitjes. Së pari, bashkitë do të duhet të hapin llogari për kostot fikse e variabël. Së dyti, ato duhet të vendosin parimin “pagesë për shërbim”. Kjo do të thotë se paga për ujin e kërkuar të bëhet e plotë përpara furnizimit me ujë, dhe më pas bëhet rimbursim për ndonjë shërbim që nuk është kryer. Së treti, duhet të bien dakord për standardin e shërbimit që do të sigurohet, duke dhënë një përcaktim praktik dhe të matshëm. Së katërti, gjatë sezonit të ujitjes bashkitë monitorojnë shërbimin e ujitjes (si ai që merret dhe ai që nuk merret) për çdo fermer që ka kërkuar ujitje. Së pesti, mbahen shënime për çdo kërkesë për ujë dhe kohën kur kryhet shërbimi për çdo fermer. Së gjashti, nëse fermeri nuk merr gjithë shërbimin për të cilin ka paguar, paga e tij do të reduktohet në mënyrë proporcionale.

5.1.7 Ngritja e kapaciteteve

Do të hartohen, së paku, 12 module trajnimi për teknologjinë, qeverisjen, menaxhimin dhe financimin e ujitjes. Është prioritarë ngritja e kapaciteteve për qeverisjen, menaxhimin dhe financimin e sistemeve të ujitjes nga bashkitë. Këtu përfshihet, sipas rastit, administrimi i rrjetit të kanaleve të dyta dhe të para dhe mbështetja e OPU-ve në administrimin e rrjetit të kanaleve të dytë dhe të tretë. Trajnime do kryhen edhe për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU për teknologjinë, qeverisjen, menaxhimin dhe financimin e ujitjes. Do të punohet edhe për ngritjen e kapaciteteve brenda GPU-ve në nivel kanalesh të treta dhe OPU-ve në nivel kanalesh të dyta. OPU-të do trajnohen për të 12 aspektet e lidhura me qeverisjen, menaxhimin dhe financimin e ujitjes në nivelet sekondare dhe terciare, kërkesat dhe ofrimin e shërbimeve të ujitjes, njohuritë bazë mbi hidromodulin e ujitjes dhe funksionet e menaxhimit financiar.

Module shtesë trajnimi do të përgatiten për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në

varësi të MBZHR-së për aspektet rregullatore, konsultimet që lidhen me menaxhimin, Planet e Përmirësimit të Ujitjes dhe shërbimet mbështetëse. Kapacitetet e tyre do të rriten për menaxhimin e veprave të marrjes dhe kanalet e parë, përgatitjen e Planit të Shërbimit të Ujitjes, aspektet rregullatore të sektorit të ujitjes brenda territorit të tyre si dhe për ngritjen e kapaciteteve të bashkive dhe OPU-ve. Konsultimet për menaxhimin do të jenë në formën e trajnimit dhe zgjidhje të problemeve nga një specialist me përvojë në menaxhimin e ujitjes.

Konsultime për menaxhimin do të zhvillohen nga strukturat përgjegjëse për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja në varësi të MBZHR-së dhe njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive kur ato të kenë përvojë të mjaftueshme të asistojnë bashkitë/OPU-të në përgatitjen e Planeve të përmirësimit të menaxhimit.

Trajnimi në salla nuk duhet të jetë e vetmja metodë për ngritjen e kapaciteteve të bashkive dhe OPU-ve. Stafet e bashkive dhe OPU-ve kanë nevojë për konsultime në terren, në administrimin në praktikë të sistemit të ujitjes.

Një udhëzues për zbatimin e mundshëm të Partneriteteve Publik Privat (PPP) do të përgatitet nga MBZHR-ja, ndërsa strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj do të identifikojnë mundësitë për të punuar me sektorin privat. Në të ardhmen, do të bashkëpunohet më shpesh me sektorin privat, për identifikimin dhe kryerjen e shërbimeve të ujitjes për bashkitë dhe OPU-të, për të rritur kapacitetin e tyre në administrimin e sistemeve ujitës, sigurimin dhe financimin e shërbimeve të ujitjes.

Në strukturën përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR do të përfshihet një Sektor për Ngritjen e Kapaciteteve. Ngritja e kapaciteteve të administrimit dhe zhvillimit të ujitjes duhet konsideruar si një proces afatgjatë, që nevojitet të përsëritet edhe për shkak të ndryshimeve që ndodhin në stafet e agjencive, bashkive dhe OPU-ve.

Ky sektor do të zhvillojë trajnime për aspekte të tilla si përgatitja dhe zbatimi i Planeve të shërbimit të ujitjes, përgatitja e buxheteve bazuar mbi nevojat, caktimi dhe mbledhja e tarifave të shërbimit të ujitjes, krijimi i OPU-ve, takimet dhe lidhshëritë, menaxhimi financiar, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, auditimet e menaxhimit të ujitjes, përgatitja e planeve afatshkurtra të veprimit etj.

Masat për politikën e ngritjes së kapaciteteve

Njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive do të duhet të trajnohen si për aspektet teknike të administrimit të ujitjes ashtu dhe qeverisjen, menaxhimin dhe financimin. Është e nevojshme që trajnimi të përfshijë çështjet e mëposhtme:

1. Hartimi dhe zbatimi i PSHU-së, bazuar në standarde performance të pranuar nga palët;
2. Menaxhim financiar, buxhetim mbi bazë nevojash, tarifa e shërbimit dhe mbajtja e llogarive, transparenca;
3. Inventarizimi i funksionalitetit të infrastrukturës, administrimi i aseteve dhe planifikimi i kostove kapitale;
4. Prokurimi dhe administrimi i kontratave;
5. Bashkëpunimi publik-privat në menaxhimin me pjesëmarrje;
6. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i digave dhe rezervuarëve;
7. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i stacioneve të pompimit;
8. Ligjet dhe rregulloret mbi ujitjen dhe kullimin;
9. Administrimi i ujit, monitorimi i performancës dhe mbajtja e të dhënave;
10. Ngritja e OPU-ve dhe administrimi i ujitjes me pjesëmarrje;
11. Metodatat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
12. Auditimet e menaxhimit të ujitjes.

Module trajnimi do të përgatiten për secilën nga çështjet e mësipërme brenda një periudhe afatshkurtra dhe trajnimi do të fillojë sapo të gjenden fondet dhe organizata trajnuese mund të iniciojë trajnimin. Trajnimi i strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe njësitë të U dhe K të bashkive do të jetë prioriteti i parë dhe më pas vjen krijimi dhe trajnimi i OPU-ve. Ky trajnim do të vazhdojë për çdo vit dhe për një kohë të gjatë.

Trajnimi do të bëhet për të gjithë stafin e strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe njërive të U dhe K të bashkive, stafin e OPU-ve dhe përfaqësuesve të GPU-ve si administratorë të rrjetit të tretë të kanaleve ujitës. Trajnimi do të bëhet me afate fleksibël për të mundësuar pjesëmarrjen. Në trajnim do të përfshihen edhe stafe apo individë, të cilët janë kontraktuar nga OPU-të për të kryer funksione të shfrytëzimit, mirëmbajtjes apo mbledhjes së tarifave.

Stafi i strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të trajnohet edhe në 3 çështje shtesë, përveç 12 të përmendura më lart:

1. Si monitorohen/mbikëqyren njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe OPU-të;
2. Si organizohen konsultime për të ndihmuar njësitë e ujitjes dhe kullimit dhe OPU-të në hartimin e planeve të përmirësimit të menaxhimit;
3. Si identifikohen nevojat e njërive të ujitjes dhe kullimit dhe OPU-ve për shërbime mbështetëse;
4. Metodot e komunikimit dhe vendimmarrjes.

Modulet e trajnimit për këto çështje duhet të hartohen brenda një periudhe afatshkurtër si dhe trajnimi duhet të zhvillohet po brenda një periudhe afatshkurtër.

Synohet që ngritja e kapaciteteve të njërive të ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe stafeve të OPU-ve, të bëhet nëpërmjet konsultimeve periodike, ku audituesit do të shqyrtojnë problemet dhe sfidat e sistemit të ujitjes, inspektojnë vendet problematike dhe ndihmojnë bashkitë dhe OPU-të në hartimin e planeve të përmirësimit të menaxhimit.

Kontaktorë lokalë apo kompani të vogla private mund të identifikohen dhe informohen nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së mbi mundësinë e partneritetit publik privat në administrimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet lidhjes së kontratave me to apo bashkitë. Në këto shërbime mund të përfshihen mirëmbajtja dhe riparimet, rehabilitimi dhe modernizimi, shërbimet e ujitjes, operimi i stacioneve të pompimit, mbajtja e llogarive, çështje ligjore, financiare, bankare si dhe marrja e huave.

Në periudha afatshkurtra deri afatmesme, sektori për ngritjen e kapaciteteve do të sigurojë trajnime gjatë periudhave të caktuara të vitit, kryesisht para fillimit të sezonit të ujitjes. Në të do të ketë staf që do të mbledhë të dhëna prej strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, për rezultatet e auditimeve të menaxhimit të ujitjes, dhe në bazë të tyre do të përcaktojë se cilat janë çështjet ku do të fokusohet trajnimi dhe i nevojave të trajnimit. MBZHR-ja do të sigurojë fondet dhe stafin e nevojshëm për ngritjen e këtij sektori sa më shpejt të jetë e mundur.

5.2 Komponenti strategjik 2: Objektivat dhe masat për kullimin

5.2.1 Politika për zhvillimin e sistemeve të kullimit

Rehabilitimi/modernizimi dhe mirëmbajtja ciklike vjetore e rrjetit të kanaleve kulluese dhe 29 stacioneve të pompimit të kullimit (hidrovorëve), të vendosur në ultësirën perëndimore të vendit është prioritet. Për këtë qëllim do të përgatitet një plan i veçantë me ndërhyrjet dhe buxhetet përkatës. Kullimi jo i mirë dhe prania e ujit në sipërfaqet bujqësore si pasojë e mosfunksionimit sipas standardeve teknike të kanaleve kulluese dhe hidrovorëve e bën të domosdoshëm rehabilitimin dhe modernizimin e tyre. Po kështu, ka shumë rëndësi që përpara se të fillojë rehabilitimi/modernizimi duhet që të përcaktohet dhe buxheti për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së kullimit.

Gjithashtu, duhet të përcaktohen se cilat janë nevojat për ndërhyrje në sistemin kullues ekzistues për të ruajtur kapacitetin e projektuar dhe nevojat për rritjen e kapaciteteve të kullimit. Kullimi është i rëndësishëm, jo vetëm sepse mbrohet vlera e tokës për qëllime prodhuese, por edhe parandalon dëmin dhe dëmtimet e pasurisë së njerëzve. Në shumë zona, kullimi është i lidhur me ujitjen dhe është një parakusht për ujitjen e duhur. Është prioritarë që zonat problematike nga kullimi të eliminohen plotësisht brenda një periudhe afatmesme duke barazuar volumet e mbushjes me ato të pastrimit/ largimit të dherave në kanalet kullues.

Masat për politikën për zhvillimin e sistemeve të kullimit

MBZHR-ja, së pari, do të planifikojë, financojë dhe zbatojë një program rehabilitimi dhe modernizimi për 14 hidrovorë të ultësirës perëndimore. Si fillim, do të përcaktohet se në çfarë mase punimet mund të financohen nga buxheti dhe se ku mund të gjendet pjesa tjetër e financimit.

Një studim do të ndërmerret për masën e rritjes së kapaciteteve të rrjetit kullues. Ky studim do të identifikojë vendet ku duhet që sistemi i kullimit të ridimensionohet duke rritur aftësinë përcjellëse të kolektorëve, të kanaleve të parë dhe në vijim. Studimi do të identifikojë gjithashtu edhe zonat ku nuk ka sistem kullimi dhe ai duhet të ndërtohet në mënyrë që risku nga përmbytjet të zvogëlohet.

Mungesat evidente të ekskavatorëve dhe dragave kanë qenë faktor kryesor në shkallën e ulët të largimit të dherave nga kanalet. Synohet një proces largimi dherash më intensiv dhe të barazuar me sasinë e mbushjes së kanaleve. Në afatshkurtër kërkohet që të bëhen përpjekje për rritjen e koeficientit të shfrytëzimit të ekskavatorëve dhe dragave duke përmirësuar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Disa ekskavatorë dhe draga janë në fund të periudhës së shfrytëzimit të tyre. Në afatmesëm një pjesë prej tyre duhet të zëvendësohen.

5.2.2 Politika për administrimin e sistemeve të kullimit

MBZHR-ja do të vlerësojë gjendjen e kullimit dhe do të bëjë rekomandime dhe përgatisë udhëzues për një sistem kullimi të përshtatshëm. Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së janë përgjegjësit kryesorë për të siguruar funksionimin e kolektorëve dhe kanaleve kryesorë kullues nëpërmjet kryerjes së punimeve të pastrimit me ekskavatorë apo draga.

Ndërsa Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive janë përgjegjëse për funksionimin e rrjetit të kanaleve kullues të transferuar në pronësi të tyre.

Në sistemet e kullimit që janë të shoqëruara me sisteme ujitëse, grupet e përdoruesve të ujit do të administrojnë rrjetin e tretë të kanaleve kullues, ndërsa OPU-të do të marrin përgjegjësinë e pastrimit të rrjetit të dytë.

Për sistemet e kullimit, të cilat nuk janë pjesë e sistemeve të ujitjes, do të synohet të krijohen shoqata të kullimit, që përbëhen nga të gjithë anëtarët që zotërojnë toka, ndërtesa apo pasuri të tjera, brenda zonës së kullimit. Ato do të jenë përgjegjëse për pastrimin e kanaleve të treta kulluese, ndërsa strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë do të pastrojnë respektivisht kanalet kryesorë.

MBZHR-ja dhe strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj do të kujdesen që punimet të kryhen në mënyrën e duhur po ashtu dhe makineritë të përdoren si duhet. Gjithashtu, do të bëhen më shumë përpjekje që ekskavatorët dhe dragat të jenë në terren çdo ditë për të kryer pastrimet sipas grafikëve të miratuar duke funksionuar në mënyrë eficiente dhe efektive

MBZHR-ja do të kryejë vlerësimin e stafit, pajisjeve dhe sigurojë buxhetin e nevojshëm për pastrimin e kanaleve kullues sipas standardit ndërsa strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj duhet të vlerësojnë kapacitetet e tyre për pastrimin e kanaleve të parë dhe kolektorëve në terma të matshëm, gjatësi kanali dhe volume germimi, mbi baza mujore dhe ta krahasojë me nivelin e mbushjeve për të gjykuar se cilat do të jenë nevojat për të rritur kapacitetet e tyre.

Objektivi final i administrimit të sistemit kullues, pasi të jenë kryer punimet e pastrimit për ti kthyer në parametrat e projektit, do të jetë pastrimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit për të kontrolluar nivelin e mbushjeve që të mos cenohet kapaciteti përcjellës i kanaleve. Kjo do të thotë që strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së duhet të rrisin volumet e punës vjetore të pastrimit në atë masë që të mos lejojnë mbushjen e kanaleve.

Hartimi dhe zbatimi i planeve të pastrimit të kanaleve behet në mënyrë paralele midis strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, bashkive dhe mundësisht OPU-ve për të nxitur pastrimin në rrjetin e dytë dhe tretë të kanaleve kullues, paralelisht me pastrimin e kolektorëve dhe kanaleve të parë.

Masat për politikën për administrimin e sistemeve të kullimit

MBZHR-ja do të përgatisë rekomandime dhe udhëzime për punimet e kullimit në të gjitha nivelet. Duhet të ndërmerret një studim mbi punimet që kryhen aktualisht në sistemin e kullimit, ndoshta mbi baza kampionesh, nga ku do të rezultojë nëse punimet e pastrimit kryhen si duhet dhe nëse parametrat e projekteve duhen të modifikohen si pasojë e punimeve të pastrimit të bëra jo si duhet. Gjithashtu, makinerisë së rëndë (ekskavatorë, draga, mjete motorike të tonazhit të lartë etj.) do t'u montohen pajisje GPS me anë të cilave bëhet monitorimi në kohë i vendndodhjes dhe kohës së punës nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive.

Duke hartuar një inventar të sistemit primar dhe kolektorëve kullues, strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të vlerësojnë nevojat për staf, makineri dhe buxhetin që kërkohet për të mbajtur rrjetin kullues të pastër në nivelet e projektit. Mbi këtë bazë, ministria do të mobilizojë edhe burimet e financimit.

Strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të caktojnë prioritetet për pastrimin e kanaleve kryesore dhe kolektorëve si dhe identifikojnë sistemet e kullimit që kanë nevojë për rehabilitim apo zgjerim. Në fillim të një periudhe afatmesme ato duhet të organizojnë takime me njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të për të hartuar plane integrale pune ku do të përcaktohen bashkërisht kanalet ku do të ndërhyhet dhe koha e ndërhyrjes. Kjo pasi pastrimi i një niveli të vetëm kullues nuk jep rezultatet e pritshme, duhet që rrjeti kullues të pastrohet në të tre nivelet e tij. Për këtë ndoshta do të duhen dhe incentiva dhe mekanizma llogaridhënieje, siç mund të ishte kërkesa për pastrimin e kanaleve të treta dhe të dyta çdo vit përpara se të pastrohen kanalet e para.

5.2.3 Politika për financimin e kostos së sistemeve të kullimit

Do të bëhet një analizë ekonomike e kostos së energjisë për hidrovorët dhe për punimet e gërmimit të kanaleve të para dhe kolektorëve. Kostoja e energjisë është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit. Ku është e domosdoshme, qeveria do të vazhdojë të paguajë koston e energjisë elektrike për këtë qëllim.

Kullimi është një funksion publik, por kjo nuk do të thotë se të gjitha punët e pastrimit, riparimit, zgjerimit të rrjetit kullues duhet të mbulohen me fondet e buxhetit. Tarifat për shërbimin e kullimit, do të mbledhen nga të gjithë përfituesit duke paguar një pjesë të kostos së shërbimit të kullimit. Kosto e pastrimit të kanaleve të tretë në nivel ferme duhet të mbulohen eventualisht nga OPU-të, nëse ato funksionojnë.

Në skemat e kullimit, të cilat shoqërohen me skema ujitëse, pastrimi i kanaleve të para dhe kolektorëve do të jenë përgjegjësi e MBZHR-së/bashkisë dhe financohet nga buxheti.

Kostot e pastrimit të kanaleve sekondarë dhe kryesorë në pronësi të bashkive do të mbulohen nga bashkitë. Bashkitë do të përfshijnë edhe një pagesë, e cila do të jetë vjetore, që do të paguhet nga OPU-të dhe organizatat e kullimit për mbulimin e një pjese të kostos për pastrimin e kanaleve sekondare dhe kryesorë për punimet me ekskavatorë.

MBZHR-ja do të përgatisë një studim për identifikimin e pronarëve të tokave, ndërtesave dhe përfituesve të tjerë brenda sipërfaqes së shërbimit të kullimit. Është e nevojshme që MBZHR-ja dhe strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të saj të identifikojnë të gjithë pronarët e tokës, ndërtesave dhe aseteve të tjera, që ndodhen brenda zonave të shërbimit të kullimit dhe janë përfitues si dhe të agjencive përgjegjëse për rrugët, hekurudhat, ujësjellësit, linjat telefonike etj., që kalojnë nëpër këto zona shërbimi kullimi.

Ajo pjesë e shërbimit për të cilën nuk identifikohen përfitues të drejtpërdrejtë do të konsiderohet si shërbim publik dhe si e tillë do të mbulohet me fondet e buxhetit.

Masat për politikën për financimin e kostos së sistemeve të kullimit

Do të bëhet një analizë ekonomike për koston e energjisë për hidrovorët, mundësinë e pronarëve të tokës për të paguar dhe shkallën e subvencionit nga buxheti i shtetit për të mbuluar diferencën midis kostos dhe asaj që pronarët e tokës mund të mbulojnë.

Në periudha afatshkurtër pastrimi i kolektorëve, kanaleve kryesorë dhe sekondarë do të bëhet nga buxheti i shtetit nëpërmjet strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të

MBZHR-së dhe bashkive. Pastrimi i kanaleve të treta do të përballohet nga OPU-të dhe GPU-të. Në rastin e GPU-ve, me kanale të tretë të vegjël, mund të bëhet pastrimi me kontributin e anëtarëve ose mund të merren dhe punëtorë me pagesë. Në varësi me progresin e ekonomisë rurale, synimi i qeverisë është që brenda një periudhe afatmesme (4–7-vjeçare), pagesa për pastrimin e kanaleve kulluese të fillojë të mbulohet nga përfituesit. Në vijim, në një periudhë afatgjatë, kontributi i tyre mund të rritet, bazuar në vlerësime, analiza dhe negociata.

Këto kosto do të vlerësohen për çdo sistem kullimi dhe do të bëhen analiza krahasuese të kostove me të ardhurat relative të pronarëve të tokave. Do të shihet mundësia e pronarëve të tokave për mbulimin e kostove dhe për këtë do të bëhen dhe rekomandimet përkatëse.

Me qëllim mundësimin e rritjes së të ardhurave për strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, do të ndërmerret një studim fizibiliteti në disa skema kullimi, për identifikimin e të gjithë përfituesve të drejtpërdrejtë nga sistemi kullues dhe për përcaktimin e modaliteteve për grumbullimin e tarifave të kullimit prej tyre.

MBZHR-ja do të hartojë një metodë për vlerësimin e përqindjes së përfituesve të drejtpërdrejtë kundrejt atyre që nuk mund të identifikohen.

5.2.4 Politikat për ngritjen e kapaciteteve për kullimin

Një modul trajnimi për kullimin do të përgatitet dhe do të zhvillohet me stafet e strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-të, që do të ndihmojë për prioritizimin e punimeve të pastrimit dhe kryerjen e tyre, pa modifikuar gjerësinë dhe thellësinë e kanaleve.

Masat për politikën për ngritjen e kapaciteteve për kullimin

Një modul trajnimi do të përgatitet për trajnimin e strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë të ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU-ve, që janë përgjegjëse për administrimin e kullimit, sipas niveleve të kanaleve që kanë në përgjegjësi.

5.3 Komponenti strategjik 3: Objektivat dhe masat për sigurinë dhe shfrytëzimin e digave

5.3.1 Politika për rregulloret mbi sigurinë dhe shfrytëzimin e digave

Zbatimi i rregulloreve të sigurisë së digave përfshin të gjitha digat dhe pronarët e tyre, që kanë përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë së veprës. Rregulloret e përgjithshme të sigurisë së digave janë të aplikueshme për të gjitha digat në Shqipëri, pavarësisht nga madhësia, përveçse kur rregullore specifike aplikohen vetëm për digat e mesme apo të mëdha.

Çështjet teknike duhen zgjidhur nga ekspertë teknikë, ndërsa për çështje jo teknike dhe administrative duhet të vendoset nga autoritetet menaxhues. Ka çështje që i kërkojnë të dyja. Është e rëndësishme që për to të ketë rregullore, udhëzues dhe instruksione të qarta.

Rregulloret e sigurisë së digave duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e pronarit/shfrytëzuesit, pozicionet e autorizuarra dhe kualifikimet e tyre për të marrë vendime për sigurinë e digave dhe cilat janë kufijtë brenda të cilëve mund të merren vendimet. Autoriteti mbikëqyrës i sigurisë së digave duhet të ketë në inventar të gjitha digat në vend, të gjitha ato diga të cilat janë të një madhësie të konsiderueshme dhe përbëjnë rrezik potencial. Rregullorja e sigurisë së digës duhet të përmbajë digën, rezervuarin, veprat e lidhura me të, popullatën, pronat dhe mjedisin poshtë saj. Siguria e digës i referohet si vetë trupit të digës ashtu dhe veprave anekse të saj, përfshi rezervuarin. Ajo i referohet gjithashtu edhe popullsisë që jeton poshtë saj dhe pronave që rrezikohen nga shkatërrimi i digës.

Raportimi për rrezikun nga shkatërrimi i digës i bëhet i njohur bashkive ashtu dhe njësisë përgjegjëse të paralajmërimit të rrezikut nga përmblytjet dhe ndërhyrjes (NJPRP) në Ministrinë e Mbrojtjes. Pronari apo shfrytëzuesi i digës dhe veprave anekse të saj është përgjegjës për njoftimin e menjëhershëm të bashkive dhe NJPRP në rast të mundshëm shkatërrimi të digës.

Masat për politikën për rregulloret mbi sigurinë dhe shfrytëzimin e digave

Shembuj të çështjeve teknike janë shfrytëzimi i veprës, metodat dhe instrumentet e përdorur, standardet e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, përshtatshmëria e ujëlëshuesve apo shkarkuesve etj. Çështje jo teknike janë ato që bazohen në autoritetin dhe gjykimin e vendimmarrësve rreth

shkallës së pranueshme të riskut, rreth prevalencës së kostove apo sigurisë dhe plotësimit të nevojave shoqëro-mjedisore të veprës.

Të gjitha rregulloret, instruksionet, udhëzuesit duhen kuptuar dhe zbatuar për të gjitha digat pavarësisht përmasave të tyre, nëse nuk janë të specifikuar ndryshe. Shkatërrimi i digave mund të ketë pasojë fatale sidomos nëse ka efekt domino. Duhet një rregullore, e cila të shprehë qartë përgjegjësitë e pronarit/shfrytëzuesit të veprës për të garantuar shfrytëzim dhe mirëmbajtje me standarde.

Specifikimet rreth atyre që marrin vendime dhe çfarë vendimesh mund të marrin përbëjnë pjesë të rëndësishme të rregullores dhe instruksioneve. Kjo përfshin arsimin dhe trajnimin, që kërkohet për çdo pozicion të lidhur me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digës.

Inventari i digave do të jetë publik dhe do mundësojë që autoritet zyrtare dhe publike të ndërjegjësohen për problematikën e lidhur me sigurinë e digave. Inventari përmban informacion mbi madhësinë e digës, kapacitetin e rezervuarit të projektuar dhe aktual, veprat kryesore, sipërfaqja ujtitëse që ajo mbulon, përfituesit e saj, pronari, shfrytëzuesi, licencat dhe lejet.

Rregullorja apo udhëzimet përfshijnë sigurinë e digës, rezervuarit, veprave të saj, popullsinë dhe pronat afër dhe poshtë saj.

Pronari apo shfrytëzuesi i digës duhet të raportojë menjëherë në rast emergjence te personeli që mbulon emergjencat pranë bashkive ku ndodhet diga dhe shkatërrimi i saj ka impakt për njerëzit, tokën dhe pasuritë. Gjithashtu, Ai duhet të raportojë urgjentisht dhe të NJJPRP-së dhe Njësia përgjegjëse menjëherë kur vëren mundësi të dëmtimit të digës ose kur shfaqen emergjenca.

5.3.2 Politika për marrëdhëniet institucionale dhe financimin

Spektori i Sigurisë së Digave, në strukturën përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR do të monitorojë dhe rekomandojë përmirësimet për sigurinë e digave. Komiteti i Sigurisë së Digave të Mëdha (KKDM) do të vazhdojë të kryejë rolin e tij si organi më i lartë për sigurinë e digave në vend.

KKDM-ja dhe Spektori i Sigurisë së Digave duhet të jenë të pavarura nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së apo autoritetet e tjera të përfshira në vendimmarrje për ndërtimin e digave të reja, rehabilitimin e tyre, nga ata që përfaqësojnë pronarët e shfrytëzuesit e digave, rezervuarëve dhe veprave anekse të tyre.

Përpara se diga dhe rezervuari të konsiderohen për transferim, duhet të plotësohen një sërë kriteresh që lidhen me anën ligjore të transferimit të administrimit të digave dhe rezervuarëve.

Masat për politikën për marrëdhëniet institucionale dhe financimin

Spektori i Sigurisë së Digave do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe praktikave të sigurisë të digave në gjithë vendin, për inspektimet, miratimin e aplikimeve për licenca / leje, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e standardeve të sigurisë.

Do të bëhet një analizë ligjore e shoqëruar me rekomandimet e nevojshme për të bërë të mundur që rregulloret e sigurisë së digave të jenë të ndara ligjërisht dhe institucionalisht nga ato të shfrytëzimit e mirëmbajtjes.

Kriteret për transferimin e përgjegjësisë së administrimit të digave dhe rezervuarëve te bashkitë/OPU-të mund të përfshijnë: 1) kompleksitetin dhe përmasat e digës dhe rezervuarit, 2) nivelin e administrimit të kërkuar dhe buxhetin, 3) gjendjen funksionale të veprës, 4) shkallën potenciale të rrezikshmërisë, dhe 5) gatishmërinë e OPU-ve për të marrë përgjegjësinë e administrimit të digës dhe rezervuarit. Në rastin kur gjendja funksionale e veprës është poshtë standardeve të kërkuara, përpara se të bëhet transferimi duhet të bëhet rehabilitimi apo modernizimi i veprës.

5.3.3 Politika për funksionet dhe kompetencat e njësisë mbikëqyrëse

Spektori i Sigurisë së Digave përditëson normat, kriteret dhe standardet e sigurisë së digave me treguesit e monitorimit të bazuar në kërkesat e ligjit dhe rregulloreve. Përgjegjësitë kryesore për Spektorin e Sigurisë së Digave janë mbrojtja e sigurisë publike duke hartuar standarde sigurie në

varësi të kushteve të digës dhe veprave anekse të saj, dhe të përcaktimit të standardeve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Sektori duhet të garantojë përputhshmërinë me këto standarde nëpërmjet inspektimeve periodike dhe dhënies së rekomandimeve, mos zbatimi i të cilave shoqërohet me sanksione kundrejt pronarit apo shfrytëzuesit të veprës.

Sektori i Sigurisë së Digave duhet të bëjë një inventarizim të të gjitha digave që shërbejnë për ujitje. Ai ka përgjegjësinë e inspektimit periodik të digave dhe të lëshimit të instruksioneve ligjore për pronarët apo shfrytëzuesit e digave për punimet që duhen të kryhen apo për ndryshimin e praktikave të administrimit. Ai do të bëjë rekomandime për strukturën përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR lidhur me ndërtimin e digave të reja, përdorimin e ujit, licencimet dhe lejet për digat e bujqësisë.

Duke parë rëndësinë strategjike të sektorit të ujit si për bujqësi a prodhim energjie si dhe për rrezikshmërinë që paraqesin digat në rast shkatërrimi, është detyrë e qeverisë që të gjejë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe me kualifikimin përkatës si dhe të gjejë burime financiare të mjaftueshme për këtë sektor.

Sektori i Sigurisë së Digave duhet të shqyrtojë planet dhe praktikave të pronarëve apo shfrytëzuesve të digave, për të siguruar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e sigurisë së digave. Çdo digë duhet të ketë planin e saj të emergjencës të hartuar nga pronari apo shfrytëzuesi.

Masat për politikën për funksionet dhe kompetencat e njësisë mbikëqyrëse

Sektori i Sigurisë së Digave ka përgjegjësinë dhe autoritetin e hartimit të kriterëve dhe standardeve të lidhura me shfrytëzimin e veprës si dhe të treguesve për monitorim, nëse shfrytëzimi bëhet në përputhje me standardet dhe ligjet në fuqi. Sektori i Sigurisë së Digave harton gjithashtu dhe udhëzuesit e siguron trajnim për zbatueshmërinë e tyre.

Inventari duhet të përmbajë një listë me informacione rreth digës dhe veprave anekse të saj, dimensioneve të tyre, gjendjes dhe dëmtimeve të tyre, kapacitetin e projektuar të rezervuarit dhe atë funksional.

Ndonëse Komiteti i Sigurisë së Digave nuk mund të jetë i vetmi autoritet për të aprovuar ose jo dhënien e lejeve dhe licencave, ai duhet të ketë fuqinë e vetos për vendime të tilla për aplikantët, planet dhe praktikave të cilëve për sigurinë e digave nuk përmbushin standardet zyrtare.

Sektori i Sigurisë së Digave kryhen inspektime së paku një herë në dy vjet. Këtu përfshihet inspektimi i digës dhe veprave anekse të saj, mirëmbajtja, treguesit e sigurisë, plani i emergjencës, personat përgjegjës, personat e kontaktit, buxheti për M dhe SH. Ai përgatit edhe rekomandime për sigurinë e veprës të cilat kanë fuqi ligjore dhe duhen zbatuar.

MBZHR-ja do të saktësojë më tej rregulloret rreth arsimimit, trajnimit dhe certifikimit të kërkuar për pozicionet që kanë të bëjnë me administrimin e digave dhe veprave anekse.

Si pjesë e inspektimeve në terren, Sektori i Sigurisë së Digave do të shqyrtojë dhe vlerësojë përshatshmërinë e aktiviteteve të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, planeve të emergjencës, praktikave të ndjekura si dhe nëse buxheti i alokuar është në përputhje nevojat për ndërhyrje sipas standardeve të sigurisë së digës. Inspektimi dhe protokollet do të përfshihen në një raport me një listë rekomandimesh dhe masash që duhen marrë brenda një afati kohor të mirë përcaktuar.

5.3.4 Politika për rehabilitimin dhe modernizimin e digave dhe rezervuarve

Do të përgatitet një udhëzues për të bërë vlerësime për nevojën e rehabilitimit të digës, rezervuarit apo strukturave të tjera. Udhëzuesi do të përfshijë nëse është i nevojshëm modernizimi si dhe aspektet teknike dhe menaxhuese të digave dhe rezervuarëve, për shkak të ndryshimeve që ndodhin në vend.

Masat për politikën për rehabilitimin dhe modernizimin e digave dhe rezervuarve

Udhëzuesi mbi vlerësimin do të sigurojë instruksione për prioritizimin e asaj se çfarë lloj strukture dige, aspekte të rezervuarve, kanaleve ushqyes, dhe strukturave të tjera përkatëse janë të nevojshme të rehabilitohen. Ka shumë kushte dhe faktorë që e bëjnë të nevojshëm rehabilitimin dhe modernizimin. Këto kushte përfshijnë mungesat më të shpeshta të ujit, përmbytjet, konkurrenca për ujë etj. Në këtë kontekst, duke pasur fenomene natyrore ekstreme më të

shpeshhta si thatësira a përmbytje, del si nevojë e pashmangshme vlerësimi i kapaciteteve ujore të vendit dhe rishikimi i standardeve të sigurisë së digave, si dhe cilat mund të ishin praktikatat më të mira për të përcaktuar nevojat për modernizim.

Në terma afatshkurtër, MBZHR-ja duhet të marrë në analizë nevojat potenciale për modernizim të digave dhe veprave të tyre anekse. Ky studim do të jepte rekomandime specifike për metodologjinë e modernizimit me kosto të përshtatshme. Po ashtu studimi do të jepte dhe përmirësimet menaxheriale që kërkohen. Në terma afatmesme, do të fillojë programi i modernizimit dhe investime të mëtejshme për rehabilitim dhe modernizim duhet të parashikohen dhe alokohen në përputhje me programin e hartuar për këtë qëllim.

5.3.5 Politika për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin dhe sigurinë e digave dhe rezervuarve.

Përgjegjësitë kryesore të pronarit, apo shfrytëzuesit të digës dhe veprave anekse të saj, janë garantimi i sigurisë së veprës dhe shfrytëzimi e mirëmbajtja konform standardeve. Pronari apo shfrytëzuesi është përgjegjës për monitorimin e sigurisë së digës dhe veprave anekse të saj.

Do të hartohen manuale dhe module trajnimi për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave dhe caktohen trajnues për zhvillimin e trajnimeve. Marrëveshje do të nënshkruhen me të gjithë përfaqësuesit e pronarit apo shfrytëzuesit e digave që trajnohen për pjesëmarrjen, leximin e ndjekjen e instruksioneve të përshkruara në manuale. Trajnimi do të bëhet edhe për stafet e Sektorit të Sigurisë së Digave, strukturave përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, bashkive etj.

Masat mbi politikën e ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin dhe sigurinë e digave dhe rezervuarve

Të gjitha këto përgjegjësi dhe zbatimi i tyre në përputhje me standardet e sigurisë dhe të SH dhe M do të jenë pjesë e manualeve të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë së digave. Kjo do të trajtohet edhe në trajnimet që do të shpjegohen më poshtë.

Ministria do të caktojë ekspertë për përgatitjen e manualeve të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë së digave dhe veprave anekse të tyre. Këto module dhe manuale trajnimi do të përmbajnë treguesit kryesorë të sigurisë së digave, mënyrën e monitorimit, në çfarë stadi bëhen ndërhyrjet për riparime e modernizime. Trajnimi do të përfshijë mënyrën dhe shpeshësinë e kryerjes së inspektimeve, llojin e rekomandimeve, burimet financiare për ndërhyrjet riparimet dhe përmirësimet në digë.

Këto do të jenë në përputhje me standardet e BE-së për sigurinë e digave. Pjesëmarrës në këtë program trajnimi do të jenë të gjithë përfaqësuesit e strukturave shtetërore, me cilësinë pronarëve dhe shfrytëzuesve të digave. Trajnimi do të përfshijë edhe detyra të lidhura me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave dhe planet e emergjencës, që do të plotësohen nga pjesëmarrësit në trajnim. Module dhe manuali i trajnimit do të hartohen për rregulloret e sigurisë së digave. Ato do të jenë konform standardeve të BE-së për sigurinë e digave. Si fillim, si trajnues mund të ftohen edhe ekspertë ndërkombëtarë dhe lokal, për të trajnuar stafin e Sektorit të Sigurisë së Digave dhe staf të përzgjedhur nga strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së/bashkitë. Trajnimet e mëpasshme do të përfshijnë të gjithë përfaqësuesit e pronarëve apo shfrytëzuesve të digave në vend. Vlerësohet se procesi i trajnimit mund të zgjasë nga 2 deri në 3 vjet.

5.4 Komponenti strategjik 4: Objektivat dhe masat për mbrojtjen nga përmbytjet

5.4.1 Politika për menaxhimin e integruar të basenit lumor

Politika për mbrojtjen nga përmbytjet ka në bazë parimin e solidaritetit. Ky parim do të adoptohet brenda baseneve lumore. Kjo ka të bëjë me nevojën për marrjen e masave të integruara kundër përmbytjes.

Masat për politikën për menaxhimin e integruar të basenit lumor

Parimi i solidaritetit bazohet në faktin që planifikimi dhe zbatimi i masave kundër përmbytjeve ndjekin tre hapa: 1) mbajtjen e ujit të reshjeve në zona të përcaktuara sa më gjatë të jetë e mundur, 2) depozitimin e ujërave të tepërta në zona të përcaktuara, dhe 3) lejimin e

rrjedhës së ujërave të tepërta në rrjedhjen e poshtme në basenin ujqor, kur nuk kemi më mundësi të mbajmë ujë në segmentet e rrjedhjes së sipërme.

5.4.2 Politika mbi zhvillimin e strukturave/veprave të mbrojtjes nga përmbytjet

Përveç mbrojtjes së zonave shumë të populluara, synohet identifikimi i zonave dhe kufijve për mbajtjen e ujit apo zonave të evakuimit dhe kufizimi i ndërtimit të veprave të mbrojtjes nga përmbytjet si argjinatura, përforsime bankinash etj., të cilat faktikisht mund të pengojnë lëvizjen natyrore të ujit. Gjithashtu, një parim kryesor është mos përcjellja e riskut nga përmbytjet nga një pjesë në pjesën tjetër të basenit lumor.

Do të bëhet një inventarizim i veprave të mbrojtjes nga përmbytja, duke i renditur sipas riskut: i lartë, i mesëm dhe i ulët. Duke parë shpeshësinë në rritje të përmbytjeve, rehabilitimi dhe mundësisht edhe modernizimi në disa vende i veprave të mbrojtjes nga përmbytja, do të bëhet bazuar në rëndësinë dhe emergjencën në funksion të mbrojtjes së tokës për qëllime prodhimi dhe prandalimit të dëmeve për njerëzit dhe pasuritë e tyre.

Nëpërmjet një studimi do të identifikohen vendndodhjet me risk të lartë dhe të mesëm dhe nevojat për ndërtimin e veprave mbrojtëse. MBZHR-ja do të identifikojë të gjitha vendet e tjera ku ka nevojë për vepra të reja mbrojtjeje nga përmbytjet dhe do të rekomandojë dhe tipin e veprave që duhet ndërtuar.

MBZHR-ja do të mobilizojë fonde për kryerjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit të projekteve të zbatimit. Po kështu, do të përcaktojë modalitetet për të bërë të mundur kryerjen e studimeve për evidentimin e pasojat klimatike, hidrologjike, ekologjike, mjedisore dhe social ekonomike të përmbytjeve në të gjashtë basenet lumore të vendit.

Synimi është të projektohen dhe financohen ndërtimi i veprave mbrojtëse në zonat me risk të lartë dhe të mesëm, menjëherë sapo të gjenden fondet. Ndërtimi/rehabilitimi i veprave mbrojtëse në zonat me risk të lartë konsiderohet si prioritet. Mbrojtja e zonave të populluara, të rrezikuara nga përmbytjet është prioritet emergjent.

Synimi është që ndërtimi i veprave të nevojshme për mbrojtjen nga përmbytjet të përfundojë brenda një periudhe 10-vjeçare.

Gjithashtu përbën prioritet mobilizimi, vënia në dispozicion dhe përdorimi i barrierave dhe pajisjeve të lëvizshme në zonat shumë të populluara me risk të lartë përmbytjeje.

MBZHR-ja do të përgatisë një plan, do të mobilizojë fonde dhe zbatojë një program për zhvillimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet dhe erozioni detar.

Masat për politikën për zhvillimin e strukturave/veprave të mbrojtjes nga përmbytjet

Përgatitja e planeve të menaxhimit të përmbytjeve do të përfshijë vlerësimin e llojeve të ndryshme të investimeve dhe ndërhyrjeve për rritjen e aftësisë mbajtëse/akumuluese ujore brenda basenit lumor. Veprimet e gabuara ku mbrohet një seksion, por rrezikohet një tjetër duhen eliminuar. Baseni konsiderohet si një i tërë dhe po kështu dhe efektet bazohen mbi vlerësime të integruara.

Brenda një periudhe afatshkurtër, strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të bëjnë vlerësimin e të gjitha veprave të mbrojtjes nga përmbytjet dhe do të klasifikojnë ato me: 1) risk i lartë/riparime ose rehabilitim sa më shpejt të jetë e mundur, 2) risk i mesëm/riparime ose rehabilitim brenda një periudhe dyvjeçare dhe 3-) risk i ulët por që duhet të inspektohet përsëri brenda një periudhe 3-vjeçare.

Në fund të një periudhe afatshkurtër, strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së do të inspektojnë vendet që rrezikohen nga përmbytjet ku mungojnë veprat mbrojtëse. Ato do të identifikojnë shkallën e rrezikut si për popullatën ashtu dhe për pronat. MBZHR-ja do të përpiqet të gjejë fonde të mjaftueshme duke filluar së pari me kryerjen e studimeve të fizibilitetit dhe të projekteve për të gjitha zonat me risk të lartë brenda një periudhe afatshkurtër. Më pas pritet të fillojë puna për ndërtimin e veprave. Fizibilitetet dhe projektet për zonat me risk të mesëm do të hartohen gjatë një periudhe afatmesme dhe do të vihen në zbatim gjatë një periudhe afatgjatë.

MBZHR-ja do të mobilizojë fonde për kryerjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimin e

projekteve të zbatimit për ndërtimin e veprave mbrojtëse. Të dhëna ndërdisiplinore, modelimi dhe parashikimi i motit janë të nevojshme për studimet lidhur me karakterizimin e riskut të përmbytjeve në basenet lumore. Bursa studimi do të mundësohen për studentë me rezultatet më të larta të vijnë kualifikimin për mbrojtjen dhe parandalimin e përmbytjeve.

Gjithashtu, profesionistë të fushës, inxhinierë, ekonomistë, ekologë etj., të cilët veprojnë ose mund të përfshihen në fushën e përmbytjeve do të mbështeten me trajnime në fushën e analizave të riskut nga përmbytjet dhe mbrojtjet të zhvilluara në kuadër të Programeve Profesionale të BE-së. Këtu përfshihen kurse, seminare, konferenca e takime në rang ndërkombëtar. Po kështu në trajnime do të përfshihen dhe stafet e bashkive me risk të lartë nga përmbytjet, planifikues të përdorimit të tokës, specialistë të emergjencave civile etj.

Po kështu do të inkurajohet dhe pjesëmarrja e shkencëtarëve vendas në forumet dhe takime të rëndësishme të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave Hidraulike “International Association of Hydrological Sciences (IAHS)” ose të Shoqatës Evropiane të Gjeofizikës “European Geophysical Society (EGS)” të cilat merren dhe me fenomenin e përmbytjes.

Veprat mbrojtëse në zonat me risk të lartë do të projektohen dhe ndërtohen brenda një periudhe afatmesme, ndërsa ato të zonave me risk të mesëm gjatë një periudhe afatgjatë. Këto do të financohen me fonde nga buxheti i shtetit dhe donatorë.

Çështja e mbrojtjes nga përmbytjet do të trajtohet si një nga prioritetet më kryesore të vendit dhe do të merren të gjitha masat që riparimet dhe ndërtimet e veprave të reja mbrojtëse do të përfundojnë nga fundi i periudhës afatmesme.

Në terma afatshkurtër, MBZHR-ja do të hartojë planin e rehabilitimit të veprave mbrojtëse dhe ndërtimit të atyre të reja përgjatë lumenjve. Plani do të japë detaje për punimet, vendndodhjet dhe kostot e vlerësuara.

Do të përdoren edhe pajisje dhe barriera të tilla si mure parapet për dallgët, pengesa të çmontueshme, thasë me rërë etj. Këto masa janë të lëvizshme dhe mund të magazinohen diku dhe të përdoren më pas në rast nevojë gjatë përmbytjeve.

Ky plan për mbrojtjen nga përmbytjet nga deti do të identifikojë vendet ku duhen ndërtuar vepra mbrojtëse dhe do të përcaktojë dhe koston e tyre për çdo vendndodhje. Plani do të rekomandojë burimet financiare që mund të nevojiten, jashtë buxhetit të shtetit.

5.4.3 Politika për financimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet

Mbrojtja nga përmbytja është një funksion publik dhe për pasojë dhe financimet për mirëmbajtje, riparime apo modernizime do të përballohen nga buxheti i shtetit. Ndërsa për disa rehabilitime dhe ndërtime të reja që do të financohen nga shteti, për mbrojtjet e zonave me risk të lartë, mund të konsiderohet edhe mundësia e financimit nga institucione financiare ndërkombëtare apo donatorë bilateralë.

MBZHR-ja do të përgatisë një plan se si do të financohet mirëmbajtja, riparimi dhe modernizimi i veprave të mbrojtjes nga përmbytjet. Gjithashtu, do të përgatitet një studim lidhur me kombinimin optimal të investimeve në kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet. Vlerësimi i lidhjeve midis kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet është i nevojshëm për të siguruar një kombinim optimal të investimeve si në terma të standardeve të larta ashtu dhe të efektivitetit.

Masat mbi politikat për financimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet

MBZHR-ja do të përgatisë projektet për rehabilitimin e veprave ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet dhe zhvillimin e strukturave/veprave të reja që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe ato që mund të financohen nga grante apo hua nga institucionet financiare ndërkombëtare apo donatorë bilateral.

Studimi për investime të kombinuara në kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet mund të bëhet me fonde donatorësh dhe duhet të përfshijë ekspertizë për investimet në infrastrukturë dhe impaktin ekonomik të tyre.

6. Plani i Veprimit për zbatimin e strategjisë

Seksioni 6.1 deri në 6.4 paraqet tabelat që tregojnë veprimtaritë që do të implementohen në kuadër të kësaj strategjie. Çdo tabelë tregon për çdo veprimtari periudhën e përafërt

(afatshkurtër-mesme-gjatë), kohëzgjatjen dhe rezultatin e pritsëm.

6.1 Ujitja

Tabela 6.1 Veprimtaritë, koha dhe rezultatet e strategjisë së ujitjes

| Veprimtaria | Fillimi | Kohëzgjatja | Rezultati i pritsëm |
|---|--------------|-------------|---|
| Ujitja dhe bujqësia | | | |
| *I-1. Projektet e ujitjes do të zbatohen paralelisht me projektet e tjera të bujqësisë përmes granteve | Afatshkurtër | 10 vjet | Projekte paralele në ujitje dhe bujqësi që sigurojnë sinergji |
| I-2. Projektet e Ujitjes dhe bujqësisë do të fokusohen kryesisht në produktivitetin e fermave të vogla dhe agrobiznesin | Afatshkurtër | 10 vjet | Përmirësuar të ardhurat në fermë, punësimi, agropërpunimi dhe agrobiznesi |
| I-3. Lehtësimi i konsolidimit të aktiviteteve në fermë për të mundësuar kooperimin e agrobiznesit dhe marketingut | Afatshkurtër | 10 vjet | Operacione të përmirësuara të konsolidimit të tokës midis fermerëve të vegjël |
| I-4. Kërkim dhe zhvillim për kultura bujqësore me vlerë të lartë, përpunim, marketing dhe përputhje me standardet e BE | Afatmesëm | 10 vjet | Fermerët e vegjël kanë akses për kapital dhe bujqësi të leverdishme dhe biznes me akses në tregjet e BE |
| Zhvillimi | | | |
| I-5. Përgatitje e udhëzuesit për rehabilitimin dhe modernizimin me pjesëmarrje | Afatshkurtër | 3-6 muaj | Udhëzues se si të implementohet rehabilitimi dhe modernizimi me pjesëmarrje |
| I-6. Përgatitja e Planit të Investimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e sistemeve ujitëse | Afatshkurtër | 1 vit | Plani i Investimeve për rehabilitimin, përmirësimin dhe modernizimin |
| I-7. Angazhimi i fondeve për Planin e Investimeve | Afatshkurtër | 4 vjet | Fonde të mjaftueshme dhe asistencë në projekt për Planin e Investimeve |
| I-8. Përcaktimi i kostos së investimit që do të bashkëfinancohet nga fermerët | Afatshkurtër | 3-6 muaj | Marrëveshje mbi mënyrën se si fermerët investojnë në rehabilitim dhe modernizim |
| I-9. OPU përfshihen të investojnë në rehabilitimin e kanaleve të treta | Afatshkurtër | 8 vjet | Sistemet ujitëse janë rehabilituar dhe OPU kanë marrë përgjegjësinë e administrimit |
| I-10. Përfundimi i rehabilitimit të sistemeve ujitëse për 100 000 ha | Afatshkurtër | 1-2 vjet | Shtim i sipërfaqes së ujitshme me rreth 100 000 ha |
| I-11. Rehabilitimi i sistemeve për 140 000 ha së bashku me mbështetjen për bujqësinë dhe agrobiznesin | Afatmesëm | 10 vjet | Shtim i sipërfaqes së ujitshme me rreth 140 000 |
| I-12. Analiza dhe rekomandime për modernizimin e sistemeve ujitëse | Afatshkurtër | 1 vit | Raport me rekomandime për strategjinë e modernizimit |
| I-13. Zhvillimi i programit të modernizimit me praktika intensive të menaxhimit dhe matjen e ujit | Afatshkurtër | 6 muaj | Master Plan për modernizimin me mjete matëse të ujit dhe menaxhim intensiv |
| I-14. Angazhimi i fondeve dhe zbatimi i modernizimit | Afatmesëm | 12 vjet | Sistem i modernizuar dhe menaxhim intensiv |
| I-15. Identifikimi dhe rehabilitimi i stacioneve të pompimit të cilat duhen rehabilituar dhe modernizua | Afatmesëm | 1 vit | Raport me rekomandimet se cilat stacione pompimi duhen rehabilituar dhe modernizuar |

| Rregullime | | | |
|--|--------------|-----------------------|---|
| I-16. Miratimi i vendimeve për investime në ujitje | Afatshkurtër | Përafërsisht 6 vjet | Miratimi dhe përshtatja e planeve të investimeve |
| I-17. Mbikëqyrja e rehabilitimit të ujitjes, modernizimi, zhvillimit dhe menaxhimit | Afatshkurtër | Në vazhdimësi | Përputhje me politikat e ujitjes, ligjet, rregulloret dhe standardet |
| I-18. Monitorimi i punimeve në investimet në ujitje | Afatshkurtër | Në vazhdimësi | Identifikuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetja me shërbime |
| I-19. Përgatitja e udhëzuesit për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes | Afatshkurtër | 1 muaj | Udhëzues mbi mënyrën si do realizohet Auditimi i Menaxhimit të Ujitjes |
| I-20. Udhëzues i SPUKV/MBZHR për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes | Afat mesëm | Në vazhdim, afatgjatë | Performanca e Ujitjes e monitoruar, ngritja e kapaciteteve dhe shërbime mbështetëse të rekomanduara |
| I-21. Zbatimi i Auditit të Menaxhimit të Ujitjes | Afatshkurtër | Në vazhdimësi | Siguruar përputhje me politikat, ligjin dhe programet. Kapacitete menaxhuese të krijuara |
| I-25. Rekrutimi dhe trajnimi organizimi i ekipit të ujitjes | Afatshkurtër | 6 muaj | Staf me kapacitet për organizimin e Njësisë të Ujitjes dhe OPU |
| I-26. Sigurimi i firmave të së paku 51% të pronarëve të tokave brenda zonës së shërbimit të ujitjes për të themeluar OPU | Afatshkurtër | 5 vjet | OPU dhe GPU krijuar në gjithë sistemet e ujitjes të bashkisë |
| I-27. Roli i kryepaqve përpara krijimit të OPU/GPU | Afatshkurtër | 5 vjet | Koordinim të O dhe M në nivelin e parcelës para krijimit të GPU |
| I-28. Përgatitja e moduleve për Marrëveshjen e Transferimit të Menaxhimit (MTM) | Afatshkurtër | 6 muaj | Module për termat e Transferimit të Menaxhimit të Ujitjes |
| I-29. Krijimi i OPU dhe GPU | Afatshkurtër | 5 vjet | OPU dhe GPU në sistemet e ujitjes së bashkisë |
| I-30. Përgatitja dhe miratimi i statutit të OPU-v | Afatshkurtër | 5 vjet | Të gjithë OPU-të kanë statut |
| I-31. Përgatitja dhe miratimi i rregulloreve të funksionimit të brendshëm të OPU | Afatshkurtër | 5 vjet | Të gjitha OPU kanë rregullore |
| I-32. Bashkitë aplikojnë mbledhjen e tarifave të ujitjes | Afatshkurtër | Në vazhdimësi | Administrimi, menaxhimi dhe financimi i qëndrueshëm i ujitës nga bashkitë |
| I-33. Bashkitë do rekrutojnë stafe të mjaftueshme për njësitë e U dhe K dhe trajnimi i tyre | Afatshkurtër | 1-3 vjet | Njësitë e U dhe K të krijuara sipas nevojave dhe trajnuara |
| I-34. Transferimi i menaxhimit të kanaleve ujitëse | Afatshkurtër | 10 vjet | Të gjitha OPU kanë mësuar operimin dhe menaxhimin |
| I-35. Stafi i OPU-ve do të trajnohet për menaxhimin dhe financimin e ujitjes | Afatshkurtër | Vazhdimësi, afatgjatë | Stafi i OPU dhe GPO i trajnuar mire në menaxhimin e ujitjes |
| I-36. Transferimi i të drejtës së përdorimit të kanaleve sekondare dhe terciare tek OPU në se janë të gatshme, me marrëveshje me kushte për transferimin | Afatmesëm | 10 vjet | Gjithë OPU janë të afta dhe janë dakord të marrin administrimin e kanaleve sekondare dhe terciare |

| | | | |
|--|------------------------|---------------------------|---|
| I-37. Pronësia e kanaleve kryesore dhe veprave të marrjes mbetet në vartësi të shtetit. Transferimi i të drejtës së përdorimit të sistemeve të mesme dhe të vogla OPU-ve | Afatmesëm | 10 vjet | Ndarje e qartë e përgjegjësi. Transferimi i të drejtës së përdorimit rrit incentivat e përfituesve të paguajnë tarifën dhe mirëmbajnë sistemin. |
| I-38. Heqja e të drejtës së përdorimit e pjesës së sistemit në administrim nga OPU-të nëse dështojnë në menaxhimin dhe vetë financimin | Afatmesëm | Në vazhdimësi në se ndodh | Administrimi i hequr në se nevojitet pas dështimit të OPU |
| I-39. SPUKV/MBZHR do të inspektojnë dhe ndërtojnë kapacitetet e njësive të ujitjes dhe kullimit të bashkitë/OPU | Afatshkurtër-afatmesëm | 10 vjet | Staf i aftë i Njësive të Ujitjes dhe kullimit të bashkive/OPU-ve |
| I-40 Futja e incentivave dhe masave të llogaridhënies në sektor | Afatmesëm | 5 vjet | Performance e lartë e stafit në punë |
| Menaxhimi | | | |
| I-41. Përcaktimi i kriterëve kryesore të performancës së ujitjes dhe përfshirja në përgatitjen e manualit të O dhe M | Afatmesëm | 1 vit | Manuali i O dhe M i përgatitur dhe përdorur në trajnim |
| I-42. SPUKV/MBZHR do të ndihmojnë Njësitë e U dhe K të bashkive dhe OPU të përgatisin Planin e Shërbimit të Ujitjes dhe buxhete të bazuar në nevojat dhe dhënia e ndihmës ku nevojitet | Afatshkurtër | Në vazhdimësi afatgjatë | Staf i aftë i njësive të ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe OPU |
| I-43. Përgatitja e manualit të Planit të Shërbimit të Ujitjes dhe përfshirja brenda moduleve të trajnimit | Afatshkurtër | 6 muaj | Modul i Planit të Shërbimit të Ujitjes i përgatitur për përdorim në trajnime |
| I-44. Fermerët bëjnë kërkesën për ujë dhe OPU, Njësia e U dhe K në bashki e ndihmuar SPUKV/MBZHR, përgatitin Planin e Shërbimit të Ujitjes | Afatshkurtër | Çdo vit | Kërkesa për ujë të depozituara dhe Plani i Shërbimit të Ujitjes i përgatitur |
| I-45. MBZHR-ja do të kërkojë financim dhe bashkëpunim për kërkime mbi teknologjitë e ujitjes dhe inovacionin në menaxhim | Afatmesëm | Në vazhdimësi afatgjatë | Program mbi kërkimin dhe inovacionin për ujitjen dhe menaxhimin i zbatuar |
| I-46. Instalimi dhe përdorimi i mjeteve matëse të ujit përgjatë kanaleve kryesore dhe sekondare | Afatmesëm | 5 vjet | Matja e ujit përgjatë kanalit kryesor dhe sekondar |
| I-47. Trajnimi i SPUKV/MBZHR, Njësive të Ujitjes dhe OPU mbi ndërmjetësimin për konfliktet që kanë të bëjnë me ujitjen | Afatmesëm | 5 vjet | Stafi i përzgjedhur i SPUKV/MBZHR, njësitë e U dhe K të bashkive dhe OPU i aftë për ndërmjetësim në zgjidhjen e konflikteve të ujitjes |
| Financimi | | | |
| I-48. Zbatimi i parimit të pagesës së kostove fikse dhe variable të ujitjes | Afatshkurtër | 2 vjet | Një bazë e qartë e krijuar për pagesat e kostove fikse dhe variable të ujitjes |
| I-49. Hartimi i një udhëzuesi për buxhetimin bazuar në nevojat dhe | Afatshkurtër | | Udhëzues për buxhetim sipas nevojave dhe pagesat për |

| | | | |
|---|--------------|-------------------------------------|--|
| tarifat e shërbimit të ujitjes | | 6 muaj | shërbimin e ujitjes i përgatitur dhe përdorur në trajnim |
| I-50. SPUKV/MBZHR ndihmojnë Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive dhe OPU-të të përgatisin buxhetin dhe caktojnë Tarifatat e Shërbimit të Ujitjes | Afatshkurtër | 5 vjet | Njësia e U dhe K të bashkive dhe OPU janë të afta të përgatisin buxhetin bazuar në nevojat dhe Tarifatat e Shërbimit të Ujitjes |
| I-51. Bashkitë bien dakord të grumbulloje tarifën fikse të ujitjes prej të gjithë pronarëve të tokave në zonën potenciale të shërbimit përmes Zyrës së Taksave | Afatmesëm | Në vazhdimësi | Drejtoria e taksave në bashki grumbullon tarifën fikse për ujitjen nga pronarët e tokave në zonën potenciale të shërbimit të ujitjes |
| I-52. Procedura të reja për pagesat dhe depozitat | Afatshkurtër | Vazhdimësi | Menaxhim financiar transparent dhe llogaridhënës |
| I-53. Parimi i “paguaj vetëm për shërbimin e marre” është parashikuar në rregullore | Afatmesëm | 6 muaj të përgatitet dhe përshtatet | Rregullore ose ndryshime të miratuara me parimin “paguaj për shërbimin e marre” |
| Ndërtimi i kapaciteteve | | | |
| I-54. Së paku 12 module trajnimi do të përgatiten mbi teknologjinë e ujitjes, administrimin, menaxhimin dhe financat | Afatshkurtër | 2 vjet | 12 module trajnimi dhe manual të përgatitura mbi teknologjinë e ujitjes, administrimin, menaxhimin dhe financat |
| I-55. Trajnimi i SPUKV/MBZHR, Njësive të U dhe K të bashkive dhe OPU-ve mbi teknologjinë e ujitjes, administrimin., menaxhimin dhe financat | Afatshkurtër | 5 vjet | SPUKV/MBZHR, Njësitë e U dhe K të bashkive dhe OPU të trajnuara me 12 module trajnimi |
| I-56. Përgatitja e moduleve shtesë dhe trajnimi i SPUKV/MBZHR mbi rregulloret, konsultime mbi menaxhimin, Planin e Përmirësimit të Ujitjes dhe shërbime mbështetëse | Afatshkurtër | 2 vjet | Trajnimi i dhënë stafit të SPUKV/MBZHR mbi rregulloret, konsultime mbi menaxhim, Planin e Përmirësimit të Ujitjes dhe shërbime mbështetëse |
| I-57. Konsultime për menaxhimin me bashkitë dhe OPU për përgatitjen e Planit të Përmirësimit të Menaxhimit | Afatmesëm | 10 vjet | Plane Përmirësimi të Menaxhimit për çdo bashki dhe OPU |
| I-58. Kryerja e Auditimit të Menaxhimit të Ujitjes në të gjitha sistemet ujëtare të bashkive se paku çdo dy vjet | Afatmesëm | Në vazhdimësi | Auditimet e Menaxhimit të Ujitjes bëhen rregullisht dhe identifikohen nevojat për rritjen e kapaciteteve dhe shërbime mbështetëse |
| I-59. Përgatitja e udhëzuesit për aplikuesit e mundshëm për Partneritetin Publik Privat (PPP). SPUKV/MBZHR identifikojnë mundësitë potenciale | Afatmesëm | 2 vjet | Udhëzues për PPP i përgatitur, SPUKV/MBZHR identifikojnë mundësitë potenciale |
| I-60. Njësia e Ngritjes së Kapaciteteve do të krijohet në DPAUT, stafi i trajnuar | Afatshkurtër | 2 vjet | Pranë DPAUT-së në MBZHR është krijuar Njësia e Ngr. Kapaciteteve |

* I-Ujitje

6.2 Komponenti strategjik 2: Kullimi

Tabela 6.2. Veprimtaritë, koha dhe rezultatet e strategjisë së kullimit

| Veprimtaria | Fillimi | Kohëzgjatja | Rezultati i pritshëm |
|--|----------------|--------------------|---|
| Zhvillimi | | | |
| *D-1. Përgatitja e planit, financimi dhe programi i rehabilitimit dhe modernizimit të 14 hidrovoreve | Afatmesëm | 3-5 vjet | Plani i financimit dhe programi i rehabilitimit dhe modernizimi i 14 hidrovoreve i përfunduar |
| D-2. Vlerësimi i nevojave për rritjen e kapacitetit kullues | Afatshkurtër | 6 muaj | Raport me rekomandime për ku dhe sa duhet të rritet kapaciteti kullues |
| D-3. Barazimi i sasisë së aluvioneve që vijnë me atë që hiqen | Afatshkurtër | 2-3 vjet | Sasia e aluvioneve të hequra e barabartë me atë që vjen |
| Menaxhimi | | | |
| D-4. Vlerësimi i cilësisë së kullimit, rekomandime dhe udhëzues për kullim efikas | Afatshkurtër | 1 vit | Raport me rekomandime mbi kullimin, udhëzues për praktikat më të mira |
| D-5. Vlerësimi i stafit, pajisjeve dhe buxhetit të nevojshëm për pastrimin e gjithë kulluesve në standard | Afatshkurtër | 1 vit | Raport mbi burimet ekzistuese dhe të nevojshme për nënsektorin e kullimit |
| D-6. Mobilizimi i fondeve të mjaftueshme për kullimin | Afatmesëm | 5 vjet | Buxhet i mjaftueshëm për kullimin |
| D-7. Zhvillimi dhe implementimi i planit për programin e pastrimit paralel të kullimit midis SPUKV/MBZHR dhe bashkive/OPU-ve | Afatshkurtër | Në vazhdimësi | Kullimi i ndodhur në të gjitha nivelet |
| Financimi | | | |
| D-8. Analizë ekonomike e kostos së energjisë dhe nevoja për subvencion për hidrovoret dhe pastrimi i kolektorëve dhe kanaleve kryesore | Afatshkurtër | Deri Afat mesëm | Nevojat për subvencionin për energjinë elek. të hidrovoreve dhe pastrimin e kanaleve kryesore dhe kolektorëve të kullimit janë të njohura |
| D-9. Mbulimi i kostos së pastrimit të kanaleve brenda parcelës dhe kulluesit anësore prej OPU-ve. | Afatshkurtër | Vazhdimësi | Kanalet në parcelë dhe jashtë saj të pastruar |
| D-10. Mbulimi i një pjese të kostos së pastrimit të kolektorëve dhe kulluesit kryesore, nafta e eskavatorëve nga OPU-të. | Afatmesëm | Vazhdimësi | Tendenca për financim nga përfituesit në kullim vazhdon të rritet |
| D-11. Studim për të identifikuar pronarët e tokave dhe ndërtesave në zonën e shërbimit të kullimit dhe përfitues të tjerë | Afatmesëm | 3 vjet | Identifikimi i përfituesve në zonën e shërbimit të çdo sistemi kullues |
| D-12. Shërbimet e kullimit që do të paguhen nga buxheti i shtetit | Afatshkurtër | 1 vit | Baza për të përcaktuar çfarë shërbime kullimi do të paguhen nga buxheti i shteti |
| Ndërtimi i kapaciteteve | | | |

| | | | |
|--|-----------|--------|--|
| D-13. Përgatitja e modulit të trajnimit për kullimin dhe trajnimi i stafit të SPUKV/MBZHR, NjUKB dhe OPU-ve. | Afatmesëm | 6 muaj | Stafi i SPUKV/MBZHR, Njësive të U dhe K të bashkive dhe OPU-ve njohin praktikatat korrekte të kullimit |
|--|-----------|--------|--|

* D-Kullim

6.3 Komponenti strategjik 3: Siguria e digave

Tabela 6.3. Veprimtaritë, koha dhe rezultatet e strategjisë së sigurisë së digave

| Veprimtaria | Fillimi | Kohëzgjatja | Rezultati i pritshëm |
|--|--------------|-------------|---|
| Rregullimet | | | |
| *DR-1. Zgjidhja e çështjeve teknike dhe jo-teknike | Afatshkurtër | 6 muaj | Kuadër ligjor/rregullator i qartë për sigurinë e digave, O dhe M dhe financimin e tyre |
| DR-2. Zbatimi i rregullores së sigurisë së digave në të gjitha digat dhe pronari i digës ka përgjegjësinë kryesore të garantojë sigurinë e digës | Afatshkurtër | 3 muaj | Rregullore që përcakton qartë përgjegjësitë e pronarit dhe operatorit të digës |
| DR-3. Rregulloret e sigurisë së digave duhet të qartësojnë autoritetet dhe përgjegjësitë | Afatshkurtër | 6 muaj | Rregulloret e sigurisë së digave do kenë fushë/mbulim të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës |
| DR-4. Inventarizimi i të gjitha digave të vendit | Afatshkurtër | 1 vit | Të dhëna të gjendjes funksionale dhe pronësisë të të gjitha digave |
| DR-5. Rregullorja e sigurisë së digave duhet të përfshijë digat, rezervuarët, gjithë strukturat përkatëse, popullsinë dhe pronat dhe mjedisin poshtë digës | Afatshkurtër | 6 muaj | Udhëzues për të gjitha aspektet e sigurisë së digave dhe si të vlerësohet siguria e tyre |
| DR-6. Përgatitja e procedurës së përmirësuar për të raportuar evidencën për rrezikun e shpërthimit të digës dhe njohja me to e të gjitha palëve të përfshira, si bashkitë dhe njësia përgjegjëse për paralajmërimin dhe reagimin | Afatshkurtër | 3 muaj | Procedura të përmirësuara për paralajmërimin e hershëm nga rreziku i dëmtimit të digave |
| Përshtatjet institucionale dhe financimi | | | |
| DR-7. Sektori i Sigurisë së Digave në SPUK/MBZHR do të monitorojë, rregullojë, miratojë licencat/lejet dhe rekomandojë përmirësimin e sigurisë së digave kur është e nevojshme | Afatmesëm | 1 vit | Sektori i Sigurisë së Digave është forcuar dhe janë kryer përmirësimet në sigurinë e digave |
| DR-8. Pavarësia e Sektorit të Sigurisë së Digave do të përcaktohet në rregullore | Afatshkurtër | 1 vit | Pjesë e rregullores së sigurisë së digave |
| DR-9. Kriteret për transferimin e menaxhimit të digave dhe rezervuarve | Afatshkurtër | 1 vit | Pjesë e rregullores së sigurisë së digave |
| Funksionet dhe autoriteti i entit mbikëqyrës | | | |
| DR-10. Sektori i Sigurisë së Digave përditëson normat dhe standardet për sigurinë e digave me treguesit për monitorimin në përputhje me ligjin dhe rregulloret | Afatmesëm | 1 vit | Raport mbi përputhjen me standardet, normat dhe indikatorët për monitorim |
| DR-11. Sektori do të bëjë një inventar | | Vazhdimisht | Përditësimi i informacionit të |

| | | | |
|---|--------------|---------------|---|
| të karakteristikave të digave dhe kushtet për të gjitha digat e bujqësisë | Afatmesëm | me përditësim | inventarit mbi karakteristikat e digave, kushtet e përdorimit, menaxhimit, sigurisë |
| DR-12. Sektorit të Sigurisë së Digave i jepet autoritet të miratojë ose vendosë veton në ndërtimin e digave, përdorimin e ujit dhe lejeve të përdorimit ose licencave për digat bujqësore | Afatmesëm | 6 muaj | Rregullore për Sektorin e Sigurisë së Digave që të miratojë/refuzojë ndërtimin, përdorimin e ujit dhe lejet ose licencat e përdorimit për digat e bujqësisë |
| DR-13. Inspektimi i digës nga Sektori së paku një herë në 2 vjet, përfshirë M dhe Sh, sigurinë, planet e emergjencave, buxhetin për M dhe Sh dhe dhënien e rekomandimeve që duhen zbatuar | Afatmesëm | Vazhdimësi | Inspektime dhe raporte me rekomandime për të gjitha digat e bujqësisë |
| DR-14. Marrja e vendimit, për tu ndihmuar nga të tretë për inspektime, por Sektori duhet të miratojë gjithë gjetjet dhe rekomandimet | Afatmesëm | 6 muaj | Vendim nëse duhet një palë e tretë për të ndihmuar për inspektime në sigurinë e digave |
| DR-15. Angazhimi i stafit të kualifikuar dhe të mjaftueshëm | Afatmesëm | 3 vjet | Staf i mjaftueshëm për Sektorin e Sigurisë së Digave dhe operatorë të digave |
| DR-16. Sektori duhet të miratojë planet për përmirësimin e digave | Afatmesëm | 6 muaj | Sektori ka udhëzues dhe njohuri sesi të vlerësojë planin për përmirësimin e digave |
| Rehabilitimi dhe modernizimi | | | |
| DR-17. Udhëzues për vlerësimin nëse është i nevojshëm rehabilitimi i një dige, rezervuari, kanali ushqyes apo strukturave të tjera | Afatshkurtër | 6 muaj | Udhëzues për vlerësimin e rehabilitimit të një dige, rezervuari, kanali ushqyes dhe struktura të tjera |
| DR-18. Udhëzues për vlerësimin nëse është i nevojshëm modernizimi i një dige, rezervuari, kanali ushqyes apo strukturave të tjera | Afatshkurtër | 6 muaj | Udhëzues për vlerësimin e modernizimit të digave, rezervuarve, kanaleve ushqyes dhe struktura të tjera |
| Ndërtimi i kapaciteteve | | | |
| DR-19. Përgjegjësitë e pronarëve dhe operatoreve të digave bëhen të qarta në rregulloren e sigurisë së digave | Afatshkurtër | 6 muaj | Pjesë e rregullores së sigurisë së digave |
| DR-20: Përgatitja e manualeve dhe moduleve të trajnimit | Afatshkurtër | 1 vit | Manuale trajnimi dhe module të sigurisë së digave |
| DR-21: Përgatitja e manualeve dhe moduleve mbi rregullat e sigurisë së digave | Afatshkurtër | 6 muaj | Module dhe manual trajnimi mbi rregullat e sigurisë së digave |
| DR-22: Organizimi i trajnimeve për pronarët dhe operatorët e digave | Afatmesëm | 3 vjet | Ndërgjegjësim dhe zbatim nga të gjithë pronarët dhe operatorët e digave i kërkesave për sigurinë e digave |

* DR-Diga

6.4 Komponenti strategjik 4: Mbrojtja nga përmbytjet

Tabela 6.4 Veprimtaritë, koha dhe rezultatet e strategjisë për mbrojtjen nga përmbytjet

| Veprimtaria | Fillimi | Kohëzgjatja | Rezultati i pritshëm |
|-------------|---------|-------------|----------------------|
|-------------|---------|-------------|----------------------|

| Qasja e menaxhimit të integruar të baseneve ujore | | | |
|---|--------------|----------------------------------|---|
| *FP-1. Parimi i solidaritetit me 3 aspekte i pranuar si politikë për mbrojtjen nga përmbytjet | Afatshkurtër | 6 muaj | Parimi i solidaritetit për mbrojtjen nga përmbytjet i pranuar si politikë |
| Zhvillimi struktural | | | |
| FP-2. Inventari i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet duke i renditur me rrezik të lartë, mesëm dhe ulët | Afatshkurtër | 1 vit | Raport mbi gjendjen dhe ndërhyrjet urgjente që duhen për riparimin/ rehabilitimin e strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet |
| FP-3. Rivlerësimi i infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytja që mund ta zvogëlojë evadimin e ujit | Afatmesëm | 1.5 vjet | Raportimi i vlerësimit të infrast. së mbrojtjes nga përmbytja dhe rekomandime |
| FP-4. Identifikimi i vendeve me nevoja prioritare të larta dhe mesatare për ndërtimin e strukturave mbrojtëse nga përmbytjet | Afatmesëm | 1 vit | Vendet e përcaktuara për ndërhyrje me struktura të reja |
| FP-5. Angazhimi i fondeve dhe implementimi i studimeve të fisibilitetit dhe përgatitja e projekteve | Afatmesëm | 2 vjet | Fonde të siguruara, studime fisibiliteti të bëra, projekte të përfunduara |
| FP-6. Përg. e rregullores mbi stand. e ndërtimit, përfshirë vendndodhjen, hapësirën dhe ndalimin e ndërtimeve në zonën që përmbytet | Afatmesëm | 1 vit | Rregullore mbi standardet e ndërtimit për zonat që përmbyten |
| FP-7. Ndërtimi i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet sipas prioriteteve të lartë dhe mesëm | Afatmesëm | Gjatë gjithë periudhës afatgjatë | Ndërtimi i strukturave shtesë të mbrojtjes nga përmbytjet kompletuar |
| FP-8. Riparimi i strukturave mbrojtëse nga përmbytjet me nivel të lartë risku, i adoptuar si prioritet i lartë i politikës | Afatshkurtër | 6 muaj | Qëndrim politik që riparimi i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet me rrezik të madh është prioritet i lartë |
| FP-9. Politika që ndërtimi i argjinaturave të nevojshme të lumenjve dhe pendët tërthore do të kompletohet brenda 10 vjetësh | Afatshkurtër | 1 vit | Qëndrim politik i mbajtur për kohën e ndërtimit të argjinaturave dhe pendëve tërthore |
| FP-10. Mobilizimi dhe vendosja e pengesave të lëvizshme dhe pajisjeve për mbrojtjen nga përmbytjet në zonat me rrezik të lartë nga përmbytjet dhe zonat me popullsi të dendur | Afatshkurtër | 5 vjet | Barriera të lëvizshme ndaj përmbytjeve dhe pajisje të siguruara ku është e nevojshme |
| Financimi | | | |
| FP-11. Përgatitja e planit të financimit për mirëmbajtjen, riparimin, rehabilitimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet | Afatshkurtër | 1 vit | Plan sesi do të financohet dhe mirëmbahet, rehabilitohet dhe zhvillohet infrastruktura e mbrojtjes nga përmbytjet |
| FP-12. Studimi mbi kombinimin optimal të investimeve në kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet | Afatmesëm | 1 vit | Studim i bërë mbi kombinimin optimal të investimeve për kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet |
| FP-13. Përgatitja e Planeve të investimeve të mbrojtjes nga përmbytjet në nivel baseni dhe nivel kombëtar | Afatshkurtër | 4 vjet | Plani i investimeve të mbrojtjes nga përmbytjet i përgatitur për të orientuar investimet |
| FP-14. Planifikimi dhe financimi për | | | Plan për ndërhyrje në mbrojtjen |

| | | | |
|--|-----------|--------|--------------------|
| ndërhyrjet në mbrojtjen e vijës bregdetare | Afatmesëm | 5 vjet | e vijës bregdetare |
|--|-----------|--------|--------------------|

* FP-Mbrojtje nga përmbytja

7. Analiza e llogaridhënies, monitorimi dhe vlerësimi

7.1 Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi i këtij kapitulli është të shpjegojë se si janë ndarë /caktuar përgjegjësitë kryesore për implementimin e kësaj strategjie dhe si palët përgjegjëse ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në përputhje me parimet bazë të kësaj strategjie.

7.1.1 Matricat e përgjegjëse

Matricat e përgjegjëse do të përdoren për të treguar cilat organizata do të jenë përgjegjëse për secilin nga katër aspektet e implementimit të çdo veprimtarie të ndërmarrë. Katër aspektet janë:

1. **Planifikimi** – i emërtuar në tabelën e matricës së përgjegjëse me “P”.
2. **Financimi** – i emërtuar me “F”.
3. **Implementimi** – i emërtuar me “I”.
4. **Monitorimi dhe vlerësimi** – të emërtuar me “M dhe V”.

Institucionet dhe strukturat kryesore të përfshira në matricën e përgjegjëse janë: Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes, struktura përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në MBZHR, strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së, njësitë e ujitjes dhe kullimit të bashkive dhe organizatat e përdoruesve të ujit.

7.1.2 Indikatorët e performancës për monitorimin dhe vlerësimin

Transparenca për performancën e aktorëve që do të implementojnë strategjinë është thelbësore për të garantuar llogaridhënien e tyre ndaj politikës dhe strategjisë së qeverisë. Matja e performancës së aktoreve në lidhje me strategjinë është esenciale për të siguruar llogaridhënien. Kjo përfshin performancën në mobilizimin e burimeve, zbatimin e strategjisë, arritjen e rezultateve dhe impaktit të dëshiruar.

Indikatorët e performancës do të përdoren për të vlerësuar katër aspekte të strategjisë. Këto janë në katër kategori:

1. **Inputet**- shkalla në të cilën janë mobilizuar fondet e nevojshme dhe inpute të tjera;
2. **Zbatimi**- shkalla në të cilën janë arritur target/synimet e implementimit;
3. **Rezultate të menjëhershme** – shkalla në të cilën janë arritur rezultatet e menjëhershme të pritshme ose direkte;
4. **Impakti përfundimtar**- shkalla në të cilën është arritur impakti përfundimtar i pritshëm.

Në këtë kapitull përfshihen indikatorët për këto aspekte të performancës në ujitje, kullim, sigurinë e digave dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

7.2 Komponenti strategjik 1: Ujitja

7.2.1 Matricat e përgjegjëse

Tabela 7.2.1 më poshtë liston veprimtaritë që ndërmerren në strategji për nënsektorin e ujitjes. Të lidhur me çdo veprimtari janë dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin, financimin, implementimin, monitorimin, vlerësimin e aprovimin. Këto paraqiten si më poshtë:

- P = Planifikim
- I = Implementim
- F = Financim
- M dhe V = Monitorim dhe vlerësim
- M = Miratim.

Në disa raste, dy ose tre organizata mund të ndajnë përgjegjësinë për një nga këto funksione. Këto katër funksione dhe simbolet e tyre janë paraqitur me poshtë në matricën e përgjegjëse për ujitjen, kullimin, rezervuarët, dhe digat, dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

Tabela 7.2.1 Matrica e përgjegjësiave për ujitjen

| Veprimtaria | KM | MBZH R | SPUKV/M BZHR | Kon- sulentët | SPUKV/ MBZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona- torët |
|---|----|-----------|-----------------|------------------|-----------------|----------------|-----------|-----|----------------|
| Rehabilitimi dhe zhvillimi i ujitjes | | | | | | | | | |
| I-5. Përgatitje e udhëzimit për rehabilitim / modernizim me pjesëmarrje | | M | P,I | I | | | | | F |
| I-6. Udhëzues për zhvillimin me pjesëmarrje të sistemeve të reja | | M | P,I | I | | | | | F |
| I-7. Përgatitja e Planit të Investimeve | | M | P,I | I | I | | | | F |
| I-8. Angazhimi i fondeve për Planin e Investimeve | | M,I | P,I | | | | | | F |
| I-9. Përcaktimi i kostos të invest që do të bashkëfinancohet nga fermerët | | M | P,I | | I | I | | | F |
| I-10. OPU investojnë në rehabilitimin e kanaleve të treta | | | | | | M, M dhe V | M,P, I, F | | |
| I-11. Rehabilitimi i sistemeve për 100000 ha | | M | P,M | I, M dhe V | M | | | F | |
| I-12. Rehabilitimi i sistem për 140 000 ha | | M | P,M | I, M dhe V | M | M | | | F |
| I-13. Studime për modernizimin e sistemeve ujtitëse | | M | P | I | | | | | F |
| I-14. Zhvillimi i programit të modern | M | M | P | I | I | M | M | F | F |
| I-15. Angazhimi i fondeve dhe zbatimi i modernizimit | | P,M | P | I, M dhe V | I | I,M | | F | F |
| I-16. Identifikimi dhe rehabilitimi i st. të pompimit, të cilat do rehab. dhe modernizoh. | | M | P | I, M dhe V | I | I | | F | F |
| Mbikëqyrja e sektorit | | | | | | | | | |
| I-17. Miratimi për investimet në ujitje | M | M | M | | | | | | |
| I-18. Mbikëqyrja e investimeve | | | I | I | I | I | | | |
| I-19. Monitorimi i punimeve në invest. | | | I | I | I | I | | | |
| I-20. Përg. e udhëzues për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes | | M | P | I | | | | | F |
| I-21. Udhëzues për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes për SPUKV/MBZHR | | M | P | I | | | | | F |
| I-22. Kryerja e auditimeve të menaxhimit të ujitjes | | M | P | I | | | | | F |
| Institucionet dhe qeverisja e sistemit | | | | | | | | | |
| I-23. Ndryshime organizative brenda MBZHR në nivel qendror dhe rajonal | M | M,I | P,I | I | I | | | F | |
| I-24. Përgatitja e moduleve të OPU statuti/ rregullore | | M | P | I | | | | | F |
| I-25. Përgatitja e planeve për krijimin e OPU | | M | P,I | I | | I | I | | F |
| I-26. Rekrutimi dhe trajnimi organizimi i ekipit të ujitjes | | M | P | I | I | | | | F |
| I-27. Sigurimi i firmave për krijimin e OPU-së | | M | P,I | I | I | | | | F |
| I-28. Roli i kryepleqve para krijimit të OPU | | M | P | | I | I | | | F |
| I-29. Përgatitja e udhëzimit për MTM | | M | P,I | I | | | | | F |
| I-30. Krijimi i OPU dhe GPU | | M | P | I | | I | I | | F |
| I-31. Përgatitja dhe miratimi i statutit të OPU-ve | | M | M,P | I | | I | I | | F |
| I-32. Përgatitja dhe miratimi i rregull. të funksionimit të brendshëm të OPU | | M | M,P | I | | I | I | | F |
| I-33. Bashkitë administrojnë kanalet sekondare | M | | P | | | I | | F | |
| I-34. Bashkitë rekrutojnë stafet të mjaftueshme për NjUK | | M | M,P | I | | I,M Bashkia | | F | |
| I-35. Transferimi menaxhimit të kanaleve ujtitës te bashkitë | | M | P | | | I | | F | |
| I-36. Staf i OPU i trajnuar për ujitjen, menaxhimin dhe financat | | M | P | P,I | | I | I | | F |
| I-37. Kanalet sekondare/terciare transferuar bashkive | M | M | M,P,I | | | I | | | |

| Veprimtaria | KM | MBZH R | SPUK/M BZHR | Kon- sulentët | SPUKV/ MBZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona- torët |
|---|----|-----------|----------------|------------------|-----------------|-------|-------|-----|----------------|
| I-38. E drejta e përdorimit të sistemeve të vogla transferuar OPU | M | M | M,P,I | | | I | | | |
| I-39. Kushtet e heqjes së të drejtës përdorimit/ pronësisë | | M | M,I | | | I | | | |
| I-40. SPUKV/MBZHR rrisin kapacitetet e NjUK të bashkive | | | M,P | | I | I | | F | F |
| I-41. Incentiva dhe masa llogaridhënie | | M | P,I | I | I, M dhe V | I | I | | F |
| Menaxhimi i sistemit të ujitjes | | | | | | | | | |
| I-42. Kriteret e performancës përfshihen në manualin e M dhe Sh | | M | M,P | I | | | | | F |
| I-43. PShU dhe buxheti i përgatitur | | | | | I | I | I | F | |
| I-44. Udhëzuesi i PShU i përgatitur | | | M,P | I | | | | | F |
| I-45. PShU bazuar në kërkesat për ujitje | | | | | I | I | I | | |
| I-46. MBZHR-ja kërkon fonde për kërkim në U dhe K | | M,P | P,I | I | | | | | F |
| I-47. Instalimi pajisjeve matëse të ujit | | M | M,P | I | I | | | | F |
| I-48. Trajnim Zgjidhja e Konfliktëve me Ndërmjetësim | | | M,P | P,I | I | I | | | F |
| Financimi | | | | | | | | | |
| I-49. Politika për pagimin e kostos fikse dhe variable | | M,I | I | I | | | | | |
| I-50. Hartimi i një udhëzuesi për buxhetimin bazuar në nevojat dhe tarifën e shërbimit të ujitjes | | M | M | I | | | | | F |
| I-51. Buxhete dhe tarifën e shërbimit të ujitjes përgatitur | | | | | I | I | I | | |
| I-52. Bashkitë grumbullojnë tarifën fikse të ujitjes | | | | | | M,P,I | M,P,I | | |
| I-53. Procedura të reja për pagimin e tarifës dhe depozitat | | | P | P,I | | I | I | | |
| I-54. Adoptimi i politikës paguaj për shërbimin | | M | P,I | I | | I | I | | |
| Ngritja e kapaciteteve | | | | | | | | | |
| I-55. 12 module trajnimi të përgatitur | | M | P,M | I | | | | | F |
| I-56. Trajnim i dhënë SPUKV/MBZHR dhe NjUK dhe OPU | | M | M,P | I | I | I | I | | F |
| I-57. Trajnim shtesë për SPUKV/MBZHR | | M | M,P | I | I | | | | F |
| I-58. Konsultime menaxhimi për Planin e Përmirësimit Ujitjes | | | P | P,I | I | I | | F | F |
| I-59. Auditime të Menaxhimit të Ujitjes | | | | P,I | I | I | I | F | F |
| I-60. Udhëzues për PPP përgatitur dhe mundësitë e identifikimit | | M | M,P | I | | | | | F |
| I-61. Sektori Ngritjes Kapaciteteve i krijuar | M | M | M,P,I | I | | | | F | F |

* P=Planifikimi F=Financimi, I=Implementimi, M dhe V=Monitorimi dhe vlerësimi, M=Miratimi

7.2.2 Indiktorët e performancës për të monitoruar dhe vlerësuar ndërhyrjet strategjike për ujitjen

Më poshtë paraqiten indiktorët potencialë, që mund të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar aktivitetet e ujitjes të zbatuar sipas kësaj strategjie. Nuk është praktike të zbatohen të gjitha, por përzgjedhja e tyre do të bëhet në varësi me mundësitë konkrete.

Indiktorë potencialë për inputet

1. Buxhetet e siguruar dhe shpenzuar për ngritjen dhe zhvillimin e Njësive të Ujitjes dhe Kullimit të bashkive;
2. Buxhetet e siguruar dhe shpenzuar për zhvillimin e OPU-ve;
3. Zërat për të cilat buxhetet janë përdorur (trajnim, organizim, riparime dhe përmirësime me pjesëmarrje etj.).

Indiktorë potencialë të implementimit

1. Numri i Njësive të U dhe K të bashkive ku është rekrutuar staf i kualifikuar

2. Trajnimi i kryer për Njësitë e U dhe K të bashkive
3. Trajnimi i kryer për OPU-të brenda bashkive
4. Kosto e programit të transferimit të menaxhimit të ujitjes për ha
5. Numri i OPU-ve të krijuara dhe regjistruara në gjykatë
6. % e anëtareve dhe stafit gra në OPU
7. % e anëtarëve dhe stafit në OPU që janë fermerë të vegjël
8. Roli i kryepreqve të fshatrave në ujitje dhe kullim
9. Përgatitja e Planit të Shërbimit të Ujitjes

Indikatorë potencialë të rezultateve (outcome)

1. Sipërfaqe me infrastrukturë ujitëse potencialisht që mund të ujitet
2. Sipërfaqe me infrastrukturë ujitëse funksionale
3. Sipërfaqe e ujitur
4. Sipërfaqe e përmirësuar (diferenca e sipërfaqes potencialisht të ujitshme me atë funksionale)
5. Numri i ha të ujitur x here/sasia e ujit për ha (m^3/ha sezon ujitës)
6. Numri i ha të ujitur y herë/sasia e ujit për ha (m^3/ha sezon ujitës)
7. Numri i ha të ujitur z herë/sasia e ujit për ha (m^3/ha sezon ujitës)
8. Sipërfaqe e ujitur rishtas (hera e parë në tre-pesë vitet e fundit)
9. % e bllokut terciar e pastruar dhe mirëmbajtur
10. % e bllokut sekondar e pastruar dhe mirëmbajtur
11. Volumi i aluvioneve të hequr nga blloku terciar dhe nga kanali sekondar
12. Sipërfaqja e çdo lloj kulture (sipas regjistrimit në format e kërkesave për ujë)
13. Kosto M dhe Sh për ha
14. Mbledhja e tarifave të ujit (%) = Faktike/Planifikuar
15. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Përmirësimit të Manaxhimit
16. Ndryshime në zonën e shërbimit të ujitjes
17. Ndryshime në prodhimin total të kulturave në bashki/OPU
18. Ndryshime në produktivitetin e kulturave për ha
19. Ndryshime në produktivitetin e kulturave për njësi ujitje
20. Ndryshime në intensitetin e kulturave

Indikatorë potencialë të impaktit

1. Ndryshime drejt mbjelljes së kulturave me vlerë të lartë
2. Prodhimi (rendiment max- R min)
3. Produktiviteti i tokës (kg/m^3)
4. Produktiviteti i ujit ($\$/m^3$)
5. Ndryshime në të ardhurat e fermerëve
6. Ndryshime në pagat e punonjësve në bujqësi
7. Rritja e punësimit në bujqësi (ditë punë/ha)

7.3 Komponenti strategjik 2: Kullimi

7.3.1 Matricat e përgjegjësi

Tabela 7.3.1 Matricat e përgjegjësi për kullimin

| Veprimtaria | KM | MBZHR | SPUK/M BZHR | Kon- sule- ntët | SPUKV/M BZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona- torët |
|--|----|-------|----------------|-----------------------|-----------------|-------|-----|-----|----------------|
| Rehabilitimi dhe zhvillimi | | | | | | | | | |
| D-1. Përgatitja e planit të rehabilitimit të 14 hidrovorëve | M | M | P,I | P,I | P | | | M,F | F |
| D-2. Vlerësimi i nevojës se deri në çfarë koeficienti kapaciteti kullues duhet të rritet | | M | P,I | P,I | P | | | | |
| D-3. Barazimi i sasisë se llumit të hequr dhe atij që krijohet nga prurjet | | | P | | P,I | I | I | F | |
| Menaxhimi | | | | | | | | | |

| Veprimtaria | KM | MBZHR | SPUK/M BZHR | Kon-sule-ntët | SPUKV/M BZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona-torët |
|--|-----|-------|-------------|---------------|--------------|-------|-----|-----|------------|
| D-4. Vlerësimi i cilësisë së kullimit dhe përgatitja e udhëzuesve | | | M,P,I | I | | | | | F |
| D-5. Vlerësimi i stafit dhe pajisjeve të nevojshme për kullim | | | P | | I | I | | F | |
| D-6. Angazhimi i fondeve për kullimin | | M | M,P,I | | I | | | F | F |
| D-7. Kanale të pastruar nga SPUKV/MBZHR bashkitë/OPU | | | M | M dhe V | M,I | M,I | I | F | |
| Financimi | | | | | | | | | |
| D-8. Analiza nevojave për subvencion | M,P | M,P | | I | | | | F | |
| D-9. Kanalet e tretë dhe kulluesit brenda parcelës të pastruar nga OPU | | | | | | M | I | F | |
| D-10. Pjesë e kostos të pastrimit të kolektorit kulluesit kryesore, nafta e eskavatoreve mbuluar nga OPU | | | | | | | F | | |
| D-11. Përfitësit nga kullimi të identifikuar | | | P | | I | I | I | | F |
| D-12. Përcaktimi i pjesës që do paguhet nga shteti | M | M | P | I | I | I | I | | F |
| Ngritja e kapaciteteve | | | | | | | | | |
| D-13. Trajnimi për kullimin përgatitja dhe kryerja | | | P,I | I | I | I | I | | F |

* P=Planifikimi, F=Financimi, I=Implementimi, M dhe V=Monitorimi dhe Vlerësimi, M=Miratimi

7.3.2 Indikatorët e performancës për të monitoruar dhe vlerësuar ndërhyrjet strategjike për kullimin

Më poshtë paraqiten indikatorët potencialë që mund të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e përmirësimeve në kullim.

Indikatorë potencialë për inputet

1. Metër kanal kryesor dhe kolektorë kullimi për ekskavator
2. Metër kanal kryesor kullues për dragë
3. Buxhet i mjaftueshëm për kullimin (buxheti i alokuar/ nevojat)
4. Dendësia e kullimit (m.l/ha)

Indikatorë potencialë të zbatimit

1. Metër kanal të pastruar mesatarisht në ditë
2. Kosto mesatare e pastrimit të kanalit kryesor dhe kolektorëve të kullimit për 100 metër
3. Kanale të tretë dhe të dytë të pastruar çdo vit

Indikatorë potenciale të rezultateve (outcome)

1. Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër të kanaleve kryesore
2. Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër të kanaleve sekondare
2. Volumi i aluvioneve të hequr për çdo 100 metër të kanaleve terciare

Indikatorë potencialë të impaktit

1. Ndryshime të sipërfaqes me probleme kullimi
2. Sipërfaqe e bonifikuar nga ujërat sipërfaqësore ose probleme të tjera kullimi

7.4 Komponenti strategjik 3: Siguria e shfrytëzimi i digave

7.4.1 Matrica e përgjegjësive

Tabela 7.4.1 Matrica e përgjegjësive për sigurinë dhe shfrytëzimin e digave

| Veprimtaria | KM | MBZH | SPUK/M | Kon- | SPUKV/ | NjUKB | OPU | MFE | Dona- |
|-------------|----|------|--------|------|--------|-------|-----|-----|-------|
|-------------|----|------|--------|------|--------|-------|-----|-----|-------|

| | | R | BZHR | sule- ntët | MBZHR | | | | torët |
|--|---|-----|-------|---------------|-------|---|--|---|-------|
| Rregullimet për sigurinë e digave | | | | | | | | | |
| DR-1. Zgjidhja çështjeve teknike dhe jo-teknike | | M,I | M,I | | M,I | | | | |
| DR-2. Politika të rregullores të sigurisë së digave | M | M | M,P,I | I | I | | | | |
| DR-3. Autoriteti / përgjegjësitë të përcaktuara nga rregulloret e sigurisë së digave | | | M | | I | I | | F | |
| DR-4. Inventarizimi i të gjitha digave dhe rezervuarëve | | | M,P | | I | I | | F | F |
| DR-5. Objekti i rregullores të sigurisë së digave i përcaktuar | | | M,P,I | I | I | | | | |
| DR-6. Sistemi i raportimit të rrezikut të digave i miratuar | | M | M,P,I | I | I | I | | | F |
| Rregullime institucionale dhe financimi | | | | | | | | | |
| DR-7. Sektori i Sigurisë së Digave i forcuar | M | M | M,P,I | I | | | | | F |
| DR-8. Rregullore për Sektorin e Sigurisë së Digave | M | M | M,P,I | I | | | | | F |
| DR-9. Kriteret e lejuara për transferimin e menaxhimit të digave | M | M | M,P,I | I | | | | | |
| Funksionet dhe kompetencat e Sektorit të Sigurisë së Digave | | | | | | | | | |
| DR-10. Norma dhe standarde të reja për sigurinë e digave | | M | M,P,I | I | I | I | | F | F |
| DR-11. Sektori i Sigurisë së Digave i jepet autoriteti të miratojë digat | M | M | M | | | | | | |
| DR-12. Inspektime periodike të digave prej Sektorit të Sigurisë së Digave | | M | P,I | | | | | F | |
| DR-13. Pale e tretë merr pjesë në inspektim | | | | I | | | | | |
| DR-14. Angazhim i stafit të nevojshëm | | M | P,I | | | | | F | |
| DR-15. Sektori i Sigurisë së Digave ka autoritetin të miratojë përmirësimin e digave | M | M | M | | | | | | |
| Rehabilitimi dhe modernizimi | | | | | | | | | |
| DR-16. Udhëzues i vlerësimit të nevojave të rehabilitimit të digave | | M | P,I | I | | | | | |
| DR-17. Udhëzues i vlerësimit të nevojave për modernizimin e digave | | M | P,I | I | | | | | |
| Ngritja e kapaciteteve | | | | | | | | | |
| DR-18. Rregullore mbi M dhe Sh | | M | P,I | I | | | | | |
| DR-19. Përgatitja e manualeve dhe moduleve të trajnimit | | M | M,P | I | | | | | F |
| DR-20. Manuale/module mbi rregulloren e sigurisë së digave | | M | M,P | I | | | | | F |
| DR-21. Trajnime për stafin Sektorin e Sigurisë së Digave dhe pronarëve të digave | | M | P | I | | | | | F |

* P=Planifikimi, F=Financimi, I=Implementimi, M dhe V=Monitorimi dhe vlerësime, M=Miratimi

7.4.2 Indiktorët e performancës për të monitoruar dhe vlerësuar ndërhyrjet strategjike për sigurinë dhe shfrytëzimin e digave

Indiktorë potencialë të inputeve

1. Trendi i buxhetit të shtetit për riparimin dhe mirëmbajtjen e digave
2. Buxhetet e bashkive për riparimin dhe mirëmbajtjen e digave
3. Politika të reja për sigurinë dhe përdorimin e digave

Indiktorë potencialë të zbatimit

1. Volumi i mirëmbajtjes dhe kostot e riparimit të bërë për digat
2. Buxheti vjetor i përafërt i shpenzuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e digave
3. Shpeshësia e riparimeve apo mirëmbajtjes
4. Shkalla në të cilën aluvionet janë hequr nga rezervuarët

Indikatorë potencialë të rezultateve

1. Gjendja funksionale të digave dhe rezervuarve
2. Shkalla e mbushjes së rezervuarëve nga aluvionet
3. Disponueshmëria e ujit në fillim të sezonit
4. Disponueshmëria e ujit në raport me kërkesat

Indikatorë potencialë të impaktit

1. Sasia dhe cilësia e ujit në zonën aktive të depozitimit në raport me kërkesën potenciale
2. Frekuenca e vërtetimeve të gabimeve në sigurinë e digave në inspektime

7.5 Komponenti Strategjik 4: Mbrojtja nga përmbytjet

7.5.1 Matricat e përgjegjësi

Tabela 7.5.1 Matrica e përgjegjësi për mbrojtjen nga përmbytjet

| Veprimtaria | KM | MBZHR | SPUK/MBZHR | Kon-sule-ntët | SPUKV/MBZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona-torët |
|---|-------|-------|------------|---------------|-------------|-------|-----|-----|------------|
| Qasje e menaxhimit të integruar të baseneve të lumenjve | | | | | | | | | |
| FP-1. Politika të solidaritetit për mbrojtjen nga përmbytja | M,P,I | | I | | I | | | | |
| Zhvillimi struktural | | | | | | | | | |
| FP-2. Inventari i strukturave/veprave të mbrojtës nga përmbytjet | | | M,P,I | I | I | | | F | F |
| FP-3. Vlerësimi i strukturave/veprave mbrojtjes nga përmbytjet | | M | M,P,I | I | I | | | F | |
| FP-4. Identifikimi ku janë të nevojshme strukturat e mbrojtjes nga përmbytjet | | M | M,P,I | I | I | | | F | F |
| FP-5. Angazhim i fondeve për studim dhe projektim | | M | M,P,I | I | I | | | F | F |
| FP-6. Përgatitja e rregulloreve për standardet e ndërtimit | | M | M,P,I | I | I | | | F | |
| FP-7. Ndërtimi i strukturave të domosdoshme të mbrojtjes nga përmbytjet | | M | M,P,I | I | I | | | | F |
| FP-8. Riparimi i strukturave me risk të lartë | | M | M,P,I | I | I | | | | F |
| FP-9. Politika për ndërtimin e pendëve mbrojtëse të lumenjve dhe digave | | M | M,P,I | | | | | | |
| FP-10. Furnizime me barrierave për mbrojtje nga përmbytjet | | M | M,P,I | | I | | | F | |
| Financimi | | | | | | | | | |
| FP-11. Plan financiar për investime në mbrojtje nga përmbytjet | | M | P,I | I | I | | | | F |
| FP-12. Studim për investime në kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet | | M | P | I | I | | | | F |
| FP-13. Përgatitja e Planeve të Investimeve kundër Përmbytjeve | | M | P,I | I | I | | | F | |
| FP-14. Plani dhe financimi për ndërhyrjet në mbrojtjen e vijës bregdetare | | M | P | I | I | | | | F |

* P=Planifikimi, F=Financimi, I=Implementimi, M dhe V=Monitorimi dhe vlerësimi, M=Miratimi

7.5.2 Indikatorët e performancës për monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve strategjike për mbrojtjen nga përmbytjet

Indikatorë të inputeve

1. Trendi i buxhetit për veprat mbrojtëse nga përmbytjet
2. Ndërtimi i veprave të mbrojtjes nga përmbytjet

Indikatorë të zbatimit

1. Përshtatja dhe përmirësimi i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet

2. Trendi në volumet e punëve të veprave që do ndërtohen për mbrojtjen nga përmbytjet

Indikatorë potencialë të rezultateve

1. Shkalla e realizimit të planeve për ndërtimin e veprave të mbrojtjes nga përmbytjet

Indikatorë të impaktit

1. Numri i njerëzve të vdekur apo të dëmtuar nga përmbytjet

2. Niveli i dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet

3. Përqindja e volumit të ujit të mbetur në zonat e evokuara nga përmbytja

4. Rreziku nga përmbytja (sipërfaqe e përmbytur)

8. Financim i qëndrueshëm i ujitjes, kullimit, sigurisë dhe shfrytëzimit të digave dhe mbrojtjes nga përmbytjet

8.1 Parimet e financimit efektiv dhe të qëndrueshëm

Më poshtë jepen shtatë parimet bazë të financimit efektiv dhe të qëndrueshëm për ujitjen, kullimin, sigurinë dhe shfrytëzimin e digave dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

1. Investime në rehabilitim dhe modernizim bazuar në prioritete

Investimet në infrastrukturë në sistemet e ujitjes dhe kullimit, digat dhe rezervuarët, dhe mbrojtjen nga përmbytjet duhet të bazohen mbi kritere objektive të tilla si numri i përfituesve, shkalla e përfitimit, trajtim i barabartë, efektiviteti i kostos etj. Investimet nuk duhet të ndikohen prej interesave të veçanta.

2. Buxhetim i bazuar mbi nevojat dhe tarifa në nivel-sistemi.

Buxhetet për M dhe Sh vjetor të sistemeve të ujitjes dhe kullimit duhet të përgatiten bazuar mbi koston faktike dhe eficientë të menaxhimit të një sistemi ujitës, bazuar në standarde shërbimi të pranuar. Tarifat e ujitjes do të bazohen në koston faktike.

3. Bashkitë marrin përgjegjësi për mbledhjen dhe përdorimin e fondeve për ujitjen në nivel të kanaleve sekondare dhe terciare

Bashkitë kanë ose do të kenë mundësinë e mbledhjes, menaxhimit dhe përdorimit të fondeve për ujitjen në kanalet e dyta dhe të treta të sistemit. Ato mund të zhvillojnë praktika transparente dhe të verifikueshme të mbajtjes së llogarive. Ndërsa OPU-të mund të marrin një rol në rritje për qeverisjen dhe menaxhimin e sistemeve ujitëse dhe kulluese në nivele terciare dhe sekondare, bashkitë duhet të jenë përgjegjëse për menaxhimin/mbikëqyrjen financiare për një periudhë afatgjatë në të ardhmen.

4. Ndarja e kostove fikse dhe kostove variable të sistemeve ujitëse dhe kulluese

Kostot fikse të ujitjes përfshijnë koston për mirëmbajtjen rutinë dhe dëmtimet e rastit të sistemit, koston për zyrën dhe pagesën e stafit. Sistemet e ujitjes dhe kullimit dhe zhvillimi i tyre rrisin mundësitë ekonomike në zonë si dhe vlerën e tokës. Të gjithë pronarët e tokave brenda zonës potencialisht të ujitshme dhe kulluese do të paguajnë tarifën vjetore të ujitjes për të mbuluar këto kosto. Pagesa e kësaj tarife nga një numër i madh i pronarëve të tokave do të ulë koston për person. Përderisa koston fikse do të mbulohej tashmë nga kjo tarifë, kostoja e ndryshueshme e shërbimit të ujitjes së ofruar faktikisht për ata që ujitin do të jetë shumë më e ulët se aktualisht. Kjo do të inkurajojë më shumë fermerë për të ujitur.

5. Mbulimi i pjesshëm i koston të kullimit

Kur të jenë identifikuar përfituesit direkt të kullimit, pritet që ata të paguajnë një tarifë për shërbimin e kullimit. Përfituesit indirekt të kullimit, të cilët nuk mund të identifikohen, nuk do të paguajnë tarifë. Pjesët e tjera të koston të kullimit do të mbulohej nga buxheti i shtetit.

6. Arritja e mirëmbajtjes së plotë për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe produktivitetit

Nuk ka objektiv më të rëndësishëm se sa arritja e mirëmbajtjes së plotë të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe rezervuarve dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytjet. Kjo do të sigurojë qëndrueshmëri dhe efektivitetin e investimeve në infrastrukturë, produktivitetin e bujqësisë së ujitshme dhe bizneseve të tjera rurale, dhe mbrojtjen e njerëzve dhe pronës.

7. Investime adekuate në mbrojtjen nga përmbytjet

Qeveria duhet të përgatisë një plan që të mundësojë investime optimale në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet dhe mirëmbajtjen e saj me qëllim që të mbrojë vendin nga përmbytjet, të cilat po ndodhin gjithnjë e më shpesh, janë më të mëdha dhe të shpërndara në zona të

ndryshme. Duhet të identifikohen dhe mund të jenë të nevojshme edhe sigurimet nga përmbytjet për disa lloje biznesesh.

8.2 Financimi i rehabilitimit, modernizimit dhe menaxhimit të ujitjes

Rehabilitimi dhe modernizimi i ujitjes

Kostoja totale e rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes, e vlerësuar nga MBZHR-ja shkon në rreth 253.6 milionë USD.

Menaxhimi i ujitjes

Siç është përmendur më sipër në seksionin 7, kostoja e përvitshme rutinë e shërbimit të ujitjes në nivel të kanaleve terciare dhe sekondare do të paguhet nga kombinimi i dy tarifave. Tarifa bazë e ujitjes do të mbulojë kostot fikse çdo vit, pavarësisht reshjeve të atij viti (mirëmbajtje e kanaleve dhe strukturave, zyra, staf). Është e nevojshme të sigurohet rekrutimi i stafit me kualifikimin e duhur, të zhvillohen incentiva dhe ndoshta edhe bonuse për performancën me cilësi të lartë të punës, dhe kombinime optimale të ndihmës nga shteti me investimet e përdoruesve të ujit.

Bashkia do të marrë të gjitha masat që të grumbulloje tarifën bazë të ujitjes prej të gjithë pronarëve të tokave brenda zonës potencialisht të ujitshme. Ndërsa tarifa e shërbimit të ujitjes do të mbulojë kostot variabël të sigurimit faktik të ujit për ujitje, për fermerët që kanë një marrëveshje shërbimi me Njësinë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkisë.

Për ata, të cilët ujin faktikisht do të kërkohet të bëjnë edhe pagesën për tarifën e shërbimit të ujitjes, siç është rënë dakord përpara se t'u jepet shërbimi.

Kostoja e pastrimit të të kanaleve kryesorë të kullimit dhe kolektorëve do të paguhet nga buxheti i shtetit. Kostoja e pastrimit në fermë dhe kullimit të anësoreve do të mbulohet nga përfituesit e sistemit të kullimit.

Në nivel ferme, kostoja e përafërt e M dhe Sh vjetor të infrastrukturës së ujitjes vlerësohet në rreth 20-50 USD për ha.

Tabela 8.2 tregon kostot e vlerësuara, të nevojshme për të zbatuar veprimtaritë në ujitje që janë të përfshira në këtë strategji. Po kështu, në tabelë përfshihen edhe veprimtari pa kosto të programuar në nënsektorët e ujitjes, kullimit, sigurisë së digave dhe mbrojtjes nga përmbytjet.

Tabela 8.2 Kostot e vlerësuara për veprimtaritë e ujitjes

| Veprimtaritë | Kosto e vlerësuar në USD |
|--|--------------------------|
| Ujitja dhe bujqësia | |
| I-1. Projektet në ujitje dhe bujqësi të implementohen në mënyrë paralele | |
| I-2. Fokusi në produktivitetin e fermave të vogla dhe agrobiznesin | |
| I-3. Konsolidimi i aktivitetëve në fermë | |
| I-4. Veprimtari kërkimi dhe zhvillimi për kultura bujqësore me vlerë të lartë, në përpunim dhe marketing | |
| Zhvillim | |
| I-5. Udhëzues për rehabilitimin dhe modernizimin me pjesëmarrje | 8,000 |
| I-6. Udhëzues për ndërtimin e sistemeve të reja me pjesëmarrje | |
| I-7. Përgatitja e Planit të Investimeve | 10,000 |
| I-8. Angazhimi i fondeve për Planin e Investimeve | |
| I-9. Përcaktimi i kostos të investimit që do të bashkëfinancohet nga fermerët | 1 milion |
| I-10. OPU investojnë në rehabilitimin e kanaleve të treta. | |
| I-11. Kompletimi i rehabilitimit të infrastrukturës ujitëse për 100 000 ha (vazhdim) | 24 milionë |
| I-12. Rehabilitimi i infrastrukturës ujitëse për 140 000 ha, përfshirë studim/projektim | 164 milion |

| | |
|---|-----------|
| I-14. Zhvillimi i programit të modernizimit | 16,000 |
| I-15. Angazhimi i fondeve dhe zbatimi i modernizimit | 9,600 |
| I-16. Identifikimi dhe rehabilitimi i stacioneve të pompimit, për ujitje me ngritje mekanike të rreth 75 000 ha | 60 milion |
| Aspekte rregullatore/mbikëqyrje | |
| I-17. Miratimi i vendimeve për investime në ujitje | |
| I-18. Supervizioni i investimeve | |
| I-19. Monitorimi i punimeve civile të investimeve | |
| I-20. Udhëzues për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes | 6,500 |
| I-21. Udhëzues për Auditimin e Menaxhim Ujitje për SPUKV/MBZHR | 4,000 |
| I-22. Zbatimi i Auditimit të Menaxhimit të Ujitjes çdo 2-vjet | 500,000 |
| Qeverisja e sistemit dhe institucionet | |
| I-23. Ndryshimet në nivel qendror dhe rajonal të MBZHR | 8,000 |
| I-24. Përgatitja e moduleve, krijimi OPU, statuti dhe rregullore | 8,000 |
| I-25. Plani për krijimin e OPU | 6,000 |
| I-26. Rekrutimi dhe trajnimi organizimi i ekipit të ujitjes | 400,000 |
| I-27. Marrja e firmave për krijimin e OPU | |
| I-28. Roli i kryepaqjeve para krijimit të OPU | |
| I-29. Përgatitja e udhëzuesit për TMU | 8,000 |
| I-30. Krijimi i OPU dhe GPU | 640,000 |
| I-31. Përgatitja dhe adaptimi i statutit për OPU | |
| I-32. Përgatitja dhe adaptimi e rregullores për OPU | |
| I-33. Bashkitë menaxhojnë sistemet ujitëse (sekondaret dhe sistemet e mesme dhe vogla) | |
| I-34. Bashkitë rekrutojnë stafet për Njësitë e Ujitjes | |
| I-35. Transferimi i pronësisë të kanaleve | |
| I-36. OPU të trajnuara në ujitje, menaxhim dhe financë | 80,000 |
| I-37. E drejta e përdorimit e kanaleve sekondare/terciare transferuar OPU | |
| I-38. E drejta e përdorimit e sistemeve të vogla transferohet në OPU | |
| I-39. Politikat e kushteve të heqjes së pronësisë/të drejtës së përdorimit | 8,000 |
| I-40. SPUKV/MBZHR ngrenë kapacitetet e Nj. U dhe K të bashkive | 2 milion |
| I-41. Ndërhyrja me masa incentivuese/llogaridhënëse | |
| Menaxhimi | |
| I-42. Përfshirja e kriterëve të performancës në manualin e O dhe M | 8,000 |
| I-43. PShU dhe buxheti i përgatitur | |
| I-44. Udhëzuesi i PShU përgatitur | 8,000 |
| I-45. PShU bazuar mbi kërkesat për ujë | |
| I-46. MBZHR-ja synon sigurimin e fondeve për kërkime U dhe K | |
| I-47. Instalimi i mjeteve matëse të ujit | 80,000 |
| I-48. Trajnim për zgjidhjen e konflikteve | 4,000 |
| Financimi | |
| I-49. Politika për pagimin e kostove fikse dhe variabël | |
| I-50. Përgatitja e Udhëzuesit të buxhetit bazuar në nevojat dhe PShU | 4,000 |
| I-51. Buxhetet dhe PShU përgatitur | |
| I-52. Bashkitë grumbullojnë kostot fikse të ujitjes | |
| I-53. Procedura të reja për pagesën e tarifës dhe depozitat | |
| I-54. Politika për pagimin e shërbimit të ofruar e miratuar | |

| Ndërtimi i kapaciteteve | |
|--|--------------------------|
| I-55. 12 module trajnimi të përgatitur | |
| I-56. Trajnimi i dhënë SPUKV/MBZHR dhe Nj. Ujitjes dhe K dhe OPU | |
| I-57. Trajnime shitesë përgatitjen dhe dhënë te SPUKV/MBZHR | |
| I-58. Konsultime menaxhimi për Planin e Përmirësimit të Ujitjes | 600,000 |
| I-59. Auditimi i Menaxhimit të Ujitjes i kryer | 200,000 |
| I-60. Udhëzues për PPP i përgatitur dhe mundësitë e identifikuar | 4,000 |
| I-61. Krijimi i Njësisë së Ngritjes së Kapaciteteve | |
| Totali | 253.6 milionë USD |

8.3 Financimi i rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve të kullimit

Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve të kullimit

Kostoja e vlerësuar për kthimin e infrastrukturës së kullimit në funksion të plotë (pa përfshirë mirëmbajtjen ciklike vjetore dhe funksionimin e hidrovorëve) shkon 56.3 milionë USD. Kjo është detajuar në tabelën 8.2.

Tabela 8.3. Kosto për rikthimin e sistemit kullues në funksionalitet të plotë

Heqja e 18 milionë m³ aluvione rrjeti i kanaleve kullues 25.7 milionë USD;
 Heqja e 2 milionë m³ aluvione prej kanaleve të ujërave të lartë 2.8 milionë USD;
 Rehabilitimi i 14 hidrovorëve në ultësirën perëndimore të vendit 15.8 milionë USD;
 Sistemi kullimit dhe ndërtimi i hidrovorëve të rinj në Maliq dhe Torroviçë 12 milionë USD.

TOTAL 56.3 milionë USD

Tabela 8.3 tregon kostot e vlerësuara për t'u mbuluar nga buxheti dhe donatorë për të implementuar veprimtaritë për kullimin që janë të përfshira në këtë strategji.

Tabela 8.3 Kostot e vlerësuara për veprimtaritë për kullimin

| Aktivitetet | Kosto e përafërt në USD |
|--|--------------------------------|
| Zhvillimi | |
| D-1. Plan për financimin dhe rehabilitimin e 14 hidrovorëve dhe rikonstruksionin e rrjete kulluese të tokave torfike Torroviçë e Maliq | 27.8 milion |
| D-2. Vlerësimi i nevojave për rritjen e kapacitetit të kullimit | 80,000 |
| D-3. E njëjta sasi e aluvioneve që vijnë me atë që hiqen | |
| Menaxhimi | |
| D-4. Vlerësimi i cilësisë së kullimit dhe bërja e udhëzuesit | 100,000 |
| D-5. Vlerësim i stafit, pajisjeve të nevojshme për kullimin | 4,000 |
| D-6. Angazhimi i fondeve për kullimin | |
| D-7. Kulluesit e pastruar nga SPUKV/MBZHR dhe bashkitë dhe OPU-të | 28.5 milion |
| Financimi | |
| D-8. Analizimi i nevojave për subvencione | 8,000 |
| D-9. Kulluesit e tretë anash parcelave pastruar prej OPU | |
| D-10. OPU/OK paguajnë pjesërisht pastrimin e kolektorëve dhe kanaleve kryesore kullues | |
| D-11. Identifikimi i përfituesve nga kullimi | 8,000 |
| D-12. Identifikimi i shërbimit të kullimit që do paguhet nga shteti | 8,000 |
| Ndërtimi i kapaciteteve | |
| D-13. Trajnimi i kullimit i përgatitur dhe ofruar | 24,000 |

Totali: 56.53 milionë USD

8.4 Financimi i rehabilitimit dhe modernizimit të digave dhe rezervuarve

Nga vlerësimet e bëra, rezulton se në total kostoja për sigurinë e digave arrin në rreth 130.2 milionë USD, ku rehabilitimi i 410 digave kushton rreth 120 milionë USD, të ndara në:

- 104.4 milionë USD për rehabilitimin dhe modernizimin e 300 digave, për garantimin e burimit ujor dhe rritjen e sigurisë së tyre;
- 7.2 milionë USD për garantimin e sigurisë së 40 digave;
- 8.4 milionë USD për punime rikonstruktuese e përshtatëse, për abandonimin e 70 digave.

Tabela 8.4 tregon kostot e vlerësuara për t'u mbuluar nga buxheti dhe donatorë për të implementuar veprimtaritë për modernizimin e digave dhe rezervuarve, që janë të përfshira në këtë strategji.

Tabela 8.4 Kostot e vlerësuara për veprimtaritë për sigurinë e digave

| Veprimtaria | Kostoja e përafërt në USD |
|---|---------------------------|
| Rregullimet | |
| DR-1. Zgjidhja e çështjeve teknike dhe jo-teknike | |
| DR-2. Politika mbi rregullat e sigurisë së digave | |
| DR-3. Siguria e digave ka autoritetin/përgjegjësinë | |
| DR-4. Inventari i të gjitha digave dhe rezervuarve/studime fisibiliteti | 10 milion |
| DR-5. Përcaktuar detyrat e rregullores e sigurisë të digave | 8,000 |
| DR-6. Adoptuar sistemi i raportimit të rrezikut të digave | 5,000 |
| Rregullimet/marrëveshjet institucionale dhe financimi | |
| DR-7. Forcimi i procedurave të sigurisë së digave | 50,000 |
| DR-8. Rregullore mbi sigurinë e digave | 5,000 |
| DR-9. Kriteret e lejuara për transferimin e menaxhimit të digave | 8,000 |
| Funksionet dhe autoriteti i njësisë mbikëqyrëse | |
| DR-10. Norma dhe standarde të reja përcaktuar për sigurinë e digave | 10,000 |
| DR-11. SSD jepet autoritet për miratimin e digave | 8,000 |
| DR-12. Inspektim periodik i digave prej SSD | 100,000 |
| DR-13. Një palë e tretë asiston në inspektim | 1,000 |
| DR-14. Mobilizimi i stafit të nevojshëm | |
| DR-15. SSD ka autoritetin të miratojë përmirësimin e digave | 5,000 |
| Rehabilitimi dhe modernizimi | |
| DR-16. Udhëzues për nevojat paraprake të rehab. digave | 12,000 |
| DR-17. Udhëzues për vlerësimin paraprak të modernizimit të digave | 12,000 |
| Ndërtimi i kapaciteteve | |
| DR-18. Rregulloret për pronarët dhe përdoruesit e digave | 8,000 |
| DR-19. Përgatitja e manualeve dhe moduleve të trajnimit | 12,000 |
| DR-20. Manuale/module për rregulloret e sig. së digave | 12,000 |
| DR-21. Trajnim për stafin e ASD dhe pronarët e digave | 20,000 |

Totali (përfshirë kostot e rehabilitimit të 410 digave) **130.2 milionë USD**

8.5 Financimi i mbrojtjes nga përmbytjet

Kostoja e përgjithshme e vlerësuar për rehabilitimin dhe ndërtimin e veprave të mbrojtjes nga përmbytjet të nevojshme shkon në rreth 276.8 milionë USD. Ndërsa tabela 8.5 paraqet koston e detajuar për investime prioritare që shkojnë në rreth 166 milionë USD.

Tabela 8.5 Kosto e investimeve prioritare të mbrojtjes nga përmbytjet

1. Studim fizibiliteti dhe projekt zbatimi për infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja në lumenjtë Erzen–Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë **6.9 milionë USD**
2. Hartimi i projektidesë përfundimtare dhe projektit të zbatimit për **\$ 5.5 milionë**

| | |
|---|----------------------------|
| mbrojtjen nga përmbytja të zonës së Nënshkodrës duke konsideruar edhe lundrimin në lumin Buna: | USD |
| 3. Rehabilitimi/rikonstruksioni i argjinaturave mbrojtëse në të dyja anët e lumit Mat nga Ura e Zogut në grykëderdhje | \$ 10.6 milionë USD |
| 4. Ndërtimi/rikonstruksioni i infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytja përgjatë lumenjve Drin, Bunë dhe zonën e Nënshkodrës për mbrojtjen nga përmbytja të rreth 12 000 ha tokë bujqësore e zona urbane, si dhe sistemimin e shtratit të lumit Bunë për të mundësuar lundrimin në këtë lum: | \$ 81 milionë USD |
| 5. Ndërtimi/rikonstruksioni i argjinaturave mbrojtëse përgjatë lumenjve kryesore në pjesën e ultësirës perëndimore për të minimizuar rrezikun e përmbytjeve në rreth 100 000 ha: | \$ 62 milionë USD |
| TOTALI | \$166 milionë USD |

Rehabilitimi dhe modernizimi do të jetë një përpjekje e kushtueshme që do të kërkojë kohë dhe asistencë financiare nga institucionet ndërkombëtare. Vlerësimi i nevojave dhe studimet e fisibilitetit janë të nevojshme për rehabilitimin ose rikonstruksionin e veprave të mbrojtjes nga përmbytjet. Investimet për paralajmërimin nga përmbytjet dhe strategjitë për reagimin në kohë do të kërkojnë rekrutime të stafit të duhur dhe trajnime lidhur me ekspertizën dhe aftësimin e tyre.

Tabela 8.5 tregon kostot e vlerësuara për t'u mbuluar nga buxheti dhe donatorë për të implementuar veprimtaritë e mbrojtjes nga përmbytjet dhe reagimit, që janë të përfshira në këtë strategji.

Tabela 8.5 Kostot e vlerësuara për veprimtaritë e mbrojtjes nga përmbytjet

| Veprimtaria | Kosto e përafërt |
|--|-------------------------------|
| Qasja e menaxhimit të integruar të baseneve lumore | |
| FP-1. Politika të solidaritetit për mbrojtjen nga përmbytjet | |
| Zhvillimi strukturor | |
| FP-2. Inventari i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet | 40,000 |
| FP-3. Vlerësimi i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet | 300,000 |
| FP-4. Identifikim i strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet që janë të nevojshme | 14,000 |
| FP-5. Rregullore mbi standardet e ndërtimit | 4,000 |
| FP-6. Angazhimi i fondeve për të bërë studime fisibiliteti dhe projekte | 14,000 |
| FP-7. Ndërtimi i strukturave mbrojtëse nga përmbytjet ku janë prioritet | 98.5 milion |
| FP-8. Rehabilitim/rikonstruksion i strukturave me risk të lartë | 67.5 milion |
| FP-9. Politika për ndërtimin e argjinaturave dhe pendëve tërthore | |
| FP-10. Sigurimi dhe shpërndarja e barrierave mbrojtëse nga përmbytjet | 10 milion |
| FP-11. Planifikimi dhe financimi i mbrojtjes bregdetare | 100 milion |
| Financimi | |
| FP-12. Plan financimi për investimet në mbrojtjen nga përmbytjet | 8,000 |
| FP-13. Studimi i investimeve në kullim dhe mbrojtje përmbytjet | 70,000 |
| FP-14. Përgatitja e planeve të mbrojtjes nga përmbytjet | 400,000 |
| TOTALI | \$ 276,850 milionë USD |

Si përfundim, kostoja totale e vlerësuar e rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet dhe siguria e digave është në total 717 milionë USD.

Prioritete kryesore janë vazhdimi i rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes, rehabilitimi dhe rritja e sigurisë së digave, pastrimi i kanaleve kryesore dhe sekondare kullues, rehabilitimi i 14 hidrovoreve dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, si dhe kryerja e studimeve përkatëse të fisibilitetit/projekteve të zbatimit. Sidoqoftë, asnjë nga këto investime nuk do të jenë efektive, nëse nuk sigurohet mirëmbajtja e nevojshme dhe shfrytëzimi i përshtatshëm nga institucione dhe praktika menaxhimi efektive. Kjo nënvizon edhe nevojën për reforma institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve.

9. Mobilizimi i resurseve për mbështetjen e kësaj strategjie

Për implementimin e kësaj strategjie është e nevojshme mobilizimi i burimeve të mëdha financiare, jo vetëm nga burime të brendshme por edhe grante ose hua prej institucioneve financiare ose donatoreve bilateral. Këto fonde janë të nevojshme për investimet në rehabilitim, modernizim dhe zhvillim të infrastrukturës të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytjet.

Për periudhën 2013–2015, totali i investimeve në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja ka qenë rreth 2.5 miliardë lekë. Ndërsa për vitet 2016–2018, investimet në total kanë qenë rreth 11.5 miliardë lekë, nga të cilat 3.7 miliardë lekë për bashkitë për funksionet e ujitjes dhe të kullimit, ose në total rreth 5 herë më shumë krahasuar me 2013–2015.

Për periudhën 2019–2021, referuar tavaneve buxhetore janë parashikuar investime në total 8.1 miliardë lekë, nga të cilat 3 miliardë lekë për objektet që administrohen nga bashkitë. Për 10-vjeçarin në vijim (2022–2031), nevojat për investime parashikohen në rreth 70.8 miliardë lekë, të ndara për secilin vit, duke konsideruar më përparësi kërkesat e bashkive.

10. Aneksi 1: Plani i Veprimit

Kjo strategji shoqërohet me aneksin 1: Plani i Veprimit, ku janë paraqitur paralelisht veprimtaritë (aktivitetet), që do të ndërmerren në implementimin e strategjisë, përgjegjësit e realizimit të këtyre veprimtarive, periodha (koha) e implementimit të tyre, rezultatet e pritshme, ecuria e realizimit të objektivave strategjike, si dhe kostot e vlerësuara të realizimit të objektivave strategjike.

Aneksi 1: Plani i Veprimit

| Aneksi 1: Plani i Veprimit | | | | | | | | | | | | |
|----------------------------|--|-------------|--|-------------|------------------------------------|--------------------|--|-----|------------|---------|-------------|--|
| | Shpjegim | P F I | Planifikimi Financimi Implementimi | M&V M | Monitorimi & Vlerësimi Miratimi | I D DR FP | Veprimtaritë për Ujitjen Veprimtaritë për Kullimin Veprimtaritë për Digat Veprimtaritë për Mbrojtjen nga Përmytja | | | | | |
| Veprimtaritë | Pergjegjes | | | | | | | | | | | |
| | KM | MBZHR | SPUK/MBZHR | Konsulentët | SPUKV/MBZHR | NjUKB | OPU | MFE | Dona-torët | Fillimi | Kohëzgjatja | |
| 1+2 | Total tavan te programit 04240 (1+2) | | | | | | | | | | | |
| 1 | Objektivat Strategjik | | | | | | | | | | | |
| | Ujitja | | | | | | | | | | | |
| | Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar ujitjen në sipërfaqen potencialisht të ujitëshme | | | | | | | | | | | |
| | Kullimi | | | | | | | | | | | |
| | Rikthimi i infrastrukturës së kullimit në parametra optimal në sipërfaqen potencialisht të kullueshme | | | | | | | | | | | |
| | Pastrimi i rrjetit të kullimit | | | | | | | | | | | |
| | Sipërfaqe kulluese me rrjetin kryesorë kullues të pastruar si proces ciklik vjetore | | | | | | | | | | | |
| | Rehabilitimi i 14 hidrovoreve | | | | | | | | | | | |
| | Siguria e Digave | | | | | | | | | | | |
| | Rehabilitimi i rreth 410 digave (ose rreth 65% e numrit të përgjithshëm) për rritjen e sigurisë së tyre dhe garantimin e burimeve ujore për skemat egzistuese ujitese | | | | | | | | | | | |
| | Mbrojtje nga Përmytjet | | | | | | | | | | | |
| | Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmytja lumore dhe detare, nëpërmjet rehabilitimit/ rikonstruksionit të argjinaturave egzistuese dhe ndërtimit të strukturave reja | | | | | | | | | | | |
| 2 | Mirembajtje (per proceset ciklike vjetore dhe per mirembajtjen pas realizimit te investimeve) | | | | | | | | | | | |
| | Ujitje | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|-----|-------|--------|---|-------------|---|---|---------------|---------------|-----------------------|
| I-13. Studime për modernizimin e sistemeve ujitëse | | M | P | I | | | | F | Afat shkurtër | 6 muaj-1 vit | |
| I-14. Zhvillimi i programit të modernizimit | M | M | P | I | I | M | M | F | F | Afat shkurtër | 6 muaj |
| I-15. Angazhimi i fondeve & zbatimi i modernizimit | | P,M | P | I, M&V | I | I,M | | F | F | Afat mesëm | 12 vjet |
| I-16. Identifikimi & rehabilitimi i stacioneve të pompimit, për ujitje me ngritje mekanike të rreth 75 000 ha | | M | P | I, M&V | I | I | | F | F | Afat mesëm | 1 vit |
| Aspekte rregullatore/mbikqyrje | | | | | | | | | | | |
| I-17. Miratimi i vendimeve për investime në ujitje | M | M | M | | | | | | | Afat shkurtër | Përafërsisht 6 vjet |
| I-18. Supervizioni i investimeve | | | I | I | I | I | | | | Afat shkurtër | Në vazhdimësi |
| I-19. Monitorimi i punimeve civile të investimeve | | | I | I | I | I | | | | Afat shkurtër | Në vazhdimësi |
| I-20. Udhëzues për Auditimin e Menaxhimit të Ujitjes | | M | P | I | | | | F | | Afat shkurtër | 1 muaj |
| I-21. Udhëzues për Auditimin e Menaxhim Ujitje për SPUKV/MBZHR | | M | P | I | | | | F | | Afat mesëm | Në vazhdim afat gjatë |
| I-22. Zbatimi i Auditimit të Menaxhimit të Ujitjes çdo 2-vjet | | M | P | I | | | | F | | Afat shkurtër | Vazhdimësi |
| Qeverisja e sistemit dhe institucionet | | | | | | | | | | | |
| I-23. Ndryshimet në nivel qendror & rajonal të MBZHR | M | M,I | P,I | I | I | | | F | | Afat shkurtër | 3 vjet |
| I-24. Përgatitja e moduleve, krijimi OPU, statuti & rregullore | | M | P | I | | | | F | | Afat shkurtër | 3 vjet |
| I-25. Plani për krijimin e OPU | | M | P,I | I | | I | I | F | | Afat shkurtër | 6 muaj |
| I-26. Rekrutimi & trainimi organizimi i ekipit të ujitjes | | M | P | I | I | | | F | | Afat shkurtër | 6 muaj |
| I-27. Marrja e firmave për krijimin e OPU | | M | P,I | I | I | | | F | | Afat shkurtër | 5 vjet |
| I-28. Roli i kryepleqve para krijimit të OPU | | M | P | | I | I | | F | | Afat shkurtër | 5 vjet |
| I-29. Përgatitja e udhëzuesit për TMU | | M | P,I | I | | | | F | | Afat shkurtër | 6 muaj |
| I-30. Krijimi i OPU & GPU | | M | P | I | | I | I | F | | Afat shkurtër | 5 vjet |
| I-31. Përgatitja & adaptimi i statutit për OPU | | M | M,P | I | | I | I | F | | Afat shkurtër | 5 vjet |
